



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

**RAPORT
I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2019**

Mars 2020

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zonja e zotërinj Deputetë,

Në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 148/b shkronja “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 104 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.3, datë 20.01.2020 “Për miratimin e kalendarit të paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, dërguar me shkresën tuaj nr.311, datë 24.01.2020, ju parashtroj Raportin Vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2019.

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në vend gjatë vitit 2019 dhe objektivat e prioritetet për vitin 2020.

Prokuroria ka ushtruar kompetencat e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligje të tjera në fuqi, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Komitetit Moneyval të KiE-së për vitin 2019, prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit dhe strategjinë afatmesme të prokurorisë 2018-2020.

Për të garantuar, si rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën e përbashkët kundër krimit, forcimin e rendit juridik dhe shtetin e së drejtës, ashtu dhe mbrojtjen e lirive personale dhe të drejtave e interesave të ligjshme të shtetit, ka ende shumë për të bërë, dhe për këtë nevojitet forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale në sistemin e prokurorisë, bashkëpunimi ndërinstitucional i të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë penale dhe i strukturave shtetërore, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe integritetit në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë.

Duke ju siguruar se organi i prokurorisë do të intensifikojë masat në luftën efektive kundër kriminalitetit, ju paraqesim raportin për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2019:

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit	6
Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve të Komisionit European.....	6
Zbatimi i Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”.....	36
Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq.....	44
II. Analiza e treguesve të kriminalitetit.....	47
2.1 Volumi i punës në hetim	47
2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....	48
2.3 Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë në pesë vitet e fundit	49
2.4. Procedime penale të regjistruara sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë	58
2.5. Koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë bazuar në sistemin statistikor të prokurorisë.....	61
2.6. Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.....	62
2.7 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	63
2.8 Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal.....	65
2.9 Analiza e veprave penale sipas strukturës së kodit penal.....	70
Krime kundër njerëzimit.....	70
Krime kundër jetës të kryera me dashje.....	70
Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi.....	81
Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje.....	82
Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia.....	88
Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës.....	89
Krime seksuale.....	92
Vepra penale kundër lirisë së personit.....	98
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit.....	102
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.....	107
Vepra penale kundër lirisë së besimit.....	113
Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.....	114
Mashtrimet.....	125
Shkatërrimi i pronës.....	132
Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.....	140
Vepra penale në veprimtaritë bankare dhe financiare.....	144
Krime në fushën e doganave.....	146
Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet.....	153

Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë.....	157
Falsifikimi i dokumenteve.....	161
Vepra penale në fushën e falimentimit.....	167
Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit.....	167
Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës.....	171
Vepra penale kundër mjedisit.....	175
Krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera.....	180
Vepra me qëllime terroriste.....	182
Vepra penale të kryera nga banda e armatosur,organizata kriminale.....	183
Krime kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit.....	185
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik.....	192
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.....	199
Vepra penale që lidhen me pastrimin e parave.....	219
Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë.....	224
Vepra penale kundër drejtësisë.....	232
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.....	240
Veprat penale të korrupsionit.....	241
Krimi kibernetik.....	250
Trafiqet e paligjshme.....	254
Veprat penale që lidhen me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve.....	260
2.10 Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave penale.....	267
2.11 Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite.....	269
2.12 Të dhëna për të pandehurit	275
III. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....	287
3.1 Ekstradimet.....	290
3.2 Letërporositë.....	294
3.3 Njohjet e vendimeve penale.....	300
3.4 Transferimet e procedimeve penale.....	303
3.5 Transferimet e personave të dënuar.....	304
3.6 Urdhrat e arrestit ndërkombëtar.....	305
3.7 Skuadrat e Përbashkëta Hetimore.....	307
IV Garantimi i integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike	315
V. Ngarkesa e punës së prokurorive për vitin 2019.....	322
VI. Përmbledhje e analizës financiare.....	342

VII. Objektiva prioritarë në luftën kundër kriminalitetit për vitin	
2020.....	347
7.1 Aneksi 1 Të dhëna pasuritë e sekuestruara, kërkuar konfiskimi.....	352

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019

Prokuroria është organ i pavarur kushtetues, që ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Prokuroria për vitin 2019, përbëhet nga¹:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
 - b) Prokuroritë pranë gjykatave për krime të rënda, deri me datë 19 Dhjetor 2019 që u krijua dhe filloi funksionimin Prokuroria e Posaçme²;
 - c) Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
 - ç) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.
- Në prokuroritë sipas niveleve më sipër funksionet ushtrohen nga prokurorët pranë tyre.

Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2019 në luftën kundër kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë në mënyrë të sintetike, kanë qenë³:

I. Prioritetet, rekomandimet, aktiviteti dhe treguesit

1. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe i rekomandimeve të Komisionit Evropian

Prokuroria e Përgjithshme me administrimin e Rezolutës së Kuvendit datë 20.06.2019 dhe në përmbushje të detyrimit të parashikuar, në Pjesën I, pika II/1 shkronja “a” të Vendimit të Kuvendit nr. 134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik” dhe në lidhjen 3 pika 5 të Vendimit të Kuvendit nr.49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, përcolli rezolutën pranë gjithë prokurorive dhe ndërmori masat e nevojshme për hartimin e Planit të Veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së datës 20.06.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2019”, në të cilin janë përcaktuar masat, aktivitetet, strukturat përgjegjëse, fondi i nevojshëm, afatet kohore dhe treguesit e zbatimit për secilin rekomandim të rezolutës së Kuvendit. Plani i veprimit është dërguar për zbatim

¹ Bashkëlidhur struktura dhe organika e prokurorisë, miratuar me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.29, datë 03.2.2019 “Për strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme”.

² Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

³ Renditur sipas kërkesave të Rezolutës së Kuvendit datë 20.06.2019

gjithë prokurorive me detyrimin për të implementuar masat në përputhje me rezolutën dhe duke detajuar aktivitetet në zbatim të tij. Në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, evidentohet se gjithë strukturat përgjegjëse të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, kanë raportuar masat, aktivitetet, arritjet dhe problematikat në zbatimin e tyre.

i) Në zbatim të rekomandimit “*Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet zbatimit më të mirë të procedurave të hetimit proaktiv dhe përdorimit në kufijtë e ligjit të teknikave speciale të hetimit*”, gjatë vitit 2019, janë arritur rezultatet si më poshtë:

Lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar, ekonomik e financiar, pastrimit të parave, terrorizimit, kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe krimeve të rënda të tjera, ka qenë dhe mbetet prioritet i punës së prokurorive në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira, veçanërisht për identifikimin, hetimin dhe goditjen e rrjeteve kriminale, në zbatim edhe të rekomandimeve të Bashkimit Europian në kapitujt 23 e 24 ku prokuroria është e përfshirë, si dhe në zbatim të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019. Prokuroria ka vijuar zbatimin e strategjisë së saj afatmesme 2018-2020, në të cilën është përcaktuar si objektiv forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional me autoritetet vendase dhe të huaja, si në nivel operacional, ashtu dhe nëpërmjet përgjigjes në kohë dhe me efikasitet të letërkërkesave të autoriteteve të huaja.

Gjatë vitit 2019 ka vijuar zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm datë 02.02.2018 “*Në funksion të Planit të Veprimit për Luftën Kundër Krimit të Organizuar, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.637, datë 06. 11. 2017*” dhe zbatimi i udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.1/2018, “*Për krijimin e seksioneve të posaçme*”, akt ky që i ka shtrirë efektet, për prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda deri me 18 Dhjetor 2019, me krijimin dhe fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë ka vijuar zhvillimi i takimeve e analizave me institucionet ligjzbatuese, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë hetimore dhe arritjen e rezultateve sa më të larta në luftën e përbashkët kundër korrupsionit, krimit të organizuar, ekonomik e financiar, trafikëve të paligjshme, pastrimit të parave dhe krimeve të rënda të tjera. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese ka ndikuar në rritjen e numrit të referimeve të kallëzimeve për vepra penale në vitin 2019⁴ dhe në shkëmbimin e shpejtë të informacionit në kuadrin e hetimeve proaktive me shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit.

⁴ Gjatë vitit 2019 rezultojnë të jenë regjistruar në prokurori 59888 kallëzime/referime për vepra penale, ose me rritje prej 3,73 % në krahasim me vitin 2018.

Ndërkohë, në periudhën Nëntor-Dhjetor 2019, në prag të krijimit të Prokurorisë së Posaçme, krahas punës intensive të prokurorëve të ngarkuar me ndjekjen e çështjeve, paralelisht u morën masat administrative dhe procedurale penale për garantimin e një procesi efektiv të transferimit të çështjeve nga prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në Prokurorinë e Posaçme dhe nga Prokuroria për Krime të Rënda në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, duke ndjekur kompetencën lëndore e tokësore përkatëse. Për këtë qëllim, Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr. 9/2019, me anë të të cilit, me krijimin dhe fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, në mënyrë të unifikuar u siguroa transferimi i çështjeve, duke u garantuar zbatimin e parimit të ligjshmërisë, respektimi i të drejtave dhe lirive të personave nën hetim, të pandehurve dhe viktimave, ruajtja e sekretit të hetimeve dhe vijueshmëria e ushtrimit të ndjekjes penale në çështjet e transferuara.

Lufta kundër korrupsionit

-Në zbatimin e këtij rekomandimi për ***“Forcimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet zbatimit më të mirë të procedurave të hetimit proaktiv dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit”***, gjatë vitit 2019, për veprat penale kundër korrupsionit, prokuroria në bashkëpunim me agjensitë e zbatimit të ligjit ka kryer hetime proaktive, me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në kuadrin e 91 procedimeve penale ose krahasuar me vitin 2018 me shifra në rritje të procedimeve që i përkasin prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. Referuar kompetencës lëndore, 13 procedime i përkasin Prokurorisë për Krime të Rënda dhe 78 procedime i përkasin prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Në këtë veprimtari të hetimeve proaktive, prokurorët kanë patur rol aktiv në procesin për grumbullimin, administrimin e fakteve/provave që i kanë shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes të veprimtarisë së mëtejshme kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 72 personave autor të dyshuar të përfshirë në kryerjen e veprave penale, si të korrupsionit, ashtu dhe të shpërdorimit të detyrës, etj, prej të cilave 7 persona/autor të dyshuar i përkasin kompetencës së Prokurorisë për Krime të Rënda dhe 65 persona/autor të dyshuar në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

-Në zbatim të këtij rekomandimi të rezolutës, referuar të dhënave statistikore për vitin 2019 rezulton se, përqindjen më të lartë në procedimet e regjistruara për veprat penale të korrupsionit e zë nëni 259 i Kodit Penal ***“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”***, e konkretisht 33,5 % të totalit të procedimeve për korrupsion, ndërsa në procedimet e dërguara për gjykim për këtë veprë është rritur numri i personave 29,4 %, krahasuar me vitin 2018.

Në procedimet e dërguara për gjykim, për veprën penale ***“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*** që parashikon neni 245/1 i

Kodit Penal është rritur 29,6 % numri i personave të dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2018, ndërsa për veprën penale “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendore*” që parashikon neni 245 i Kodit Penal është rritur 4 herë numri i personave të dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2018.

Ndërsa, për veprën penale “*Korrupsioni pasiv në sektorin privat*” është rritur 1 (një) herë numri i procedimeve të regjistruara dhe është rritur 2 (dy) herë numri i personave të dërguar për gjykim, krahasuar me vitin 2018.

Për korrupsion në nivele të larta, referuar kërkesave të prokurorëve dhe vendimeve të Gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, për vitin 2019 veçojmë të përmendim, disa raste, siç janë: deklarimi fajtor dhe dënimi i 3 (tre) ish-gjyqtarëve të apelit, secili, për veprën penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”; -: deklarimi fajtor dhe dënimi i 1 (një) ish-gjyqtari i shkallës së parë, për veprën penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”; dhe -: deklarimi fajtor dhe dënimi i 1 (një) ish-ministër (i brendshëm), për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*”.

Lufta kundër krimit të organizuar

-Në zbatim të rekomandimit për “*Forcimin e luftës kundër krimit të organizuar nëpërmjet zbatimit më të mirë të procedurave të hetimit proaktiv dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit*”, gjatë vitit 2019, në zbatim të kërkesave dhe procedurave ligjore, janë kryer hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në kuadrin e 309 procedimeve për veprat penale kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme përfshi dhe veprat penale kundër narkotikëve, pastrimit të parave dhe krimeve të rënda të tjera të lidhura me to, ose me rritje 23.6 përqind krahasuar me vitin 2018. Referuar kompetencës lëndore, 144 procedime i përkasin Prokurorisë për Krime të Rënda dhe 195 procedime i përkasin prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Prokurorët kanë patur rol aktiv, si në regjistrimin e procedimeve, dhënien e autorizimeve ose mbi kërkesën e tyre me vendime gjyqësore është autorizuar përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit/mbikëqyrjes për zbatimin e tyre. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 420 personave të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale, prej të cilave 216 persona/autor të dyshuar i përkasin kompetencës së Prokurorisë për Krime të Rënda dhe 204 persona/autor të dyshuar në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

-Referuar treguesve statistikorë, në zbatim të këtij rekomandimi të Rezolutës, për veprën penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, që parashikon neni 333/a i Kodit Penal dhe vepra penale të tjera të kryera në kuadrin e grupit të strukturuar, në vitin 2019 rezulton se

janë regjistruar 51 procedime penale, prej të cilëve 13 procedime me 126 të pandehur janë dërguar në gjykatë, ose krahasuar me vitin 2018 me rritje 24.4 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje 116 % të numrit të procedimeve dhe mbi 300 % të numrit të personave të dërguar për gjykim për këtë vepër.

Për më tepër, në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda për vitin 2019 ka informuar se, kanë marrë formë të prerë dhe janë vënë në ekzekutim vendimet penale ndaj 89 personave, që sipas veprave penale rezultojnë të dënuar: -14 persona për veprat penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, “*Trafikimi i narkotikëve*” dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” të parashikuara nga nenet 283/a/1, 333/a e 334/1 të Kodit Penal; -16 persona për veprat penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, “*Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit*” dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, të parashikuara nga nenet 79/b, 333/a e 334/1 të K.Penal; si dhe -59 persona për veprën penale “*Trafikimi i narkotikëve*” parashikuar nga neni 283/a paragrafi 1 e 3 i Kodit Penal.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e rezolutës për faktin se evidentohet, si rritja e efektivitetit të hetimeve proaktive, ashtu dhe rritja e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë për veprat penale më të përhapura në këto grup veprash kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, tregues që ndikojnë në parandalimin e përgjithshëm të tyre.

✚ Me gjithë arritjet, për vitin 2019, në raportet ndërkombëtare për Shqipërinë, lidhur me disa indikatorë për këto grup veprash penale janë evidentuar mangësi. Për vitin në vijim rritja e mëtejshme e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që përfshin këto grupveprash në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme, përbën një sfidë për institucionet e reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK), në bashkëpunim me agjencitë e specializuara ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, për thellimin dhe intensifikimin e mëtejshëm të hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, në funksion të zbulimit dhe goditjes më në thellësi të shtrirjes së veprimtarisë, si të krimit të organizuar dhe ekonomik brenda vendit dhe lidhjeve të tij jashtë vendit, ashtu dhe të korrupsionit në nivele qendrore e vendore dhe lidhjeve të tij me krimin, duke sekuestruar pasuritë dhe produktet e veprimtarisë kriminale të tyre.

-Në kuadrin e zbatimit të këtij rekomandimi të rezolutës, krahas luftës kundër krimit të organizuar, gjatë vitit 2019 në luftën kundër veprave penale të trafikimeve të paligjshme, narkotikëve, veprave me qëllime terroriste dhe pastrimit të parave, evidentohet gjendja dhe arritjet referuar treguesve statistikorë, si më poshtë:

Lufta kundër trafiqeve të paligjshme

Për veprat “Trafikimi i personave të rritur” dhe “Trafikimi i të miturve” të parashikuara nga nenet 110/a e 128/b të Kodit Penal, janë regjistruar 25 procedime penale, prej të cilëve 3 procedime me 6 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2018 me rritje 13 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe 50 % të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim për këto vepra.

Për veprat penale “Trafikimi i armëve dhe municionit” dhe “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive” të parashikuara nga nenet 278/a e 282/a të Kodit Penal, janë regjistruar 13 procedime penale, prej të cilëve 5 procedime me 6 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2018 me ulje 7.6 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje 66.6 % të numrit të procedimeve dhe rritje 100 % të numrit të personave të dërguar për gjykim për këto vepra penale.

Lufta kundër trafikimit dhe kultivimit të narkotikëve

Për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, janë regjistruar 87 procedime penale, prej të cilëve janë dërguar në gjykatë 36 procedime me 74 të pandehur ose krahasuar me vitin 2018 me ulje 17 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje 7 % të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim.

Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal janë regjistruar 833 procedime, prej të cilëve 383 procedime me 517 të pandehur janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2018 me ulje 24 % të numrit të procedimeve të regjistruara. Ndërkohë, për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotikëve” të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal janë regjistruar 628 procedime penale, prej të cilëve 66 procedime me 104 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2018 me rritje 1,1 herë të numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje 43 % të procedimeve dhe 57,5 % të numrit të personave të dërguar për gjykim për këtë veprë penale.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e rezolutës për faktin se, si në uljen në tërësi të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikimit dhe shitjes së narkotikëve, ashtu dhe në rritjen e numrit të procedimeve dhe pandehurve të regjistruara dhe të dërguara gjyqit për kultivim të bimëve narkotike, kanë ndikuar si masat e marra në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qëndror dhe vendor në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, ashtu dhe efektet parandaluese, si nga sekuestrimi i sasive të konsiderueshme të drogës së kultivuar dhe të kapur gjatë vitit 2019, ashtu dhe goditja e vazhdueshme e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

✚ Me gjithë arritjet, referuar raporteve ndërkombëtare për këtë grup veprash penale në Shqipëri dhe rekomandimeve të BE-së në Nëntor 2019, në vështrimin institucional,

kërkohej dhe synohej rritja e mëtejshme e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, për intensifikimin e hetimeve proaktive dhe përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimtarisë, si të grupeve kriminale që udhëheqin kultivimin e kanabisit dhe tranzitimin e kokainës brenda vendit dhe lidhjeve të tyre jashtë vendit, ashtu dhe sekuestrimin e konfiskimin e pasurive dhe produkteve të kësaj veprimtarie kriminale të tyre.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

-Në zbatim të rekomandimit të Komitetit të Moneyval të KiE “***Rishikimi i arsyeve që lidhen me performancën e ulët të prokurorisë në hetimet e rasteve për pastrim të parave (PP) me qëllim rritjen e numrit të rasteve që çohen në gjykatë dhe dënimeve për PP***”, Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion të hollësishëm në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë për kryerjen e analizave lidhur me arsyet që çuan në një ecuri të ulët të hetimit dhe ndjekjes penale të këtyre çështjeve. Informacioni i mbledhur nga prokuroritë rezultoi me arsye objektive dhe subjektive që ndikojnë në efikasitetin e ndjekjes penale dhe vështirësi në sigurimin e të dhënave të sakta dhe të plota, provave, të cilat mund të justifikojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshem ndjekjen penale sipas nenit 287 të Kodit Penal.

-Në kuadrin e përmirësimit të gjendjes dhe rritjes së efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Prokurori i Përgjithshëm me urdhërin 117/2019 (10.07.2019) ka ngritur një grup pune me prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë. Ky grup pune ka mbikëqyrur zbatimin e planit të veprimit të rekomandimeve të Komitetit Moneyval, nëpërmjet kerkimit të informacionit periodik nga drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë për ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

-Në kuadrin e masave administrative dhe proceduriale për përmirësimin e gjendjes dhe rritjen e efektivitetit në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është ndjekur zbatimi i masave të mëposhtme:

Në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në secilën prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë, është caktuar një prokuror pikë kontakti për të bashkëpunuar në sigurimin e informacionit mbi çështjet brenda kompetencave të këtij grupi pune.

Prokurori i caktuar si pikë kontakti, për rastet e trajtuara lidhur me veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, mban një regjistër të veçantë ku evidenton të gjithë kallëzimet/materiallet e referuara, regjistruara dhe në vijim ecurinë dhe mënyrën e përfundimit të tyre në të gjitha fazat e procedimit penal, sipas një table/pasqyre të veçantë⁵,

⁵ Shih, në masat lidhur me regjistrin parashikohet se: “...në këtë rregjistër do të shënohen të dhëna mbi, - referuesin e materialit të kallëzuar, veprën/at penale bazë, -masat e sigurimit personal dhe/ose pasurorë (sende ose vlera monetare, etj), -përdorimin e metodave speciale të hetimit, -numrin e subjekteve të dyshuar për kryerjen e veprës penale (person fizik dhe/ose person juridik), -mënyra e përfundimit të procedimit në

përditëson dhe raporton⁶ të dhënat statistikore periodikisht çdo 3 muaj apo sa herë që kërkohet, track record sipas tabelës, për secilin kallëzim dhe/ose çështje që është aktualisht në hetim.

-Në këtë kuadër, referuar të dhënave statistikore për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave të parashikuara nga nenet 287, 287/a e 287/b të Kodit Penal, gjatë vitit 2019 janë regjistruar 236 procedime penale, prej të cilëve janë dërguar për gjykim 24 procedime me 47 të pandehur. Ndërkohë, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, janë regjistruar 232 procedime, prej të cilëve 19 procedime, me 31 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2018 me ulje 9 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje 11,7 % të numrit të procedimeve dhe 3 % të numrit të personave të dërguar për gjykim për këtë vepër penale.

-Ndësa, në kuadrin e luftës kundër terrorizmit, për veprat penale “Financimi i terrorizmit”, “Vepra me qëllime terroriste” dhe “Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste” të parashikuar nga nenet 230/a, 230 e 232 të Kodit Penal janë regjistruar 10 procedime penale ose krahasuar me vitin 2018 me rritje rreth 1,5 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këto vepra penale.

-Ndërkohë, gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2019 e në vijim, Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar maksimalisht në përgatitjen e përgjigjeve për pyetësorët, kërkesat e materialet shoqëruese në kuadër të raportimit, si për Komitetin Moneyval të KiE-së, ashtu dhe në Grupin e Posaçëm (Task Force) të Veprimit Financiar (në vijim FATF-në), ku u administruan dhe analizuan përpjekjet e bëra për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, gjatë viteve 2018-2019.

-Prokuroria e Përgjithshme po kujdeset të mbështesë këtë veprimtari me një udhëzim të përgjithshëm të ri, metodika e manuale pune, si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale me ndihmën e projekteve Euralius e Pameca, të cilët asistojnë sistemin e prokurorisë edhe në

fazën e hetimeve paraprake, -kërkesat e prokurorit në gjykatë (përfshi dhe ato mbi pasurinë e sekuestruar) dhe -vendimet e gjykatës sipas shkallëve të gjykimit, si dhe -të dhëna të tjera sipas tabelës.”

⁶ Shih, në masat lidhur me raportimi parashikohet se:

-“Raportimi do të bëhet, drejtpërdrejtë me email nga prokurori i caktuar si pikë kontakti tek prokurori i caktuar si pikë kontakti në Prokurorinë e Përgjithshme dhe zyrtarisht nëpërmjet Drejtuesit të Prokurorisë në Drejtorinë e Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme.”

-“Prokurori i caktuar, si pikë kontakti, në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, të marrë masat për të përcjellë nëpërmjet Drejtuesit të Prokurorisë, çdo vendimmarrje të prokurorëve në Prokurorinë përkatëse ku ushtron funksionin/detyrën, si mosfillim, kërkesë për pushim apo kërkesë për dërgim për gjykim, etj, si dhe vendim përfundimtar të gjykatës tek Drejtoria e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, edhe në ato raste kur referimi i veprës penale nuk është bërë prej këtij institucioni.”

këtë fushë. Në kuadrin e një projekti ndërkombëtar, Prokuroria e Përgjithshme do të përditësojë Manualin e Projektit të Binjakëzimit të BE-së⁷ me standartet europiane dhe praktikat e mira gjyqësore shqiptare në këtë fushë, përfshi dhe hetimet pasurore, me ide novative mbi metodat hetimore, me synim për të unifikuar zbatimin e praktikave dhe tipologjive lidhur me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm të të gjithë niveleve.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, konsiderojmë se është zbatuar pjesërisht rekomandimi i Komitetit Moneyval të KiE-së, për faktin se, ka rritje të masave dhe rritje të ulët të treguesve statistikore të procedimeve penale dhe të pandehurve të dërguar në gjyq për veprën penale të pastrimit të parave. Ndërkohë, konstatohet se, -në kuadrin e procedimeve penale për krimet e trafikimit, kultivimit të narkotikëve, vepra me qëllime terroriste dhe/ose krimeve të rënda të tjera që gjenerojnë të ardhura nga veprimtaria kriminale, nuk janë kryer në të gjitha rastet hetime paralele edhe për veprat penale pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.6/2018 dhe të rekomandimit të Komitetit Moneyval të KiE-së; -efektiviteti i ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për veprën e pastrimit të parave është në nivel të ulët; si dhe -mungon niveli i duhur i kapaciteteve profesionale në standarde europiane për kryerjen e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale, përfshirë dhe për gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

✚ Në zbatim të rekomandimeve për Shqipërinë, të Progres Raportit të KSA në Nëntor 2019, Planit të Veprimit ICRG/FATF në Dhjetor 2019 dhe Konferencës së Palëve të Konventës së Varshavës të KiE-së në Tetor 2019, kërkohet dhe synohen: -ndryshime ligjore të nenit 287 të Kodit Penal në përjasje me nenin 9 (3) të Konvetës së Varshavës, -forcimi i kapaciteteve profesionale dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstucional me agjencitë e përfshira (DPPP, DPSH, DPD, DPT, etj), për rritjen e efektivitetit dhe intensifikimin më tej të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me fokus të veçanërisht, pastrimin e parave të palës së tretë nga profesionistë, me kallëzime të huaja bazuar në prova rrethore, si dhe -rritja e numrit dhe efikasitetit të hetimeve paralele në ndjekjen penale të krimeve që gjenerojnë të ardhura nga veprimtaria e kriminale.

ii) Në zbatim të rekomandimit “***Sigurimi e zbatimi i drejtë dhe i njëllojtë i procedurave për sa u takon hetimeve pasurore, sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve***”, si dhe në zbatim të rekomandimit të Komitetit të Moneyval të KiE-së “***Hetimet financiare paralele të nisur në të gjitha rastet e krimeve serioze që gjenerojnë të ardhura, me qëllim të zbulimit të pastrimit të parave të lidhur me to***”, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.6/2018 “*Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale*”, me efekte zbatimi për

⁷ Manuali i Projektit të Binjakëzimit të BE “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri”, i vitit 2012.

prokuroritë për krime të rënda deri me krijimin e Prokurorisë së Posaçme, i cili normon kryerjen e hetimeve paralele, në kuadrin e procedimit penal, krahas për veprën penale në grup veprat që gjenerojnë të ardhura kriminale, edhe për pasurinë e subjekteve të përfshirë, me synim vijimin e unifikimit për zbatimin e ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, ndaj personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin, korrupsionin, pastrimin e parave, veprave me qëllime terroriste, si dhe krimeve të rënda të tjera që gjenerojnë te ardhura nga veprimtaria kriminale, si dhe për forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale.

-Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, deri më 18 Dhjetor 2019 ka vijuar funksionimi i Seksionit për Hetimin e Krimeve të Korrupsionit dhe Hetimin Pasuror, i cili ishte përgjegjës për kryerjen e hetimeve të pasurisë. Prokuroria për krime të rënda, krahas hetimit penal, ka kryer edhe verifikimet e pasurisë për procedimet penale të regjistruara për veprat penale të parashikuara në nenin 3/1 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*.

-Hetimet pasurore për produkte kriminale të ardhura nga jashtë vendit janë bazuar edhe në kërkesat e autoriteteve gjyqësore të huaja për ekstradimin nga Shqipëria drejt shteteve të huaja, apo kërkesat për njohjen në Shqipëri të vendimeve penale të huaja. Në vitin 2019 autoritetet gjyqësore të huaja kanë paraqitur 43 kërkesa për ekstradime dhe njohje vendimesh penale të huaja ose me rritje rreth 40 % të kërkesave krahasuar me vitin 2018. Për këto kërkesa Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së shtetasve të përfshirë, brenda objektit të nenit 3, pika 1/d (fusha e zbatimit) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009.

Në këtë kuadër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në periudhën Janar-18 Dhjetor 2019, ka regjistruar gjithsej 196 referime për hetime pasurore, përveç atyre të mbartura nga viti 2018, me synim që hetimi pasuror dhe sekuestrimi i aseteve kriminale të bëhet një mjet i dobishëm, për të luftuar këtë fenomen dhe nga ana tjetër të ndihmojë hetimin penal. Në këtë periudhë, në zbatim të ligjit antimafia, prokuroria ka paraqitur në gjykatë 4 (katër) kërkesa për konfiskim të cilat janë në proces gjykimi, si dhe janë pranuar nga gjykata 9 (nëntë) kërkesa të prokurorisë për sekuestrim pasurie, ose krahasur me vitin 2018 me rritje 28 % të kërkesave të pranuar nga gjykata për sekuestrime pasurore. Kërkesat për konfiskimet dhe kërkesat e pranuar nga gjykata për sekuestrime pasurore në zbatim të ligjit nr.10192/2009 dhe vlerat në euro, dollarë e në lekë, pasuri të paluajtshme e të luajtshme të sekuestruara dhe pasuritë e kërkuara në gjykatë për konfiskim, janë të listuara në Aneksin 1, bashkëlidhur. Me krijimin dhe fillimin e

funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kryerja sipas kompetencës lëndore për vitin në vijim i hetimeve pasurore në përputhje me ligjin antimafia, përbën një sfidë për prokuroritë me juridiksionit të përgjithshëm.

-Ndërkohë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe në vijim të zbatimit të udhëzimit datë 20.11.2018 (nr.6/2018), Seksionet e ngritura për Hetimin e Krimin Ekonomik, Financiar e Kibernetik dhe Seksionet e Posaçëm, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, kanë proceduar në kryerjen e sekuestrove preventive të pasurive, mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe të ardhurave nga veprimtaria kriminale, si dhe kanë kërkuar në gjykatë konfiskimin e tyre.

-Lidhur me hetimin pasuror të të ardhurave kriminale që janë sjellë në Shqipëri në rastet e krimeve të kryera jashtë vendit, në vitin 2019 në Prokurorinë e Përgjithshme kanë ardhur 39 letërkërkesa nga jashtë në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, ose me shifra pothuajse të njëjta krahasuar me vitin 2018. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale letërkërkesat i ka dërguar për kompetencë/ndjekje Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Seksioneve të Hetimit të Krimin Ekonomik, Financiar e Kibernetik dhe Seksioneve të Posaçëm, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, për kryerjen e sekuestrove preventive të pasurive si mjete të kryerjes së veprës penale dhe/ose të ardhurave nga veprimtaria kriminale në kuadrin e hetimeve pasurore për rastet e krimeve të kryera jashtë vendit.

Referuar të dhënave lidhur me sekuestrimet preventive për hetimet pasurore në periudhën janar-dhjetor 2019, evidentojnë se Seksionet e ngritura për hetimin e Krimin Ekonomik, Financiar e Kibernetik dhe Seksionet e Posaçëm në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, në kuadrin e 26 procedimeve penale për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” neni 287 të K.Penal në lidhje dhe me vepra të tjera penale, të parashikuara nga nenet 283, 283/a, 333/a, 143, 109/b, 170/ç, 186, 190, 199/a të K.Penal, mbi kërkesën e prokurorëve, me vendime gjyqësore është proceduar në kryerjen e sekuestrove preventive të përllogaritura në shumën totale 40,411,022 euro, që sipas llojeve janë: -pasuri të paluejtshme, (*sipërfaqe apartamente banimi, njesi tregtare, garazhe, tok truall, tok arë, etj*); -pasuri e luajtshme autovetura të llojeve e markave të ndryshme, etj), vlerave monetare në valutë dhe në lekë dhe llogari bankare. Kryerja e sekuestrove preventive evidentohet me tregues në rritje sasiore dhe cilësore lidhur me pasuritë e sekuestruara të listuara në Aneksin 1 bashkëlidhur.

✚ Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e ligjore dhe në zbatim të rezolutës e rekomandimeve të Komitetit Moneyval të KiE-së, konsiderojmë se, ka rritje të masave e treguesve statistikore të hetimeve pasurore dhe pasurive të sekuestruara me vendime gjyqësore, si me anë të sekuestrove preventive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, ashtu dhe të sekuestrimeve të pasurive në zbatim të ligjit nr.10192/2009 “antimafia”, si dhe

ka rritje të treguesve të bashkëpunimit në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në këtë fushë. Ndërkohë, konstatohet se nuk janë kryer hetime paralele për të gjithë procedimet penale për krime që gjenerojnë të ardhura nga veprimtaria kriminale, në zbatim të udhëzimit nr.6/2018 dhe të rekomandimit të Komitetit Moneyval të KiE-së, kjo edhe për faktin se ka patur raste kur dukshëm nuk ka qenë nevoja për kryerjen e tyre, referuar rrethanave të faktit apo subjektit si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me agjencitë e përfshira në zbatimin e ligjit antimafia nuk ka qenë në nivelin e duhur, si dhe ka pamjaftueshmëri të kapaciteteve për kryerjen e hetimeve pasurore për zbulimin, identifikimin dhe sekuestrimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaria e krimit të organizuar, trafikimeve të paligjshme, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e krime të rënda të tjera.

✚ Në zbatim të rekomandimeve për Shqipërinë, të Progres Raportit të KSA dhe të Planit të Veprimit ICRG/FATF, kërkohet dhe synohen, rritja e efektivitetit në bashkëpunimin ndërinstitucional me agjencitë e përfshira në këtë fushë (DPPP, DPSH, DPD, DPT, etj) dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të tyre, për të intensifikuar më tej hetimet pasurore për zbulimin, identifikimin dhe sekuestrimin/konfiskimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, veçanërisht të aseteve që përfaqësojnë të ardhura indirekte dhe vlerë ekuivalente, si dhe për vepra penale apo krimeve të rënda të tjera që gjenerojnë të ardhura nga veprimtaria kriminale.

iii) Në zbatim të rekomandimit **“Zgjerimi dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, me qëllim rritjen cilësore, thellimin dhe intensifikimin e hetimeve në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimitarisë kriminale brenda vendit dhe të lidhjeve të tij jashtë vendit”**, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme në zbatim të planit të veprimit *për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që parashikon ngritjen e task-forcave multidisiplinore për monitorimin dhe zbatimin e saj, me fokus të veçantë në rikuperimin e të ardhurave nga krimi*, në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në shkurt 2018 për trajtimin e përbashkët të fenomeneve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo marrëveshje, edhe pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, për veprat penale në kompetencë të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm bashkëpunimi me të gjitha institucionet ligjzbatuese do të vijojë me të njëjtin intensitet dhe përgjegjshmëri.

-Ndërkohë, ka vijuar zbatimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimit nr.1/2018 *“Për krijimin e seksioneve të posaçme”* në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe rritjes së numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve të aseteve/ardhurave nga veprimtaria kriminale, si dhe rritja e efektivitetit në hetimet penale edhe me anë të përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve për këto vepra penale.

-Prokuroria për krime të rënda dhe prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për rritjen e efektivitetit në luftën kundër kundër kriminalitetit, sipas kompetencës lëndore dhe grup veprave penale, krahas bashkëpunimit me shërbimet/strukturat e policisë gjyqësore të Drejtorive Vendore dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit, kanë bashkëpunuar me Zyrën Qendrore të Interpol Tirana, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ILDKPKI, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tregtar, Qendrën Kombëtare të Licencave, Agjencitë e Legalizimit të Ndërtimeve pa leje, Bankat e nivelit të dytë, zyrat e transferimit të parave, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore, Ministrinë e Drejtësisë dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, si dhe me autoritetet e huaja nëpërmjet kërkesave për ndihmë juridike nga jashtë dhe për jashtë vendit.

-Në kuadrin e **zgjerimin dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit**, me ratifikimin me ligjin 113/2018 të marrëveshjes së bashkëpunimit me Eurojust-in, e cila hyri në fuqi më 1 Nëntor 2019, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme është Pikë Kontakti në Eurojust, si dhe në Rrjetin Gjyqësor Evropian (European Judicial Network – EJV) dhe për rrjedhojë janë rritur kontaktet e drejtpërdrejta me Pikat e Kontaktit të Vendeve të tjera në funksion të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore jashtë vendit, me qëllim rritjen cilësore, thellimin dhe intensifikimin e hetimeve për zbulimin dhe goditjes të veprimtarisë kriminale brenda vendit dhe të lidhjeve të tij jashtë vendit. Në këtë kuadër, kjo drejtori ka komunikim të vazhdueshëm edhe me Oficerët Ndërlidhës Policorë të vendeve si Belgjika, Holanda, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Zyrën Ndërlidhëse Policore Italiane, të vendeve Nordike, etj., si dhe mbahen kontakte të shpeshta me Magjistratin Ndërlidhës Italian të atashuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore dhe në zbatim të rekomandimit të rezolutës, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin për këtë tregues, për faktin se në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor, përgjithësisht është rritur efektshmëria në zbulimin, goditjen dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale në këtë fushë, duke inkurajuar përmirësimin e mëtejshëm, si për rritjen e cilësisë së këtij bashkëpunimi, ashtu dhe rritjen e efektivitetit në bashkëpunimin ndërinstitucional në të ardhmen.

iv) Në zbatim të rekomandimit “**Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe autoritetet gjyqësore të huaja në të gjitha fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor, me qëllim shkëmbimin e informacionit lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit dhe nxitjen e krijimit e grupeve**

hetimore të përbashkëta për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit”, Prokuroria e Përgjithshme ka zbatuar masat si më poshtë:

-Në zbatim të masës **për rritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore**, vitin 2019 është nënshkruar një marrëveshje e re ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë për ngritjen e grupit të përbashkët hetimor për çështjet penale të regjistruara për veprën penale “*Organizata kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike*”. Kjo skuadër e ngritur do të realizojë aktivitetet e miratuara në marrëveshjen e përbashkët me mbështetjen e Eurojust-it. Gjithashtu, është nënshkruar një shtojcë për zgjatjen, në një periudhë shtesë prej 12 muajsh, e një marrëveshjeje ekzistuese, për ngritjen e një grupi të përbashkët hetimor, e nënshkruar fillimisht në vitin 2018.

-Në kuadrin e **marrjes së masave të nevojshme për implementimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me EUROJUST**, në zbatim të ligjit nr.113/2018 që ka ratifikuar marrëveshjen e bashkëpunimit me Eurojust-in, është ngritur një grup pune i përbashkët me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe përfaqësues të Projektit IPA 2017 “Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor”.

Prokuroria e Përgjithshme mori gjithë masat e nevojshme për adresimin e rekomandimeve të Komisionerit dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për implementimin e Marrëveshjes me Eurojust-in, përmbushja e të cilave ishte garancia për hyrjen në fuqi të saj më 1 Nëntor 2019.

-Në zbatim të Marrëveshjes me Eurojust dhe në përmbushje të rekomandimit të BE-së datë 14.11.2019, autoritetet përkatëse (Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Ministri i Drejtësisë) kanë bashkëpunuar dhe gjetur modalitetet e duhura dhe së afërmi pritjet të komandohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë një Prokuror Ndërlidhës, përfaqësues i prokurorisë shqiptare në Eurojust. Referuar varjantit në anglisht të marrëveshjes së bashkëpunimit me Eurojust e ratifikuar me ligjin nr.113/2018, terminologjia e përdorur në nenin 5 pika 1 të saj është “komandojë” dhe jo “emërojë” siç është në varjantin e përkthyer në shqip, (publikuar në FZ, Viti 2018 - Numri 197, datë 15.01.2019), arsye për të cilën sugjerojmë korrektimin e përkthimit në nenin e marrëveshjes së publikuar.

-Në zbatim të masës për **vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta me institucionet homologe**, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme luan një rol kyç koordinues ndërmjet autoriteteve gjyqësore vendase dhe të huaja në ekzekutimin e kërkesave të ndryshme juridike në çështjet penale. Kjo Drejtoria ka komunikim të vazhdueshëm me Oficerët Ndërlidhës Policorë të vendeve si Belgjika, Holanda, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Zyrën Ndërlidhëse Policore Italiane

INTERFORZE, të vendeve Nordike, etj. Përveç kësaj mbahen kontakte të shpeshta me Magjistratin Ndërlidhës Italian të atashuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

-Për vitin 2019, pika e kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme ka administruar 23 kërkesa nga autoritetet kombëtare të vendeve anëtare të BE-së në Eurojust, si Itali, Greqi, Zvicër, Republika Çeke, etj., me objekte të ndryshme, ndër të cilat veçojmë:

a) Lehtësimin dhe përmirësimin e ekzekutimit të UAE-ve, që janë qarkulluar nëpërmjet kanaleve policore (INTERPOL, SIRENE);

b) Organizimin e takimit koordinues, ndërmjet prokurorëve Shqiptarë dhe Hollandezë, për të shkëmbyer informacion mbi hetimet në secilin vend dhe për të diskutuar mbi mundësitë e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar;

c) Bashkëpunimi në mënyrë të ngushtë (duke negociuar dhe tekstin) në kuadër të ngritjes së Skuadrave të Përbashkëta Hetimore (specifikisht me Italinë), për vepra penale të kryera nga organizata kriminale (janë kryer një sërë veprimesh hetimore nga të dyja palët, si arrestime personash, kontrolle banesash, vendosje pajisjesh GPS nëpër makina, remotizim i përgjimeve, marrje në pyetje), etj.

-Të dhënat e tjera statistikore për marrëdhënit juridiksionale me autoritetet e huaja për vitin 2019, janë si vijon:

- 180 ekstradime nga jashtë;
- 157 ekstradime për jashtë;
- 625 letërporosi nga jashtë;
- 639 letërporosi për jashtë.

-Përveç sa më sipër, me mbështetjen e Misionit EURALIUS V në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur grup pune për hartimin dhe është në prag të përfundimit udhëzimi i përgjithshëm në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën e kriminit kibernetik.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e rezolutës, për faktin se, të dhënat dhe angazhimet institucionale të prokurorisë, evidentojnë tregues në rritje të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe autoritetet gjyqësore të huaja në të gjithë fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor dhe forcimin e besimit ndaj institucionit të prokurorisë nga partnerët në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

✚ Me gjithë arritjet, referuar raporteve ndërkombëtare për Shqipërinë në vitin 2019, pas Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shqipëri-Eurojust, në vështrimin institucional kërkohet dhe synohet, lehtësimi dhe intensifikimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore të vendeve anëtare dhe me vendet e treta, përfshi vendet e rajonit, si për të shkëmbyer informacion të ndërsjelltë lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale brenda vendit që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit, ashtu dhe për krijimin e

skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së grupeve kriminale brenda dhe jashtë vendit. Gjithshtu, në zbatim të Planit të Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (*Masa 7⁸, nënobjektivi 5/a*), të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.409 datë 19.06.2019 dhe në zbatim të Planit të Veprimit ICRG/FATF, që parashikon **“Zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve për prioritizimin sistemik të çështjeve të ndihmës së ndërsjelltë juridike për të gjitha autoritetet e përfshira deri në pikën që sistemi është funksional”**, kërkohet angazhimi dhe mbështetja institucionale e Ministrisë së Drejtësisë për intensifikimin e bashkëpunimi ndërinstitucional në kuadrin e zbatimit të këtij rekomandimi gjatë vitit 2020 dhe/ose brenda muajit prill 2021.

v) Në zbatim të rekomandimit **“Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për identifikimin dhe planifikimin e drejtë të nevojave për magjistratë në sistemin e prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm. Forcimi i marrëdhënieve të Prokurorit të Përgjithshëm me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për qartësimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit është i mirëpritur”**, Prokuroria e Përgjithshme po bashkëpunon me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe me Shkollën e Magjistraturës, si për të identifikuar nevojat dhe planifikuar pritshmëritë për nxjerrjen e magjistratëve të rinj në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, ashtu dhe për të plotësuar vendet vakante për prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve me juridiksion të përgjithshëm dhe për prokurorë të komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët në bazë të ndryshimeve ligjore emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim të rezolutës, si për faktin se, bashkëpunimi me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe mbështetja e tij i kanë shërbyer dhe po i shërbejnë implementimit të reformës ligjore në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, ashtu dhe i kanë shërbyer orientimit të një vizioni të përbashkët për të siguruar mbarëvajtjen e punës administrative në prokurori, si dhe për të shmangur problematikat që krijohen me uljen e numrit të prokurorëve në sistemin e prokurorisë në këtë periudhë kalimtare të procesit të rivlerësimit të prokurorëve.

vi) Në zbatim të rekomandimit **“Hartimi i udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për luftimin e kriminalitetit për vitin 2019**, në Prokurorinë e Përgjithshme grupi i punës i ngritur me asistencën e ekspertëve të

⁸ Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.409 datë 19.06.2019 Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, i cili në nënobjektivin 5/a: *“Përmirësimi i gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturere”*, tek masa 7, parashikon: *“Masa: 7. Krijimi i kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin e informacionit në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar”*, me institucion përgjegjës Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe institucion të përfshirë PP.

Projektit Euralius V vijon punën për përgatitjen e projekt udhëzimeve të përgjithshme (*administrative dhe procedurale*) të Prokurorit të Përgjithshëm në përfaqje me standartet europiane dhe praktikën e mira të prokurorive në vendet e BE-së. Në këtë kuadër, është punuar për përgatitjen e një projekt udhëzimit të përgjithshëm metodologjik për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit sipas natyrës, llojeve e problematikave përkatëse. Përgatitja e këtij projektudhëzimi në kuadrin e këtij grupi punë është përfshirë dhe në planin e punës të projektit Euralius-it për 6 mujorin e parë të vitit 2020.

-Ndërkohë, në kuadrin e mbikëqyrjes të zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2019, Prokuroria e Përgjithshme ka marrë një sërë masash, duke i kërkuar prokurorive të të gjithë niveleve informacione për ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve, arritjet dhe problematikën, si dhe nevojat legislative apo buxhetore që ndikojnë në zbatimin e tyre.

-Prokurori i Përgjithshëm, si në kuadrin e udhëzimeve të përgjithshme të nxjerra në zbatim të rekomandimeve të rezolutës, ashtu dhe në zbatim të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe/ose për problematika të tjera të konstatuara dhe të nevojshme për rregullime unifikuese në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, gjatë vitit 2019 ka nxjerrë udhëzimet e përgjithshme të listuara në pikën “i)” të pjesës “2.Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019” të këtij Raporti.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, konsiderojmë se është zbatuar ky rekomandim i rezolutës, për faktin se, është përgatitur projekt-udhëzimi i përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe është në fazën e diskutimeve, ashtu dhe se gjatë vitit 2019 janë përgatitur e miratuar disa udhëzime të përgjithshme të listuara në pikën “i)” të pjesës 2 “Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”, në përmbajtjen e të cilëve janë normuar/unifikuar edhe çështje ligjore si të zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, ashtu dhe në zbatim të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave.

vii) Në zbatim të rekomandimit “*Hartimi i një kalendari të trajnimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore...*”, në muajin korrik 2019 në zbatim të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” u ngrit dhe filloi funksionimin Komisioni i Policisë Gjyqësore, i cili në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm siguroi infrastrukturën e nevojshme, ambientet me pajisjet e përshtatshme dhe u krijua Sekretariati Teknik për funksionimin në mbështetje të tij, i përbërë fillimisht nga dy punonjës. Komisioni filloi punën me ngritjen e grupeve të punës dhe përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, ku përmendim:

- Miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit;

- Dy projekt-rregullore, *-për procedimin disiplinor të oficerëve të policisë gjyqësore dhe -për procedurën e konkurrimit për caktimin e oficerëve të policisë gjyqësore në seksionet e prokurorisë*, janë në proces konsultimi me grupet e interesit (oficerët e seksioneve dhe ata të shërbimeve të policisë gjyqësore);

- Është në proces përgatitja e sistemit të vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore.

Komisioni⁹ në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, Akademinë e Sigurisë dhe/ose institucionet publike arsimore, të ngarkuara me ligj për trajnim profesional përcakton rregullat për organizimin e trajnimit fillestar për hetimin dhe vlerëson nevojat për trajnim dhe planifikon trajnimet e oficerëve dhe agentëve të Policisë Gjyqësore.

Në zbatim të kuadri ligjor, Komisioni po bashkëpunon me projektin suedez për drejtësinë penale për të miturit, të cilëve u është kërkuar përfshirja e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori për trajnimet që ata po kryejnë për çështjet e drejtësisë penale me të miturit.

Ndërkohë, në kuadrin e trajnimit vazhdues, Komisioni po bashkërendon me Prokurorin e Përgjithshëm, Akademinë e Sigurisë dhe Shkollën e Magjistraturës për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin e trajnimit, hartimin e programeve dhe pjesëmarrjen në to.

✚ Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e ligjore, ky rekomandim i rezolutës është në proces zbatimi, ashtu si dhe aktet nënligjore bazë që rregullojnë veprimtarinë dhe ushtrimin e kompetencave të këtij Komisioni.

viii) Në zbatim të rekomandimit **“Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në konsulencë dhe me asistencë të partnerëve ndërkombëtarë, të hartohen/ose të përmirësohen manuale të mënyrës së identifikimit, evidentimit dhe ndjekjes së veprave penale të shtetasve shqiptarë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim jo vetëm sigurimin e të dhënave për veprat penale, në të cilat shtetasit shqiptarë mund të jenë përfshirë si autorë, por edhe si viktime”**, referuar në kuadrin ligjor për të mundësuar zbatimin e këtij rekomandimi, konstatojmë se nenet 28¹⁰ dhe 29¹¹ të ligjit nr.10 193, datë 3.12.2009 **“Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet**

⁹ Shih nenin 19 shkronjat "dh", "e" të kigjit nr.25/2019.

¹⁰ Shih nenin 29 “Regjistri gjyqësor penal i shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit” të ligjit nr.10193/2009 **“Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”**, në pikën 1 dhe 2 të cilit parashikohet:

“1. Zyra e Regjistrat Gjyqësor regjistron në një regjistër të posaçëm shkurtimet e vendimeve për shtetasit shqiptarë të dënuar penalisht jashtë shtetit, duke përfshirë edhe shtetasit shqiptarë të lindur jashtë shtetit. Për këtë qëllim krijohet një regjistër i posaçëm pranë kësaj zyre.”

¹¹ Shih po aty nenin 28 **“Përcjellja e informacionit për shtetasit e huaj të proceduar ose të dënuar”**, në pikën 1 të cilit parashikohet:

*e huaja në çështjet penale” në lidhje me shtetasit shqiptar që kryejnë vepra penale në shtetet e tjera, në paragrafin e parë të nenit 29 parashikon se, **Zyra e Regjistrimit Gjyqësor (Ministria e Drejtësisë) regjistron në një regjistër të posaçëm shkurtimet e vendimeve për shtetasit shqiptarë të dënuar penalisht jashtë shtetit, duke përfshirë edhe shtetasit shqiptarë të lindur jashtë shtetit.** Ndërsa, në lidhje me shtetasit e huaj që kryejnë vepra penale në Shqipëri, paragrafi i parë i nenit 28 të këtij ligji normon se **Ministria e Drejtësisë çdo tre muaj i dërgon informacion autoritetit gjyqësor të huaj për vendimet penale të formës së prerë të dhëna ndaj shtetasve të atij shteti.***

Në zbatim të këtij kuadri ligjor, Ministria e Drejtësisë si autoriteti më i lartë i shtetit në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, çojmë se është autoriteti më i lartë ligjor dhe me mundësi më efektive, që mund/duhet të mbledhë dhe të administrojë në regjistrin e posaçëm sipas ligjit, çdo të dhënë të historikut penal të shtetasve shqiptar (të dënuar dhe/ose viktima) që kanë jetuar dhe/ose jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Të dhënat e plotësuara të këtij regjistri të posaçëm, do t'i shërbenin, si sistemit të drejtësisë penale, veçanërisht për hetimin e veprave penale të pastrimit të parave e financimit terrorizmit dhe hetimeve pasurore, me synim për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga veprimtaria kriminale, ashtu dhe institucioneve të ngarkuara me zbatimin e ligjit për “dekriminalizimin”, me synim për të siguruar të dhënat e nevojshme për subjektet e ligjit nr.138/2015.

ix) Në zbatim të rekomandimit “**Përmbushjen e rekomandimeve të adresuara për Prokurorinë e Përgjithshme nga Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”**”, Prokuroria e Përgjithshme pas analizës së rekomandimeve të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr.115/2016 “**Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë**”, përgatiti ndryshimet e rekomanduara në rregulloren “**Për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit**”. Ndryshimet e propozuara nga Prokurori i Përgjithshëm, u miratuan nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve që u zhvillua në datë 04.10.2019 në kuadrin e zgjedhjes së një anëtari prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, ky rekomandim i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 është

“1. Ministria e Drejtësisë çdo tre muaj i dërgon informacion autoritetit gjyqësor të huaj për vendimet penale të formës së prerë, të dhëna ndaj shtetasve të atij shteti. Ky informacion nxirret nga regjistri i gjendjes gjyqësore.

2. Me kërkesën e autoriteteve kompetente gjyqësore të huaja, Ministria e Drejtësisë përcjell shkurtimin e vendimit penal të formës së prerë ose vërtetimin e gjendjes gjyqësore.”

zbatuar/përmbushur me ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në rregulloren më sipër nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve.

x) Në zbatim të rekomandimit “*Raportimi në Kuvend brenda muajit dhjetor 2019 në lidhje me zbatimin e rregullave të trajtimit të të miturve me kontakt në drejtësinë penale dhe ecurinë e zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur*”, në Prokurorinë e Përgjithshme me urdhrin nr.114, datë 09.07.2019 është ngritur Qendra (Zyra) e Zhvillimit për drejtësinë penale për të miturit. Në përbërje të kësaj zyre janë 4 prokurorë dhe një oficer i policisë gjyqësore, të cilët angazhohen me kohë të pjesëshme, për trajtimin e çështjeve dhe problematikave që dalin gjatë aplikimit të dispozitave ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Fokusi i kësaj zyre është grumbullimi dhe ruajtja e praktikave më të mira vendase dhe ndërkombëtare, në fushën e drejtësisë penale për të miturit, shpërndarjen e këtyre praktikave, dhënien e mbështetjes dhe këshillave prokurorëve që trajtojnë çështjet me të mitur në prokuroritë e të gjithë niveleve, përgatitjen e dokumenteve të politikave, udhëzuesve, manualeve dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera në fushën e drejtësisë penale për të miturit.

Nga kjo Qendër (Zyre), janë përgatitur tre dokumenta, akte për të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të drejtat e të miturit viktimë e veprës penale. Konkretisht janë përgatitur:

- Letra e të drejtave të të miturit në konflikt me ligjin, e cila përmban të gjitha të drejtat që ligji i njuh të miturit në konflikt me ligjin që nga momenti i fillimit të procesit hetimor ndaj tij e deri në përfundim të procedimit penal.

- Letra e të drejtave të të miturit viktimë nga vepra penale, e cila përmban të gjitha të drejtat që ligji i njuh të miturit viktimë e veprës penale gjatë gjithë fazave të procesit penal.

- Është përgatitur një listë kontrolli në të cilën pasqyrohen të gjitha hapat që oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori duhet të kenë parasysh dhe të zbatojnë gjatë trajtimit të çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin apo të miturit viktimë.

Këto materiale janë punuar në bashkëpunim me projektin suedez për drejtësinë penale për të miturit në konflikt me ligjin. Dokumentat e sipër përmendur do t’u shpërndahen gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në vitin në vijim në një aktivitet që do të organizohet nga projekti suedez.

Nga ana e Qendrës po punohet për përgatitjen e një manuali udhëzues për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore për çështjet penale me të miturit në konflikt me ligjin.

-Prioritete të rëndësishme të prokurorisë kanë qenë e mbeten garantimi gjatë procesit hetimor i të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktimat apo dëshmitarë të veprave penale, ku në fokus është interesi më i lartë i fëmijës dhe riintegrimi i tij.

Referuar informacioneve të ardhura nga prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm evidentohet se prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në seksionet për të mitur kanë në fokus të veprimtarisë së tyre garantimin e të drejtave të të miturve që për arsye të ndryshme bëhen pjesë në një proces penal.

Në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë marrë masa për të përmirësuar trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, ku prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Shkodër, Durrës, Fier, Korçë, Berat dhe Tiranë kanë në dispozicion ambiente miqësore të përshtatshme për të miturit.

-Bazuar në disponimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, referuar të dhënave statistikore, në vitin 2019 janë regjistruar 397 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin dhe janë regjistruar 388 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale. Ndaj tyre janë vendosur 41 masa sigurimi, ose për rreth 10,6 % të të miturve, ku masa me arrest është për 6 % të të pandehurve të mitur.

-Sa i përket viktimave të mitura, të dhënat tregojnë se janë regjistruar 218 procedime/çështje me 241 viktima të mitura, të cilëve u janë siguruar të gjitha të drejtat dhe garancitë procedurale penale.

Lidhur me zbatimin e masave alternative që synojnë shmangien e të miturit autor të veprës penale nga procedimi penal, në vitin 2019, ndaj të miturve autorë të veprave penale është vendosur mosfillimi i procedimit për 10,2 % të referime/kallëzimeve të mosfilluara ndaj tyre, është vendosur pushimi i hetimeve për 57,2 % të të miturve nën hetim, prej të cilëve 78,3 % e tyre janë në zbatim të masës alternative të shmangies dhe 2 % janë në zbatim të institutit të ndërmjetësimit.

-Lidhur me forcimin e kapaciteteve, Shkolla e Magjistraturës dhe SIDA (Agjencia Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillimin Ndërkombëtar) në zbatim të programit “Shqiptar-Suedeze për Drejtësinë Penale për të Mitur”, kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme trajnuese gjatë vitit 2019.

Shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar 11 aktivitete, ku 6 prej tyre janë zhvilluar në bashkëpunim me SIDA (Agjencia Suedeze për bashkëpunimin për Zhvillimin Ndërkombëtar) dhe temat kryesore kanë qenë: -“*Drejtësia penale për të mitur. Standardet ndërkombëtare lidhur me parimet e drejtësisë miqësore për të miturit dhe risitë e legjislacionit shqiptar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur)*”; -*Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës*; -*Pozita procedurale e të miturit në dhe gjatë procesit penal sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur*; -*Shmangia nga ndjekja penale e të miturit në konflikt me ligjin*. -*Të drejtat procedurale të të miturit në konflikt me ligjin*; -*Komunikimi dhe intervistimi i të miturve nga gjyqtarë/prokurorë*.

✚ Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim të rezolutës për faktin se, janë marrë masat e duhura institucionale dhe është raportuar në afat në Kuvendin e Shqipërisë, si për krijimin e strukturave të veçanta monitoruese dhe për rritjen e kapaciteteve profesionale në prokurori lidhur me trajtimin e të miturit në konflikt me ligjin dhe viktimave në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ashtu dhe se prokurorët kanë zbatuar dhe po zbatojnë masa alternative që synojnë shmangien e të miturit autor të veprës penale nga procedimi penal dhe një politikë të butë në caktimin e masave të sigurimit ndaj tyre sipas ligjit.

xi) Në zbatim të rekomandimit për **“Marrjen e masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të veprës penale dhe për të adresuar dhe rekomanduar zgjidhje për zbatimin e drejtë të rregullave për kërkesat e viktimës akuzuese”**, në vitin 2019 janë marrë masat dhe zhvilluar aktivitetet, si më poshtë:

-Ka vijuar mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.5/2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, i hartuar me asistencën e OPDAT.

-Në muajin qershor ka përfunduar procesi i rekrutimit të koordinatorëve të viktimave në të gjithë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe me asistencën e OPDAT u organizuan tryeza të rrumbullakta në qershor 2019 dhe tetor 2019 me qëllim trajnimin fillestar të tyre.

Në këto tryeza, koordinatorët u informuan me kuadrin ligjor në fuqi lidhur me të drejtat e viktimave, mbi mënyrën e koordinimit të punës së koordinatorit të viktimave dhe prokurorit në mbrojtje të të drejtave të viktimave, si edhe për mbështetjen e ndjekjes së suksesshme penale të çështjeve të tyre dhe shërbimet e disponueshme në vend në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore për ndihmën juridike falas viktimave. Në fokus të veçantë të tryezës së muajit tetor ishte edhe analiza e problematikave të hasura gjatë punës së tyre dhe diskutimi i zgjidhjeve në zbatim të ligjit.

-Referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale viktimat akuzuese në rastet kur është dëmtuar nga veprat penale (*nenet 90, 91, 92, 112 § 1, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127 e 254 të K.Pena*) ka të drejtë të paraqesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Në këto raste, prokurorët kanë siguruar pjesëmarrjen në gjykimin e këtyre çështjeve, kanë adresuar zgjidhjet dhe disponuar me kërkesë sipas parashikimeve ligjore, duke siguruar zbatimin e procesit të rregullt dhe të drejtë ligjor mbi kërkesën e viktimës akuzuese.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim të rezolutës, për faktin se, vendi janë marrë masat e duhura institucionale dhe në gjithë prokuroritë janë rekrutuar koordinatorët që asistojnë subjektet me status të veçantë, përfshi dhe viktimat akuzuese, si dhe prokurorët kanë marrë pjesë në gjykimet e posaçme

me viktimë akuzuese dhe për shkak të pozitës së veçantë në këto procese kanë mbështetur zbatimin e procesit të rregullt dhe të drejtë ligjor të kërkuar prej tyre (viktima akuzuese).

xii). Në zbatim të rekomandimit “*Përdorimi më efektiv i instituteve procedurale të reja si: urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, duke hartuar dhe nxjerrje udhëzime të përgjithshme, me synim qartësimin e kuptimit dhe zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor përkatës dhe zbatimi dhe mbikëqyrja tyre*” Prokuroria e Përgjithshme, ka mbikëqyrur nëpërmjet të dhënave statistikore periodike, treguesit në gjykimin e çështjeve në zbatimin e këtyre instituteve, ashtu dhe nëpërmjet informacioneve, për problematikat dhe praktikatat e mira të shoqëruara me praktikë gjyqësore sa më të konsoliduar në zbatimin e këtyre institutivite të reja procedurale penale.

-Referuar të dhënave statistikore për vitin 2019, në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale është për 1694 çështje me 1738 të pandehur, shifra që zënë 19.4 % të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, duke shkurtuar kështu afatet e hetimit dhe të gjyqimit për këto grup çështjesh. Konkretisht, prokurorët, kanë kërkuar: -miratimi i urdhërit penal për 740 çështje me 761 pandehur për kundravajtje penale ose krahasuar me vitin 2018 me rritje 22.9 % të çështjeve për miratimin e urdhërit penal; kanë kërkuar: -miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për 735 çështje me 745 të pandehur ose krahasuar me vitin 2018 me rritje 28,7 % të çështjeve, të cilat kryesisht janë për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët, si dhe kanë kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë për 220 çështje me 232 të pandehur.

-Ndërkohë, në Prokurorinë e Përgjithshme, grupi i punës i përbërë nga prokurorë me asistencën e ekspertëve të Projektit Euralius-it, për 6 mujin e parë 2020 është planifikuar përgatitjen e projekt-udhëzimit të përgjithshëm “*Për marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit*”, etj, si institute të reja të Kodit të Procedurës Penale.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim të rezolutës, për aplikimin e instituteve të reja procedurale penale me tregues statistikorë në shifra më të larta, si dhe është në proces zbatimi përgatitja e projekt-udhëzimit të përgjithshëm “*Për marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit*”.

xiii). Në zbatim të rekomandimit për “*Mbledhjen, hedhjen dhe përpunimin, nga çdo prokurori, të statistikave të ndjekjes penale dhe të kriminalitetit, sipas standardeve ndërkombëtare, me qëllim që të mundësohet vlerësimi dhe krahasimi i kriminalitetit ndër vite dhe në raport me vendet e rajonit, në nivel europian dhe ndërkombëtar, si dhe të mundësohet vlerësimi i politikës penale të zbatuar. Kuvendi kërkon dërgimin në Ministrinë e Drejtësisë të të dhënave statistikore të plota dhe të sakta për të gjitha veprat*”.

penale, të pandehurit, viktimat, dëmet e ardhura nga vepra penale dhe në lidhje me zbatimin e politikës penale” ju informojmë se:

-Në sistemin e prokurorisë mbajtja, plotësimi dhe raportimi i të dhënave statistikore normohet me urdhrin nr.284/2002 i ndryshuar dhe me udhëzimin nr.289/2002 i ndryshuar të Prokurorit të Përgjithshëm. Prokuroritë pranë gjykatave të gjithë niveleve raportojnë të dhënat statistikore progresive me bazë 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore. Drejtuesi i Prokurorisë, garanton përgjegjshmërinë, saktësinë dhe dërgimin në afat të statistikës.

Aktualisht, prokuroritë i mbledhin statistikatat manualisht dhe i raportojnë në Prokurorinë e Përgjithshme. Sektori i statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme kontrollon dhe përpunon të dhënat me mjetet që ofron Microsoft Excel.

Sektori i Studimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, në bashkëpunim me zyrat e statistikës në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, pas ndryshimeve të legjislacionit procedural penal ka analizuar nevojën për ndryshime në formatet standarde statistikore dhe në vijim ka pasqyruar në tabelat përkatëse këto ndryshime. Synimi ynë është që nxjerrja e këtyre të dhënave të detajuara të mundësohet nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve (CAMS). Duke qenë se analiza e këtij sistemi është kryer para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit të ri për prokurorinë, për shkak të kufizimeve të dispozitave kontraktuale ndërmjet zbatuesit dhe investitorit (KE-së), ende nuk është arritur implementimi i plotë i statistikave sipas standardeve ndërkombëtare.

-Në kuadrin e zbatimit të masës për *“Nënshkrimin e një Memorandumi Bashkëpunimi me INSTAT”*, bashkëpunimi i Prokurorisë së Përgjithshme me INSTAT ka qenë i vazhdueshëm nëpërmjet grupeve të punës, trajnimeve e shkëmbimit të të dhënave statistikore. Në përputhje edhe me rekomandimin e Kuvendit, në datë 04.11.2019, Instituti i Statistikave dhe Prokuroria e Përgjithshme nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi, ku parashikohet marrja e të dhënave në nivel më të disagreguar (ndarje e detajuar) nga ana e INSTAT.

-Në zbatim të kërkesës në rekomandim për *“dërgimin në Ministrinë e Drejtësisë të të dhënave statistikore të plota dhe të sakta për të gjitha veprat penale, të pandehurit, viktimat, dëmet ardhura nga vepra penale dhe në lidhje me zbatimin e politikës penale”* Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 38 shkronja “h”, e ligjit nr.97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i dërgon çdo vit Ministrisë së Drejtësisë të gjitha të dhënat statistikore që administrohen në sistemin e prokurorisë për ndjekjen penale, me synim hartimin e statistikës së njehsuar të sistemit të drejtësisë penale.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore dhe në zbatim të rezolutës, ju informojmë se mungesa e implementimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve (CAMS) projekt i BE-së, nuk na mundëson mbledhjen, hedhjen dhe përpunimin e të dhënave nga

çdo prokurori, në sistemin CAMS të statistikave të ndjekjes penale dhe të kriminalitetit, sipas standardeve ndërkombëtare dhe europiane, gjendje e cila kërkon marrjen e masave të nevojshme (teknike dhe financiare), për përshtatjen e këtij sistemi sipas nevojave të organit të prokurorisë, me synim hedhjen e bazave për digjitalizimin e plotë të dosjeve penale dhe hedhjen, mbledhjen dhe përpunimin në gjithë prokuroritë të statistikave të ndjekjes penale, sipas standardeve ndërkombëtare, për të na mundësuar bërjen e analizave, vlerësimeve dhe krahasimin ndër vite të treguesve të punës dhe të kriminalitetit, në raport me vendet e rajonit dhe në nivel europian e ndërkombëtar, si dhe vlerësimin e politikës penale të zbatuar.

xiv) Në zbatim të rekomandimit për **“Hartimin dhe nxjerrjen e rregullave standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm që sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori”**, në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores standarde të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. Grupi i punës po asistohet nga ekspertë të projektit Euralius V.

Aktualisht grupi i punës është në proces diskutimi të propozimeve të ekspertëve të Euralius-it, për disa shtesa e ndryshime në projekt rregulloren standard të hartuar për prokuroritë pranë gjykatave të apeleve me juridiksion të përgjithshëm. Ndërkohë, në Planin e Punës të Projektit Euralius-it, për 6 mujin e parë 2020 është planifikuar përfundimi i projekt-udhëzimit të përgjithshëm **“Për rregulloret standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”**.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, ky rekomandim i rezolutës është në proces dhe po ndiqet ecuria për zbatim, për faktin se po punohet dhe është planifikuar përfundimi në 6 mujin e parë 2020 i projekt udhëzimit të përgjithshëm **“Për rregulloret standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm”**.

xv) Në zbatim të rekomandimit për **“Rritjen e pavarësisë së prokurorisë dhe forcimin e kuptimit më të mirë të përgjegjësive nga çdo prokuror. Në këtë kuadër, Kuvendi kërkon hartimin dhe nxjerrjen e rregullave për garantimin e pavarësisë së prokurorit, koordinimin e punës ndërmjet prokurorive të ndryshme, mes tyre dhe Policisë Gjyqësore të përfshira në hetime të përbashkëta”**, grupi i punës i përbërë nga prokurorë, me asistencën e ekspertëve të Euralius-it përgatiti udhëzimin e përgjithshëm **“Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet e tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”**, i cili u miratua me nr.8, datë 04.12.2019, për të garantuar pavarësinë e prokurorit në përjasjen me standartet e akteve ndërkombëtare dhe europiane.

Në qëllimin e këtij udhëzimi të përgjithshëm është venë theksi në, **unifikimin e të drejtave dhe detyrimeve të prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me**

drejtuesit e prokurorive si prokuror më të lartë dhe informimi e kordinimi në veprimtarinë e prokurorisë, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, efincencën, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur.

Gjithashtu, është theksuar, qëllimi për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të disa çështjeve ligjore që lidhen me respektim e parimeve të ligjshmërisë¹², detyrueshmëria e ndjekjes penale¹³ dhe pavarësisë¹⁴ në marrëdhëniet ndërmjet prokurorit me drejtuesit e prokurorive në të gjithë nivelet me juridiksion të përgjithshëm, në përjasje me standartet dhe praktikat e mira europiane për unifikimin dhe përmiresimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale apo procedriale në prokurori.

Ndërkohë, në kuadrin e mbikëqyrjes të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshme, veçanërisht lidhur me garantimin e pavarësisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, i është kërkuar informacion prokurorive të të gjithë niveleve dhe nuk rezulton të ketë patur problematika në zbatimin e këtij parimi të rëndësishën në veprimtarinë e prokurorisë.

Aktualisht, është pezulluar zbatimi i këtij udhëzimi, , për të tërhequr mendimin e të gjithë prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, ndërsa në Keshillin e Lartë të Prokurorisë është depozituar ankim kundër disa neneve të këtij udhëzimi

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim të rezolutës, për faktin se, udhëzimi i përgjithshëm “*Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet e tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*” është përgatitur, miratuar e publikuar, por pezulluar me synim tërheqjen e mendimeve nga secili prokuror, dhe nëse do të vlerësohet e nevojshme mund të rishikohet për ndryshime dhe/ose shtesa të nevojshme të tij.

¹² Shih, nenin 4 “Ligjshmëria e veprimtarisë” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:

“1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi.

2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.”

¹³ Shih, po aty, nenin 5 “Detyrueshmëria e ndjekjes penale”, që parashikon: “Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.”

¹⁴ Shih, po aty, nenin 6 “Pavarësia e prokurorëve”, që parashikon:

”1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitrojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.”

xvi) Në zbatim të rekomandimit për **“Respektimin e ligjit për sekretin hetimor nga çdo prokuror dhe punonjës i prokurorisë. Në këtë kuadër, Kuvendi kërkon hartimin dhe nxjerrjen e rregullave të unifikuara për informimin e publikut dhe medias lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, duke respektuar parimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi në lidhje me ruajtjen e sekretit hetimor”** në Prokurorinë e Përgjithshme grupi i punës me asistencën e ekspertëve të Euralius-it ka përgatitur udhëzimin e përgjithshëm **“Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”**, i cili është miratuar në muajin korrik, me nr.5, datë 30.07.2019 dhe është publikuar në faqen zyrtare¹⁵ të Prokurorisë së Përgjithshme.

Ky udhëzim i përgjithshëm unifikon rregullat për marrëdhënien me publikun dhe median në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, për rritjen e transparencës në marrëdhëniet me publikun dhe median, si një mundësi që publiku të njohë punën e prokurorisë në mbrojtje të të drejtave të tij, për rritjen e besimit të publikut në sistemin e prokurorisë dhe inkurajimin për pjesëmarrjen e tij në parandalimin dhe denoncimin e krimit, si dhe në procesin e reformave në të cilat prokuroria është e përfshirë, duke ruajtur integritetin, pavarësinë e paanësinë, sekretin hetimor, parimin e rëndësishëm të prezumimit të pafajësisë, mbrojtjen e të drejtave të të miturve si dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e rezolutës, për faktin se, udhëzimi i përgjithshëm **“Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”** është përgatitur, miratuar dhe publikuar, si dhe po zbatohet në sistemin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

xvii) Në zbatim të rekomandimit për **“Hartimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”**, Sektori i Dekriminalizimit, është në proces mbledhjeje dhe përpunimi të vendimmarrjes së prokurorive dhe gjykatave, për periudhën 2016-2019, në lidhje me trajtimin e rasteve të mosdeklarimit të rekordeve penale në formularët e vetëdeklarimit nga subjektet e ligjit, si element të anës objektive dhe subjektive të veprës penale të “Falsifikimit të formularëve”.

Në kushtet kur ende nuk ka një praktikë gjyqësore të unifikuar apo një vendim njësuës të Gjykatë së Lartë, kemi vlerësuar se është e rëndësishme që organi i prokurorisë, gjatë hetimit, të ruajë paanësinë dhe të trajtojë me të njëjtat kritere vlerësimi, subjektet të cilët nuk kanë deklaruar në formularët e vetëdeklarimit rekordet kriminale të së kaluarës tyre. Në përfundim të analizës do të vlerësojmë nëse do të ketë nevojë për nxjerrjen e një udhëzimi

¹⁵ http://www.pp.gov.al/web/udhezim_nr_05_date_30_07_2019_1680.pdf

të natyrës së përgjithshme, për t'u patur parasysh nga prokurorët gjatë hetimit të këtyre rasteve.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, ky rekomandim i rezolutës është në procesin e realizimit, në fazën e mbledhjes dhe analizës së praktikave të mira në prokurori dhe në gjykata për rastet e mosdeklarimit të rekordeve kriminale në formularët e vetëdeklarimit nga subjektet e ligjit, dhe po ndiqet ecuria e tyre.

xviii) Në zbatim të rekomandimit për **“Sigurimin e bashkëpunimit, koordinimit, shkëmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë, me të gjitha institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese që kanë shërbime të Policisë Gjyqësore”**, Komisioni i Policisë Gjyqësore ka trajtuar kërkesat e ardhura nga institucionet përkatëse për lëvizje si emërim, transferime dhe komandime të oficerëve të policisë gjyqësore. Gjatë trajtimit të këtyre kërkesave Komisioni ka konstatuar dhe hasur në vështirësi për shkak të mospërputhjeve që ekzistojnë midis ligjit të ri dhe akteve ligjore (organike) të cilët trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me emërimin dhe caktimin e oficerëve të policisë gjyqësore. Konkretisht, midis ligjit të ri për policinë gjyqësore dhe ligjit për policinë e shtetit, ka mospërputhje lidhur me trajtimin e ndryshëm të instituteve apo koncepteve që kanë të bëjnë me transferimin e oficerëve të policisë gjyqësore apo boshllëku që krijohet lidhur me emërimin e oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve apo karrierën e tyre, si dhe për strukturat hetimore.

-Në këtë kuadër, Komisioni i Policisë Gjyqësore në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm po punon për të siguruar bashkëpunimin, koordinimin, shkëmbimin e informacionit dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë, me të gjithë institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese që kanë shërbime të Policisë Gjyqësore.

-Në Prokurorinë e Përgjithshme grupi i punës me asistencën e ekspertëve të Euralius-it ka planifikuar për të përgatitur në 6 mujorin e dytë të vitit 2019 udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm **“Për funksionimin e policisë gjyqësore të përfshirë në hetime dhe koordinimin e punës ndërmjet tyre dhe prokurorive në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”**, për faktin se ndryshimet ligjore lidhur me kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm në marrëdhëniet me policinë gjyqësore kanë shfuqizuar udhëzimin e përbashkët (nr.1227/1, datë 1.04.2008) me Ministrin e Brendshëm **“Për funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore”**.

Me anë të këtij udhëzimi të përgjithshëm, synohet të përcaktohen rregulla të unifikuara, si për riorganizimin e seksioneve të policisë gjyqësore pranë prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe për funksionimin e strukturave hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore pranë institucioneve/agjensive që ligji i ngarkon me detyra për të kryer hetime, ashtu dhe për koordinimin e punës ndërmjet oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Ndërkohë, evidentohet se në Policinë e Shtetit akoma nuk janë ngritur strukturat hetimore që i parashikon ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policinë gjyqësore”, mungesa e të cilave ka penguar fillimin e punës për hartimin e këtij projektudhëzimi në 6 mujorin e dytë të vitit 2019. Për këto arsye, përgatitja e këtij projekt udhëzimi të përgjithshëm nga grupi i punës në bashkëpunim ekspertët e Projektit Euralius V është planifikuar për 6 mujorin e parë 2020.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, ky rekomandim i rezolutës, është në proces dhe po ndiqet ecuria për zbatimin e tij, për faktin, se po punohet për të siguruar bashkëpunimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë, me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese që kanë shërbime të Policisë Gjyqësore, si dhe është planifikuar përfundimi i projekt-udhëzimit të përgjithshëm “Për rregullaret standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm” në 6 mujorin e parë 2020.

xix) Në zbatim të rekomandimit për “**Monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale, nëpërmjet mbikëqyrjes nga prokuroria të respektimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe në ligj të shtetasve**”, konfirmojmë se zbatimin dhe mbikëqyrja e zbatimit dhe respektimit të të drejtave e interesave të ligjshme të shtetasve është dhe mbetet detyrë parësore për çdo prokuror në kuadrin e çdo procedimi penal, krahas detyrimit kushtetues e ligjor për ushtrimin e ndjekjes penale nga ana e tyre.

Në të gjithë udhëzimet e përgjithshme proceduriale dhe aktet e tjera normative të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm është normuar veçanërisht respektimi i të drejtave dhe i interesave të ligjshme të shtetasve dhe subjekteve të procedimit në të gjitha fazat e ndjekjes penale, si dhe i të drejtës së informimit të tyre, udhëzime të detyrueshme për zbatim sipas ligjit nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, të cilët mbikëqyrën nga drejtuesit e prokurorive në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, ashtu dhe nga strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, nëpërmjet kërkesave për informim në kuadrin e mbikëqyrjes të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, të trajtuar dhe mësipër në pikën “vi) Në zbatim të rekomandimit “**Hartimi i udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për luftimin e kriminalitetit për vitin 2019.**”

Në kuadrin e respektimit të të drejtave të personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale dhe të kujdesit për ushtrimin e kompetencave ligjore të prokurorisë, shqetësimi institucional i Prokurorisë së Përgjithshme ka vijuar dhe për vitin 2019 lidhur me mungesën e institucioneve mjekësore të posaçme në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për trajtimin e personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale, ndaj të cilëve nga gjykata është vendosur mjekim i detyrueshëm në një institucion mjekësor ose shtrim i përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm.

Prokurori i Përgjithshëm me qarkoren nr.3339/1 datë 04.01.2019, drejtuar prokurorive të të gjithë niveleve me juridiksion të përgjithshëm ka udhëzuar/orientuar prokurorët që urdhri i ekzekutimit, si për kryerjen e mjekimit të detyrueshëm në institucione mjekësore, ashtu dhe për shtrimin e përkohshëm në një spital psikiatrik, sipas ligjit¹⁶ t'i dërgohet institucionit mjekësor të specializuar që është përcaktuar paraprakisht nga MSHMS mbi kërkesën e prokurorit. Në mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj qarkoreje, është evidentuar se edhe gjatë vitit 2019, nuk është kryer transferimi i të dënuarve me masë mjekësore “*Mjekim i detyrueshëm në institucionet mjekësore*” nga IEVP Krujë dhe IVSH Tiranë në varësi të MD-së, në institucionet mjekësore të posaçme në ambientet e përshtatura të IVSH Tiranë dhe dy godinat 4 dhe 5 të IEVP Lezhë, të kaluara në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS, si detyrim i shtetit për trajtimin në institucione të vecanta shëndetsore dhe rehabilitimin e shëndetin të këtij grupi personash.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandim e rezolutës, për faktin se, në vitet 2018-2019 janë nxjerr 10 udhëzime të përgjithshme, ku përfshihet dhe garantimi i të drejtave e lirive kushtetuese e ligjore të shtetasve në procesin penal, si dhe është kryer dhe vijon mbikëqyrja e zbatimit të tyre nga prokurorët e drejtuesit e prokurorive në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe nga strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

xx) Në zbatim të rekomandimit për “*Rritjen e angazhimit të prokurorisë për zbatimin e rekomandimeve të Progresraportit të Bashkimit European në lidhje me ndjekjen penale dhe luftimin e kriminalitetit*”, Prokuroria, si organ kushtetues dhe subjekt i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë penale, është angazhuar në bashkëpunimin, veçanërisht me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, në dhënien e kontributit dhe progresit të saj në përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit European për Shqipërinë në kuadër të procesit integruar të vendit.

-Në zbatim të rekomandimeve në progres raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, ministrinë përgjegjëse, sipas kapitujve, kanë hartuar planin e masave afatshkurtra, për të cilët prokuroria ka identifikuar edhe mënyrën e adresimit në masa e aktivitete konkrete që i shërbejnë realizimit.

Prokuroria e Përgjithshme periodikisht raporton në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të strukturave të BE-së, ku prokuroria është e përfshirë, si dhe periodikisht ka marrë pjesë me përfaqësuesit e saj në përbërje të delegacionit në takimet raportuese BE-Shqipëri.

¹⁶ Shih, nenet 463, 466 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nenet 9, 12, 45 e vijues të ligjin nr. 8331/1998 “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*” i ndryshuar dhe nenin 28 e vijues të ligjit nr.44/2012 “*Për shëndetin mendor*”.

-Kontribut të rëndësishëm kemi dhënë edhe në kuadër të procesit screening. Ekspertët e prokurorisë së bashku me grupet ndërinstitucionale të punës në ministritë përgjegjëse, kanë kryer analizë të detajuar të legjislacionit shqiptar në raport me atë të BE-së. Aktet e analizuara përfshijnë, konventa, vendime të Komisionit dhe të Këshillit, direktiva, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe, rezoluta etj., të ndara sipas fushave të “acquis” për kapitujt respektivë, ku kontributi institucional kryesor ka qenë në kapitujt 23 e 24, por është kërkuar e siguruar përfaqësim edhe në kapituj të tjerë si, kapitulli 32 “Kontrolli Financiar”.

-Angazhimi i prokurorisë në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL të KiE-së dhe ICRG/FATF, është veçanërisht i rëndësishëm, siç e parashtruam edhe në zbatimin e rekomandimeve më sipër, në pikën “i) *Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit*”, dhe në pikën “ii) *Sigurimi e zbatimi i drejtë dhe i njëllojtë i procedurave për sa u takon hetimeve pasurore, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve...hetimet financiare paralele*”. Prokuroria e Përgjithshme periodikisht informon/raporton progresin në Drejtorinë e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Moneyval të KiE-së dhe në vijim të masave të Planit Veprimit ICRG/FATF, ku prokuroria është e përfshirë, si dhe ka marrë pjesë me përfaqësuesit e saj në përbërje të delegacionit në takimet raportuese në Komitetin Moneyval dhe në ICRG/FATF.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar për vitin 2019 dhe në proces zbatimi për vitin 2020 edhe këtë rekomandim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Kontributi për reformimin e kuadrit ligjor në Kuvendin e Shqipërisë

Marrëdhëniet e prokurorisë me Kuvendin e Shqipërisë janë mbështetur në raporte bashkëpunimi dhe korrekte për forcimin e kuadrit ligjor. Në kuadrin e vijimit gjatë vitit 2019 të kontributit gjithëpërfshirës të reformës në drejtësi, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme kanë kontribuar dhe kontribojnë për reformimin e kuadrit ligjor, duke u përfshirë në grupe punë në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe/ose në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, si më poshtë:

- Projektligji “Për shtesa e ndryshime në Kodin Penal”;
- Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”;
- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Projektligji “Për dhënie amnistie”;
- Etj.

2. Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”

Në zbatim të nenit 103 pika 3, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Rekomandimet Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019” të miratuar me vendimin nr.296, datë 10.05.2019 të Këshillit të Ministrave¹⁷, u përcollën në prokurori nga Ministria e Drejtësisë dhe ju bënë të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjithë niveleve në mbledhjen e përbashkët të organizuar në datë 13.05.2019.

Përveç sa u trajtua më sipër lidhur me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, gjejmë me vend që t’ju bëjmë me dije masat e tjera të marra në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019, si vijon:

i) Prokurori i Përgjithshëm, si në zbatim të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës, ashtu dhe për problematika të tjera të konstatuara dhe të nevojshme për rregullime unifikuese në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, gjatë vitit 2019 ka nxjerrë udhëzimet e përgjithshme dhe akte të tjera normative, si vijojnë:

- ✓ Udhëzimi i Përgjithshëm nr.2, datë 24.05.2019 për "*Zbatimin e ligjit lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë*" me synim, unifikimin e zbatimit të ligjit¹⁸ lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë për të garantuar ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në këto institucione të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) dhe/ose rritjen e efektivitetit në parandalimin e komunikimit të dënuarve apo të paraburgosurve me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata kriminale të tjera.
- ✓ Urdhëri nr.101, datë 12.06.2019 "*Për miratimin e rregullores "Për emërimin e zëvendës drejtuesit të prokurorisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm"* me synim, për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes dhe mënyrën e organizimit të procesit për emërimin e zëvendës drejtuesit të prokurorive, si dhe për të parandaluar mungesën e drejtimit të prokurorive me juridiksion për përgjithshëm.
- ✓ Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 3, datë 21.06.2019 "*Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve*", me synim unifikimin e masat në prokuroritë me juridiksion të

¹⁷ Shih, vendimi nr.296, datë 10.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rekomandimeve Prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”, publikuar nga QPZ në F.Zyrtare Nr.68 datë 13.05.2019.

¹⁸ Shih, ligjin nr.8328/1998, i ndryshuar me ligjin nr. 108/2018, datë 20.12.2018, hyre në fuqi me datë 31.01.2019, FZ Nr.197 e vitit 2018.

përgjithshëm, si për verifikimin e integritetit të personave/kandidat për tu zgjedhur, ashtu dhe për rritjen e efektivitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para dhe pas zgjedhore, si dhe për parandalimin e përgjithshëm të veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

- ✓ Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 5, datë 30.07.2019 “*Marrëdhëniet me Publikun në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm*”, me synim unifikimin e marrëdhënieve me publikun dhe median në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm për rritjen e transparencës si një mundësi që publiku të njohë punën e prokurorisë në mbrojtje të të drejtave të tij, për rritjen e besimit të publikut në sistemin e prokurorisë dhe inkurajimin për pjesëmarrjen e tij në parandalimin dhe denoncimin e krimit.
- ✓ Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 8, datë 04.12.2019 “*Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet ndërmjet e tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*”, me synim për të unifikuar, të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me drejtuesit e prokurorive si prokuror më të lartë dhe informimin e kordinimin në veprimtarinë e prokurorisë, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, efencën, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur.
- ✓ Udhëzimi i Përgjithshëm nr.9, datë 11.12.2019 “*Mbi masat administrative dhe proceduriale në prokuroritë për krimet e rënda dhe në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm me fillimin e funksionimit të prokurorisë së posaçme*”, me synim për të unifikuar masat administrative dhe proceduriale penale në prokuroritë pranë gjykatave për krime të rënda dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për transferimin e procedimeve/çështjeve në hetim sipas kompetencës lëndore dhe/ose toksore të parashikuar në ligj¹⁹, me krijimin dhe fillimin e funksionit të Prokurorisë së Posaçme, në zbatim të parimit të ligjshmërisë, për të garantuar si respektimin e të drejtave dhe lirive të personave nën hetim, të pandehurve dhe viktimave të veprave penale, ashtu dhe ruajtjen e sekretit të hetimeve dhe ndalimin e publikimit të akteve proceduriale penale.
- ✓ U hartua një rregullore e posaçme për komunikimet me Eurojust-in, e cila u miratua me Urdhrin nr.140, datë 03.09.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.

¹⁹ Shih, nenin 75/a dhe pikën 5 të dispozitës kalimtare në Kodin e Procedurës Penale, si dhe nenet 3, 6 dhe pikën 6 te dispozitës kalimtare të ligjit nr.10192/2017, të cituara mësipër.

Në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm për të monitoruar si zbatimin, ashtu dhe si kanë ndikuar udhëzimet e përgjithshme në forcimin e ligjshmërisë dhe efektivitetin në luftën kundër kriminalitetit në fushat përkatëse, ka kërkuar informacione drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, si për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët për çështje konkrete, me synim, që të garantojnë pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe të sigurojnë efikasitetin, ligjshmërinë e transparencën në veprimtarinë e prokurorive që drejtojnë.

-Përveç sa u trajtua më sipër lidhur me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, gjejmë me vend që t'ju bëjmë me dije masat e tjera të marra në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019 si vijojnë:

ii) Në zbatim të rekomandimit për **“Rritjen e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore”**, Prokuroria e Përgjithshme ka vlerësuar dhe vlerëson rëndësinë e aksesit në bazat e të dhënave për shpejtësinë, cilësisë dhe efektivitetin e hetimeve. Për vitin 2019, ka përcaktuar si objektiv tre databaza:

-Regjistri elektronik i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dhe -Regjistri elektronik i recetave me rimbursim, për të cilat, është rënë dakort në parim me institucionet respektive dhe po vijojmë komunikimet në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Ndërsa, -Regjistri i Barrëve Siguruese në kuadrin e komunikimeve paraprake dy palëshe jemi informuar se mundësitë teknike për realizimin e këtij aksesit kërkojnë investime shtesë dhe kohë.

-Ndërkohë, pas marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2017-s, lidhja midis Sistemit të Menaxhimit të Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Prokurorisë është testuar dhe së afërmi kjo ndërlidhje do të bëhet funksionale.

-Nga ana tjetër, eksperiencia ka evidentuar se procesi nga negociimi i marrëveshjeve apo memorandumeve të bashkëpunimit deri në aksesimin e databazave, është një proces i vështirë, që përfshin si vlerësimin ligjor të nivelit të aksesueshmërisë ku faktor shumë i rëndësishëm është baza ligjore, mbrojtja e të dhënave personale, pronësia intelektuale etj, ashtu dhe vlerësimin e kushteve teknike apo kostove të nevojshme për realizimin e aksesit. Konkretisht:

Gjatë vitit 2019, prokuroria ka kërkuar aksesin në databaza të “Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor” dhe “Baza e të dhënave Shtetërore të Shërbimit Noterial Shqiptar”, për të cilat kemi nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit në vitin 2016, në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr.304, datë 21.05.2014 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, regjistri noterial shqiptar (RNSH)”, dhe nr.443, datë 16.06.2011 “Për krijimin, regjistrimin,

mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor (ALBIS)", duke i konfirmuar Ministrisë së Drejtësisë gatishmërinë për rishikimin e memorandumit dhe inicimin e nismës për miratimin e ndryshimeve përkatëse, nëse Ministria e Drejtësisë vlerëson të nevojshëm rishikimin e tij dhe marrjen e masave për realizimin e aksesit.

iii) Në zbatim të rekomandimit për "**Mbajtjen në konsideratë të nevojës për zbatimin e ligjit nr. 108/2018 për vendosjen në regjimin e posaçëm të të dënuarve/parburgosurve për veprat penale të parashikuara nga ky ligj**", Prokuroria e Përgjithshme dhe drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kanë marrë masat e duhura për zbatimin e këtij rekomandimi.

-Prokurori i Përgjithshëm në zbatim të ligjit nr.108/2018²⁰ nxorri udhëzimin e përgjithshëm nr.2, datë 24.05.2019 për "Zbatimin e ligjit lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë", në të cilin janë normuar rregullat për mënyrën e zbatimit të kushteve dhe kriterëve të këtij ligji nga drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda për t'i kërkuar Ministrit të Drejtësisë vendosjen e të dënuarit ose të paraburgosurit në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë, me synim për të garantuar ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në këto institucione të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin e komunikimit të dënuarve apo të paraburgosurve me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata kriminale të tjera.

-Ndërkohë, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në zbatim të ligjit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr.2/2019 më sipër, ka organizuar takime në kuadrin e bashkërendimit me institucionet e përfshira dhe janë grumbulluar informacione dhe administruar aktet e nevojshme provuese për paraqitjen e kërkesave drejtuar Ministrit të Drejtësisë. Gjithashtu, është bashkërenduar me Ministrinë e Drejtësisë dhe janë bërë gati kërkesat e para për zbatimin e ligjit nr.108/2018.

-Me krijimin dhe fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, me datë 19 Dhjetor 2019, zbatimi i këtij ligji është në kompetencë të drejtuesit të kësaj prokurorie.

iv) Në zbatim të rekomandimit për "**Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit, veçanërisht në rastet e korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë**", prokuroria pranë gjykatës për krime të rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, gjatë vitit 2019 për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar për kryerjen e vepra penale korruptive, kërkesat e prokurorit për caktimin e masave të sigurimit personal në 92,5% të rasteve janë për caktimin e masës sigurimit "arrest në burg", ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, për mbi 46,4

²⁰ Shih, ligjin nr.8328/1998, i ndryshuar me ligjin nr. 108/2018, datë 20.12.2018, hyre në fuqi me datë 31.01.2019, FZ Nr.197 e vitit 2018.

% të personave kanë qenë për caktimin e dënimit me burgim ose në shifra përafërsisht të njëjta krahasuar me vitin 2018.

v) Në zbatim të rekomandimit “*Hetime të shpejta, efektive, dhe ashpërsim të dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*”, Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nënshkruan në Mars 2019 një memorandum bashkëpunimi, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore. Palët morën përsipër në këtë memorandum kallëzimin dhe hetimin me përparësi të veprave penale në fushën e zgjedhjeve ku më sensitive janë rastet e korrupsionit aktiv e pasiv në zgjedhje.

-Në këtë kuadër, Prokuroria e Përgjithshme nxorri udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “*Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve*”, me synim unifikimin e masave në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si për verifikimin e integritetit të personave/kandidat për t’u zgjedhur, ashtu dhe për rritjen e efektivitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para dhe pas zgjedhore, si dhe për parandalimin e përgjithshëm të veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

-Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm drejtuesit e prokurorive morën masat e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gadishmërisë në periudhën para dhe pas zgjedhore. Në Prokurorinë e Përgjithshme, kanë raportuar periodikisht të dhëna për veprat penale që kanë prekur zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, raporte të cilat janë publikuar në faqen zyrtare (web:www.pp.gov.al).

-Referuar të dhënave statistikore evidentohet se në periudhën janar- dhjetor 2019 janë regjistruar 23 procedime penale me 15 të pandehur për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Gjatë kësaj periudhe 2 çështje penale me 5 të pandehur janë dërguar për gjykim, prej te cilëve 4 të pandehur janë deklaruar fajtor dhe dënuar.

vi) Në zbatim të rekomandimit për “*Ashpërsim të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të të fëmijëve*”, Prokuroria e Përgjithshme në vitin 2019 ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.5/2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, “*Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale*” duke u fokusuar në mbrojtjen e grupeve vunerabël dhe viktimave të veprave penale.

-Në zbatim të këtij rekomandimi, të dhënat statistikore tregojnë se, kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer krime seksuale janë të ashpra, ku 94 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe vetëm për 6 % është kërkuar caktimi i detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Krahasuar me vitin 2018, ky raport është ndryshuar në drejtim të ashpërsimit të politikës penale të ndjekur, pasi ka qenë 81,4% masa me arrest dhe 19,6% detyrim paraqitje.

-E njëjta politikë vërehet edhe në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime. Kështu, 80 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 20% për caktimin e alternativave të dënimit me burg. Krahasuar me vitin 2018, ky raport është sërish më i ashpër, pasi ka qenë 66 % burg dhe 34 % alternativa të dënimit me burgim.

-Sa i përket politikës penale në veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të dhënat tregojnë se, kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këto vepra janë të ashpra, ku 85,6 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe për 14,4 % është kërkuar caktimi i detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime rezulton se 60 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 40 % për caktimin e alternativave të dënimit me burg.

vii) Në zbatim të rekomandimit për ***“Rritje të kërkesave për dhënien e dënimeve alternative për autorë dhe vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore”*** Prokuroria e Përgjithshme, ka mbikëqyr zbatimin e këtij rekomandimi nëpërmjet informacioneve lidhur me kërkesat e prokurorëve për dhënien e dënimeve alternative të dënimeve me burgim për autorët e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore që dispozitat e Kodit Penal parashikojnë dënime deri në 5 (pesë) vjet burgim. Në vitin 2019, për grup veprat penale që parashikojnë dënime deri në 5 (pesë) vjet burgim kërkesat e prokurorëve për dhënien e dënimeve alternative të dënimit me burgim sipas neneve 59 e 63 të K.Penal zënë 64,7 % të kërkesave për caktimin e dënimeve për këtë grupveprash, ndërkohë vendimet e gjykatave për caktimin e dënimeve alternative të dënimit me burgim për këtë grupveprash zënë 69,2 % të vendimeve të dënimit të dhënë nga gjykatat për këtë grupveprash.

viii) Në zbatim të rekomandimit për ***“Forcimin e koordinimit ndërinstitutional në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar, pastrimit të parave, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integritetit të vendit”*** prokuroria ka koordinuar e bashkëpunuar me institucionet e tjera shqiptare dhe ka përgatitur e përcjellë statistikën e harmonizuar dhe track record, për periudha gjashtë mujore e vjetore.

3. Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësorë të veprimtarisë së institucionit

i) Tregues të përgjithshëm të efektivitetit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të çështjeve/akuzave në gjyq

Gjatë vitit 2019 janë përfunduar 28180 çështje që përbën ulje prej 7,49 % të çështjeve të përfunduara krahasuar me vitin 2018, prej të cilave: 36,89 % janë dërguar për gjykim, 20,66 % janë pushuar, 35,80 % janë pezulluar dhe 6,65 % janë transferuar në prokuroritë kompetente.

Janë dërguar në gjykatë 10396²¹ çështje me akuzë ndaj 12158 të pandehurve. Krahasimisht me vitin 2018 rezulton një ulje prej 11,8 e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 9,29 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 janë dënuar 8899 të pandehur dhe për 188 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm ose krahasuar me vitin 2018 me ulje 13,1 % e numrit të pandehur të dënuar dhe ulje 10,9 % e numrit të pandehurve të deklaruar të pafajshëm.

Në gjykatë janë dërguar 740 kërkesa për miratim të urdhrit penal në lidhje me 761 të pandehur ose krahasuar me vitin 2018 me rritje 25,2 % të kërkesave dhe rritje 22,9 % të pandehurve për miratimin e urdhërit penale, ndërsa nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të urdhrit penal në 20 raste ose krahasuar me vitin 2018 me ulje 53,4 % të rasteve që është vendosur nga gjykata refuzimi i miratimit të urdhrit penal.

Në gjykatë, gjithashtu, janë dërguar 734 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë në lidhje me 745 të pandehur ose krahasuar me vitin 2018 me rritje 28,7 % të kërkesave dhe rritje 19,9 % të pandehurve për miratim marrëveshje, ndërkohë nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes në 43 raste ose krahasuar me vitin 2018 me ulje 13,1 % të rasteve që është vendosur nga gjykata refuzimi i miratimit të marrëveshjes.

Gjatë vitit 2019, u dërguan në gjykatë për pushim 4379 3034 çështje ose me rritje 67,9 % krahasuar me vitin 2018. Nga të dhënat rezulton se për 214 çështje gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ose me rritje 26.6 % krahasuar me vitin 2018, ndërsa në 12 çështje vendosi kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës, shifër e njëjtë e krahasuar me vitin 2018.

²¹ 26 çështje me akuzë ndaj 31 të pandehurve bazuar në Kodin Penal Ushtarak

Ndërsa, gjatë vitit 2018 është kërkuar gjykimi i drejtëpërdrejtë për 220 çështje me 232 të pandehur.

ii) Efektiviteti i ndjekjes penale sipas grupveprave penale që evidentohen me tendencë në rritje dhe/ose në ulje.

- Lidhur me veprat penale të korrupsionit, të dhënat statistikore të vitin 2019 evidentojnë se raporti i çështjeve të dërguara në gjyq është në përqindje më të ulët se çështjet e pushuara, përkatësisht 34,52 % e çështjeve janë dërguar gjyqit dhe 65,48 % e çështjeve janë pushuar. Ndërkohë, që gjatë kësaj periudhe vërehet edhe ulje prej 9,88 % e numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2018.

- Lidhur me krimin e organizuar, të dhënat statistikore të vitit 2019, tregojnë se ndjekja penale ka qenë efiçente, ku çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 86,67 % të dërguara në gjyq me 13,33 % të pushuara. Në këtë periudhë raportuese, çështjet e regjistruara paraqesin ulje prej 2,10 % krahasuar me vitin 2018.

- Lidhur me veprat penale të trafiqeve të paligjshme, në vitin 2019, treguesi i efektivitetit duke krahasuar numrin e çështjeve të dërguara në gjyq me numrin e çështjeve të pushuara është relativisht i ulët, përkatësisht 47,46 % dërguar gjyqit dhe 52,54 % të pushuara. Ndërkohë nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 3,87 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafiqeve të paligjshme në krahasim me vitin 2018.

-Sa i përket veprave penale lidhur me narkotikët, edhe pse në vitin 2019 ka një rritje prej 2,96 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2018, ndjekja penale ka rezultuar efektive. Kështu, çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 62,45 % dërguar gjyqit dhe 37,55 % të pushuara.

-Efektiviteti i ndjekjes penale për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në vitet 2015 – 2019 evidenton tregues të ulët të raportit të çështjeve penale të dërguara në gjyq krahasuar me çështjet e pushuara, raport i cili varjon nga 10% deri 20% e çështjeve të dërguar gjyqit me 80% deri 90% e çështjeve të pushuara. Ndërkohë, në vitin 2019 kjo tendencë është shoqëruar dhe me uljen 12,27 % të procedimeve të regjistruara për veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, krahasuar me vitin 2018.

- Në vitin 2019 ka një ulje prej 17,14 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në krahasim me vitin 2018. Por, ndjekja penale ka qenë efiçente për faktin se janë dërguar për gjykim 81,68 % të çështjeve dhe janë pushuar 18,32 % çështjeve.


- Efektiviteti i ndjekjes penale ka qenë i lartë edhe lidhur me dhunën në familje, ku çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 84,33 % dërguar gjyqit dhe 15,67 % të pushuara. Në të njëjtën periudhë raportuese, çështjet e regjistruara paraqesin rritje prej 24,39 % krahasuar me vitin 2018. Për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal “Dhuna në familje”, në vitin 2019 vërehet ulje prej 5,71 % e procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2018, por vlerësojmë se duhet bërë në aspektin parandalues të saj, duke nisur që me edukimin e shoqërisë në moshë të hershme, ndërgjegjësimin e grupeve vunerabël për të drejtat e tyre dhe lehtësimin e aksesit në institucionet ligjzbatuese e në drejtësi.

- Lidhur me veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, treguesi i efektivitetit duke krahasuar numrin e çështjeve të dërguara në gjyq me numrin e çështjeve të pushuara është relativisht i ulët, përkatësisht 40,27 % dërguar gjyqit dhe 59,73 % të pushuara. Në këtë tregues ka ndikuar dhe fakti se vepra penale regjistrohet pa prituri rezultatet e aktit të ekspertimit autoteknik apo mjekoligjor. Nga ana tjetër të dhënat statistikore në vitin 2019, evidentojnë tendencë në rritje prej 5,57 % të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në krahasim me vitin 2018. Ndërkohë, e kundërta vërehet lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale të nenit 291 të Kodit Penal, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, ku përqindja e procedimeve dërguar gjyqit është 94,45 % dhe përqindja e procedimeve të pushuara është 5,55 %. Gjithashtu, në vitin 2019 vërehet edhe tendenca në ulje prej 4,79 % e procedimeve të regjistruara, krahasim me vitin 2018.

iii) Efektiviteti i përgjimit të komunikimeve elektronike në hetimet paraprake


Gjatë vitit 2019, në kuadrin e 717 procedimeve penale, me anë të përdorimit të mjeteve të posaçme hetimore, në zbatim të kriterëve ligjore, është arritur në arrestimi/ndalimi i 713 personave të dyshuar për krime kundër rendit dhe sigurisë publike, kundër jetës dhe kundër autoritetit të shtetit, dhe për vepra penale kundër lirisë së personit, në fushën e narkotikëve, korrupsion e shpërdorim detyre, trafikeve apo vepra të tjera të rënda, duke parandaluar kështu pasoja e mëtejshme për shtetin dhe shtetasit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet procedimet sipas grupveprave penale për të cilat është kërkuar përgjimi i komunikimeve elektronike në hetimet paraprake:



Në shifra të përgjithshme, gjatë vitit 2019 janë ekzekutuar gjithsej 2714 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, aplikuar në lidhje me 717 procedime penale. Nga këto, 141 procedime penale kanë qenë në kuadër të hetimeve të prokurorisë për krime të rënda. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 5574 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

Ecuria e këtij mjeti kërkimi prove në 3 vitet e fundit paraqitet në grafikun në vijim:




II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT, TË DHËNA PËR NUMRIN, LLOJET, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE FORMAT E KRIMINALITETIT

2.1 VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2019²²

Gjatë vitit 2019, në organin e prokurorisë janë trajtuar 59888²³ materiale kallëzuese që përbën një rritje prej 3,73 % në krahasim me vitin 2018. Janë ndjekur gjithsej 44289 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 3,45 % në krahasim me vitin 2018, nga të cilat 30748 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 2,10 % në krahasim me vitin 2018 dhe 584 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 20,16 % në krahasim me vitin 2018. Janë mbartur nga viti 2018, 12957 procedime penale me një rritje prej 18,66 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2018. Është vendosur mosfillimi për 15599 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një rritje prej 4,55 % në krahasim me vitin 2018.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2019 paraqitet si vijon:




²² Procedimi penal nuk njësohet me vepër penale, pasi:

- 1- Sistemi statistikor i prokurorisë regjistron të dhëna për veprën penale më të rëndë, pavarësisht se mund të jenë kryer disa vepra penale.
- 2- Në bazë të nenit 79 e 93 të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendos bashkimin ose ndarjen e procedimeve.

²³ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura nga viti 2018; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2019 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2019; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2019.

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike volumi i punës i prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, prokurorive p ranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018:




2.2 ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Gjatë vitit 2019 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 10422 procedime penale (ulje prej 11,69 % në krahasim me vitin 2018) me 12189 të pandehur (ulje prej 9,13 % në krahasim me vitin 2018). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 12288 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal.

Nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 2583 çështje themeli (ulje prej 46,04 % në krahasim me vitin 2018) dhe 2221 raste për masat e sigurimit personal (ulje prej 5,61 % në krahasim me vitin 2018).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 5 çështje dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 1 çështje.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në përqindje për çështjet e përfaqësuara në gjykatë në të tre shkallët:




2.3 TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT

Procedime të regjistruara

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 janë regjistruar 32497 procedime penale që do të thotë ulje prej 4 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë regjistruar 31305 procedime penale që përbën ulje prej 3,6 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 janë regjistruar 31481 procedime penale që përbën rritje prej 0,56 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 janë regjistruar 31409 procedime penale që përbën ulje prej 0,23 % krahasuar me vitin 2017 dhe në vitin 2019 janë regjistruar 30748 procedime penale që përbën ulje prej 2,10 % krahasuar me vitin 2018.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet penale të regjistruara në pesë vitet e fundit nga organi i prokurorisë:



Procedime në ndjekje

Nga të dhënat statistikore në vitin 2015 rezultojnë 44077 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 0,6 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezultojnë 41690 procedime në ndjekje penale që përbën ulje prej 5,4 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 rezultojnë 40911 procedime në ndjekje penale që përbën ulje prej 1,87 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 rezultojnë 42814 procedime në ndjekje penale që përbën rritje prej 4,65 % krahasuar me vitin 2017 dhe në vitin 2019 rezultojnë 44289 procedime në ndjekje penale që përbën rritje prej 3,45 % krahasuar me vitin 2018.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë në pesë vitet e fundit:



Ndjekja penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak

Pesha specifike që zënë procedimet penale të regjistruara në bazë të Kodit Penal Ushtarak në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2019 është 0,17 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 0,06.


Grafikët në vijim paraqesin të dhënat e volumit të punës në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës, për veprat penale në fushën e zbatimit të Kodit Penal Ushtarak:



Siç vërehet nga grafiku, në vitin 2019, janë regjistruar 53 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak, janë mbartur 7 procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 3 kallëzime/referime.

Gjatë vitit 2019 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 26 procedime penale me 31 të pandehur në bazë të Kodit Penal Ushtarak.

Procedimet penale janë regjistruar për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal Ushtarak që paraqiten në grafikun në vijim:



Në vijim të dhënat lidhen me vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, ligji nr.7895/1995 i ndryshuar.

Çështje të përfunduara

Në lidhje me **çështjet e përfunduara**²⁴, të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2015 rezulton një rritje prej 5,6 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezulton një ulje 5,9 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2015, në vitin

²⁴ Në këtë tregues përveç çështjeve të pushuara, pezulluara dhe dërguar gjyqit mblidhen edhe çështjet e transferuara.

2017 rezulton një ulje 9,3 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një rritje prej 1,93 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 rezulton një ulje prej 7,95 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me **çështjet e pushuara**, në vitin 2015 rezulton një rritje prej 2 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezulton një ulje prej 6,6 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një rritje prej 3,2 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një rritje prej 1,74 % e çështjeve të pushuara²⁵ në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 rezulton një ulje prej 12,53 % e çështjeve të pushuara²⁶ në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me **çështjet e pezulluara**, në vitin 2015 rezulton një rritje prej 4 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezulton një rritje e lehtë prej 0,2 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një ulje prej 13,4 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një ulje prej 2,69 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 rezulton një ulje prej 7,30 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me **çështjet e dërguara në gjykatë**, në vitin 2015 rezulton një rritje prej 7,7 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 rezulton një ulje prej 11,2 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një ulje prej 11,6 % e çështjeve të dërguara në gjykatë²⁷ në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një rritje prej 2,59 % e çështjeve të dërguara në gjykatë²⁸ në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 rezulton një ulje prej 11,82 % e çështjeve të dërguara në gjykatë²⁹ në krahasim me vitin 2018.

Lidhur me numrin e të pandehurve të dërguar në gjykatë vërehet se në vitin 2015 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur 7 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2016 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 11,4 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 14,5 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur me 4,65 % krahasuar me vitin 2017 dhe në vitin 2019 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 9,29 % krahasuar me vitin 2018.

²⁵ Në këtë tregues përfshihen çështje të pushuara nga prokurori dhe nga gjykata.


²⁶ Në këtë tregues përfshihen çështje të pushuara nga prokurori dhe nga gjykata.

²⁷ Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake si dhe kërkesat për miratimin e urdhrit penal dhe marrëveshjes së fajësisë.


²⁸ Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake si dhe kërkesat për miratimin e urdhrit penal dhe marrëveshjes së fajësisë.

²⁹ Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake si dhe kërkesat për miratimin e urdhrit penal dhe marrëveshjes së fajësisë.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e pesë viteve të fundit:



Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake:




Vendimmarrja e gjykatës

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për **pushimin e çështjeve**, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq në vitin 2015 përbën 2,3 %, në vitin 2016 ky tregues përbën 2,5 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2017 ky tregues përbën 8,2 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2018 ky tregues është 1,43 % dhe në vitin 2019 ky tregues është 1,74 %.

Në lidhje me **pushimin e akuzës** për të pandehurit, në vitin 2015 është vendosur pushimi i akuzës për 0,08 % të akuzave të ngritura, në vitin 2016 për 0,1 % të numrit të akuzave të ngritura, në vitin 2017 për 0,4 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës, në vitin 2018 për 0,12 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës dhe në vitin 2019 për 0,10 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës.

Në lidhje me **vendimet e gjykatës për pafajësinë**, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 është dhënë pafajësi për 2,47 % të të pandehurve të dërguar në gjykatë, në vitin 2016 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 2,5 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2017 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 2,6 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2018 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,57 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2019 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,55 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate.

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë në pesë vite, 2015-2019:




Pezullimet

Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokuroria është organi kompetent për të vendosur pezullimin e hetimeve kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore dhe nga ana tjetër hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendimin e prokurorit.

Ky tregues për vitin 2019 përbën 35,80 % të procedimeve për të cilat ka përfunduar hetimi. Të dhënat tregojnë se ndër 10088 procedime të pezulluara, 10084 prej tyre janë pezulluar për shkak se nuk njihet autori i veprës penale dhe 4 procedime janë pezulluar për shkak se i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për procedimet e pezulluara në vitet 2015-2019:



Në lidhje me procedimet e pezulluara nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015, numri i procedimeve të pezulluara është rritur me 4,2 %, në vitin 2016 numri i procedimeve të pezulluara ka një rritje të lehtë prej 0,2 %, në vitin 2017 numri i procedimeve të pezulluara është ulur me 13,4 %, në vitin 2018 numri i procedimeve të pezulluara është ulur me 2,69 %, ndërsa në vitin 2019 numri i procedimeve të pezulluara është ulur me 7,30 %.


Për vitin 2019, procedimet penale të pezulluara sipas grup veprave penale paraqiten grafikisht si më poshtë (në grafik nuk janë përfshirë procedimet e pezulluara për grup veprat penale numri i të cilave është më i ulët se 20):



Mosfillimet

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 14452 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 8 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2014, në vitin 2016 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 15655 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 8,3 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2015, në vitin 2017 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 17378 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 11 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2016, në vitin 2018 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 14920 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 14,15 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2017 dhe në vitin 2019 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 15596 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 4,53 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2018.

Të dhëna të detajuara gjenden në grafikun e mëposhtëm:



2.4 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2018

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Berat** janë regjistruar 994 procedime penale, që do të thotë rritje prej 4,41 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Dibër** janë regjistruar 514 procedime penale, që do të thotë një ulje prej 12,44 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Durrës** janë regjistruar 2819 procedime penale, që do të thotë rritje prej 1,44 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Elbasan** janë regjistruar 2551 procedime penale, që do të thotë rritje prej 7,59 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Fier** janë regjistruar 1727 procedime penale, që do të thotë ulje prej 4,22 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Gjirokastrë** janë regjistruar 742 procedime penale, që do të thotë rritje prej 13,28 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Kavajë** janë regjistruar 552 procedime penale, që do të thotë rritje prej 4,55 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Korçë** janë regjistruar 1406 procedime penale, që do të thotë ulje prej 8,16 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Krujë** janë regjistruar 834 procedime penale, që do të thotë rritje prej 15,99 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Kukës** janë regjistruar 402 procedime penale, që do të thotë rritje prej 3,34 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Kurbin** janë regjistruar 470 procedime penale, që do të thotë rritje prej 4,44 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Lezhë** janë regjistruar 1042 procedime penale, që do të thotë ulje prej 11,47 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Lushnje** janë regjistruar 849 procedime penale, shifër e njëjtë me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Mat** janë regjistruar 172 procedime penale, që do të thotë rritje prej 3,61 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Përmet** janë regjistruar 108 procedime penale, që do të thotë rritje prej 8,00 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Pogradec** janë regjistruar 499 procedime penale, që do të thotë ulje prej 1,58 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Pukë** janë regjistruar 137 procedime penale, që do të thotë rritje prej 1,48 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Sarandë** janë regjistruar 1065 procedime penale, që do të thotë rritje prej 11,99 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Shkodër** janë regjistruar 1671 procedime penale, që do të thotë ulje prej 22,85 % në krahasim me vitin 2018;


Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Tiranë** që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 9612 procedime penale, që përbën ulje prej 2,58 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Tropojë** janë regjistruar 181 procedime penale që do të thotë ulje prej 9,50 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë **Vlorë** janë regjistruar 2078 procedime penale, që do të thotë ulje prej 9,53 % në krahasim me vitin 2018;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për **Krime të Rënda** janë regjistruar 270 procedime penale, që do të thotë rritje prej 28,57 % në krahasim me vitin 2018;

Më poshtë paraqiten të dhënat në përqindje mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2019:



Siç vërehet nga të dhënat, edhe në vitin 2019 numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë me 31,31 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera me shifrat më të larta janë: prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës që ka regjistruar 9,18 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 8,31 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar 6,77 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier që ka regjistruar 5,63 % të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 5,44 % të numrit total të procedimeve të regjistruara dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë që ka regjistruar 4,58 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi.

2.5 KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100.000 BANORË BAZUAR NË SISTEMIN STATISTIKOR TË PROKURORISË

Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara, për 100.000 banorë³⁰ në vitin 2019 është **1072** ndërsa në vitin 2018 koeficienti i kriminalitetit ka qenë **1094**. Në lidhje me koeficientet e kriminalitetit për 100.000 banorë sipas qarqeve, të dhënat statistikore rezultojnë si më poshtë:


Në qarkun Berat që përfshin prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 794; në qarkun Dibër që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 577; në qarkun Durrës që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 1259; në qarkun Elbasan që përfshin prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 928; në qarkun Fier që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier dhe Lushnjë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 874; në qarkun Gjirokastrë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 1384; në qarkun Korçë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 916; në qarkun Kukës që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 761; në qarkun Lezhë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë dhe Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 1208; në qarkun Shkodër që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 891; në qarkun Tiranë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 1135 dhe në qarkun Vlorë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2019 është 1660.

Siç rezulton nga të dhënat, përqindjen më të ulët të koeficientit të kriminalitetit edhe në vitin 2019 e ka qarku Dibër, ndërsa përqindjen më të lartë qarku Vlorë.

Sa i përket tendencës, vërehet se rritjen më të lartë për vitin 2019 e ka qarku Gjirokastrë, 15,39 %, ndërsa në qarkun Shkodër vërehet ulje e koeficientit të kriminalitetit me 20,61 %.

Renditja paraqitet grafikisht në vijim:

³⁰ <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>



2.6 TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 janë filluar kryesisht 115 procedime penale nga ana e prokurorisë.

Kallëzime nga nëpunësit publikë: në vitin 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1438 kallëzime, që do të thotë ulje prej 10,13 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1600 kallëzime, që do të thotë ulje prej 12,18 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1822 kallëzime, që do të thotë rritje prej 17,3 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1553 kallëzime, që do të thotë rritje prej 31,5 % në krahasim me vitin 2015 dhe në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1181 kallëzime.

Kallëzime nga personeli mjekësor: në vitin 2019 rezulton të ketë ardhur në prokurori 1 kallëzim nga personeli mjekësor shifër e njëjtë me vitin 2018, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2 kallëzime nga personeli mjekësor, shifër e njëjtë me vitin 2016, ndërkohë që në vitin 2015 rezulton të ketë ardhur në prokurori 1 kallëzim penal.

Kallëzime nga shtetasit: në vitin 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 3319 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë rritje prej 19,56 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2776 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë rritje prej 1,39 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2738 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë ulje prej 1,9 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2789 kallëzime, që do të thotë rritje prej 34,7 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2070 kallëzime.

Kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim: në vitin 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 199 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim që do të thotë rritje prej 11,17 % krahasuar me një vit më parë, në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 179 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim që do të thotë ulje prej 35,38 % krahasuar me një vit më parë, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 277 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim, që do të thotë rritje prej 19,4 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 232 kallëzime, që do të thotë ulje prej 28,4 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 324 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim.

Gjatë vitit 2019 rezulton të jetë marrë njoftim për 5624 ngjarje, që do të thotë rritje prej 2,24 % në krahasim me vitin 2018, gjatë vitit 2018 rezulton të jetë marrë njoftim për 5501 ngjarje, që do të thotë ulje prej 5,6 % në krahasim me vitin 2017, gjatë vitit 2017 rezulton të jetë marrë njoftim për 5828 ngjarje, që do të thotë ulje prej 13,7 % në krahasim me vitin 2016, gjatë vitit 2016 rezulton të jetë marrë njoftim për 6757 ngjarje, që do të thotë rritje prej 22 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 është marrë njoftim për 5535 ngjarje.

Gjatë vitit 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 36760 **referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera** që përbën ulje prej 0,20 në krahasim me vitin 2018, gjatë vitit 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 36835 referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera që përbën rritje prej 2,52 në krahasim me vitin 2017, gjatë vitit 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 35929 referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera, që do të thotë rritje prej 15,7 % në krahasim me vitin 2016, gjatë vitit 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 31063 referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera, që do të thotë ulje prej 6,7 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 janë marrë 33306 referime.


2.7 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 urdhrat për ekzekutim të dënimeve kryesore me burgim, gjobë e dënime plotësuese, zënë 41,66 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori, ndërsa urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative

zënë 58,34 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori. Krahasuar me vitin 2018, urdhrat e ekzekutimit për dënime me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë dhe dënime plotësuese kanë pësuar një ulje prej 16,42 %, ndërsa dënimet alternative kanë pësuar një ulje prej 15,58 %.

Gjatë vitit 2019 janë ekzekutuar 7021 vendime penale të formës së prerë, ndërsa kanë mbetur pa u ekzekutuar 3952 vendime. Numri i vendimeve sipas llojit të tyre të mbetura pa ekzekutuar është 6 dënime me burgim të përjetshëm, 553 vendime me burgim, 1584 vendime për dënimin me gjobë, 42 dënime plotësuese dhe 1767 dënime alternative.


Sa më sipër paraqitet në grafikun në vijim:




2.8 KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2019, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara në prokurori sipas veprave penale:



Procedime të regjistruara sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2018-2019:



Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, rezulton si vijon:

- Raporti që zënë **krimet kundër njerëzimit**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 1,41 %³¹;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,02 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 2,94 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,04 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 1,30 %;
- Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,51 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,42 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,90 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 4,06 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 31,50 %;
- Raporti që zënë **mashttrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 2,43 %;
- Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 4,10 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,27 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtarinë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,06 %;
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,52 %;

³¹ Përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë.

- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 1,35 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,28 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 3,87 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në fushën e falimentimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0 %;
- Raporti që zënë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,47 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 6,22 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,86 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër pavarësisë dhe integritetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,00 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër rendit kushtetues** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0 %;
- Raporti që zënë **veprat me qëllime terroriste** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,03 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 2,08 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 3,25 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 23,85 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 4,75 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 2,22 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,11 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,17 %;

Këto të dhëna paraqiten grafikisht si më poshtë:

2.9 ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL**KRIME KUNDËR NJËRËZIMIT**

Në vitin 2019 është regjistruar 1 procedim penal në lidhje me krimet e parashikuara në Kreun I të Kodit Penal, “Krime kundër njerëzimit”, e konkretisht për nenin 74 “Krime kundër njerëzimit”.

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike³² që zë ky grup veprash penale për vitin 2019 është 1,32 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2018 ky grup veprash përbënte 1,56 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 14,18, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 17,07.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun II, Seksioni I, “Krime kundër jetës të kryera me dashje”:

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj. 33	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënua r
Neni 76 Vrasja ³⁴	30	3	17	3	13	33	11	23	18	7
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	47	10	27	16	21	49	21	50	31	9
Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje	1	1	0	2	1	0	0	0	0	0
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	25	10	19	11	13	36	17	34	26	14
Neni 79/a Vrasja e	2	0	2	0	0	1	0	1	0	0

³² “Pesha specifike” është llogaritur si raport i grupveprave të renditura në tabelë me numrin total të procedimeve të regjistruara. Për shkak të grupimit të veprave jo gjithmonë sipas strukturës së Kodit Penal, por edhe sipas fushës, mund të mos ketë përputhje midis këtij treguesi dhe raportit të grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal.

³³ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.


³⁴ Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë 28 procedime regjistruar dhe 29 të pandehur regjistruar).

funkionarëve publikë										
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	4	2	5	4	2	1	1	1	1	0
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	14	13	17	13	10	17	10	14	12	13
Neni 80	0	0	0	0	3	3	0	2	0	0
Neni 81 Vrasja e foshnjës	3	0	0	0	0	0	0	0	0	
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	0	0	1	1	0	0	2	0	2	2
Neni 83 Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	2	3	2	3	0	0	0	0	1	1
Neni 83/a Kanosja për hakmarrje/gjakmarrje	11	1	2	1	1	3	1	0	1	0
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Neni 84 Kanosja	351	66	126	79	16	263	44	97	50	37
Totali	490	109	218	134	80	406	107	222	142	83

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 17,14 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në krahasim me vitin 2018. Ndërkaq kemi një ulje prej 1,83 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re rritje prej 1,83 % përkundrejt këtij totali në vitin 2018, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 5,97 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 3,75 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër jetës të kryera me dashje për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 95,52 % e tyre janë meshkuj (nga të cilët 1 % janë të mitur) dhe 4,48 % janë femra (ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura).

Në lidhje me arsimimin e të pandehurve, rezulton se për këto grup veprash penale 5,56 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të lartë, 49,49 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve, prej 44,95 % rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 67,69 % e të pandehurve janë të papunë, 28,46 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 3,85 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se, rreth 64,65 % e të pandehurve për këtë grup veprash janë banues në qytet dhe 35,35 % e tyre, në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vihet re se 6,81 % e tyre janë përsëritës për vepra të tjera dhe 93,19 % janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**Vrasja me dashje**


Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2019 janë regjistruar 33 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, që rezulton me një rritje prej 10 % në krahasim me vitin 2018.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kryera me dashje” për vitin 2019 është 8,13 %, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 6,12 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje” për vitin 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë, konkretisht 7 procedime që përbëjnë 21 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 5 procedime ose 15 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 4 procedime ose 12 % e numrit total të procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier e Kavajë janë regjistruar respektivisht 3 procedime ose 9 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 2 procedime ose 6 % e numrit total të procedimeve dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Krujë, Kurbin, Lushnje, Përmet, Pukë, Shkodër, Vlorë dhe në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda është regjistruar respektivisht 1 procedim penal ose 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Durrës, Elbasan, Kukës, Mat, Pogradec, Sarandë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje” gjatë vitit 2019.

Vrasja me paramendim


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2019 është 12,07 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 9,59 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015 – 2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019, ka një rritje prej 4,26 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 "Vrasja me paramendim" i Kodit Penal, krahasuar me vitin 2018.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2019 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vrasjes me paramendim, rezulton në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë, 9 procedime penale që përbën 18 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, të dhënat në rend zbritës tregojnë se, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 8 procedime penale ose 16 % e procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Shkodër e Vlorë janë regjistruar respektivisht nga 6 procedime penale ose 12 % e procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier e Korçë janë regjistruar respektivisht 3 procedime që përbëjnë 6 % të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Elbasan, Kavajë, Krujë e Lushnje janë regjistruar respektivisht nga 2 procedime ose 4 % e procedimeve, ndërsa në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës, Kurbin, Mat e Pogradec është regjistruar respektivisht nga 1 procedim penal ose 2 % e procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Kukës, Përmet, Pukë, Sarandë, Tropojë e Berat nuk kanë regjistruar procedime gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”.

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kryera kundër jetës të kryera me dashje” është 8,87 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 5,10 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019, ka një rritje prej 44 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, krahasuar me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” në vitin 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve është regjistruar në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë dhe në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda ku janë regjistruar 5 procedime penale që përbëjnë 14 % të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës, Korçë e Tiranë janë regjistruar nga 4 procedime penale që përbëjnë 11 % të totalit të procedimeve penale dhe në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar nga 3 procedime penale, e shprehur në përqindje 8 % e totalit të procedimeve. Ndërkaq prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier, Gjirokastrë, Kurbin e Pogradec kanë regjistruar nga 2 procedime penale dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Krujë e Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”.

Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 4,19 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 2,86 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 janë regjistruar 17 procedime penale për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, që ndaj 14 procedimeve të regjistruara në vitin 2018, përbën rritje prej 21,43 %.




Kanosja

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje për procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal "Kanosja".


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Krime kundër jetës të kryera me dashje" është 64,78 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 71,63 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2019 janë regjistruar 263 procedime penale që përbëjnë një ulje prej 25,07 % krahasuar me 351 procedime të regjistruara për vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

Të dhënat për procedimet e regjistruara gjatë vitit 2019 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë për veprën penale të kanosjes gjenden në mënyrë të detajuar në vijim:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kanosjes është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 25 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë janë regjistruar rreth 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë, Krujë, Durrës e Sarandë janë regjistruar respektivisht rreth 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kukës e Kurbin janë regjistruar përkatësisht rreth 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2019. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër më të vogël procedimesh (më pak se 3 %) për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni II “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	4	2	1	3	0	7	5	7	12	2
Totali	4	2	1	3	0	7	5	7	12	2

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka rritje të treguesve lidhur me “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”. Konkretisht nga 4 procedime penale me 1 të pandehur të regjistruar në vitin 2018, në 7 procedime penale me 7 të pandehur të regjistruar në vitin 2019. Procedimet e dërguara në gjykatë rezultojnë me rritje nga 2 në vitin 2018, në 5 procedime me 12 të pandehur në vitin 2019, ndërkohë janë dënuar 2 të pandehur për këtë veprë gjatë periudhës raportuese.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2019 është 2,94 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2018 ky grup veprash përbënte 2,89 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 31,55, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 31,63.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i III “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit”:

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 86 Tortura	1	0	0	0	0	1	1	2	1	0
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88 Plagosje e rëndë me dashje	100	56	103	68	53	103	59	107	72	42
Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë82 psikike	0	1	1	2	2	0	0	0	0	2
Neni 88/b Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	1	2	1	2	2	1	1	1	1	2
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	775	264	588	348	192	771	255	462	330	198
Neni 89/a Shitblerja e paligjshme e organeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 90 Dëmtime të tjera	31	4	8	4	10	27	3	12	3	3
Totali	908	327	701	424	259	903	319	584	407	247

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 0,55 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit” në krahasim me vitin 2018. Tendencë në ulje paraqet edhe numri i procedimeve dërguar në gjykatë, prej 2,45 % në krahasim me vitin 2018, e po kështu edhe numri i të pandehurve të regjistruar në vitin 2019 ku rezulton ulje 16,69 % përkundrejt këtij totali në vitin 2018. Ndërkohë, numri i të pandehurve të dërguar në gjykatë është ulur me 4,01 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 4,63 %.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 7,01 % e tyre janë femra dhe 92,99 % janë meshkuj, ndër të cilët 5,36 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 1 shtetas i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se për këto grup veprash penale 6,50 % e tyre janë me arsim të lartë, 39,33 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër prej 39,33 % e të pandehurve, rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezultojnë se rreth 77,24 % e të pandehurve janë të papunë dhe rreth 22,76 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat.

Rezultojnë se 52,15 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 47,85 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 3,77 % prej tyre janë të dënuar për vepra të tjera penale dhe 96,23 % janë të pa dënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Plagosja e rëndë me dashje


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2019 është 11,41 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 11 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019, vihet re tendencë rritje prej 3 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”, në krahasim me vitin 2018.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2019, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje është regjistruar në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që përbën 38 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi, e në vijim, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë e Durrës respektivisht 9 % dhe 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër rreth 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Fier, Korçë e Lezhë që kanë regjistruar respektivisht 5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan e Kukës që kanë regjistruar respektivisht 4 % të numrit total të procedimeve, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Pogradec rezultojnë 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Krujë e Mat janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë rreth 2 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që prokuroritë e tjera të shkallës së parë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % gjatë vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”.

Plagosja e lehtë me dashje


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2019 është 85,38 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 85,35 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Në vitin 2019, të dhënat statistikore tregojnë tendencë të lehtë në ulje prej 0,52 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”, krahasuar me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje” për vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që përbën 31 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi. Në vijim, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan që përbën 14 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Vlorë që përbëjnë respektivisht nga 9 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë që përbën 6 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier ku janë regjistruar rreth 5 % e numrit total të procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Shkodër e Berat që kanë regjistruar respektivisht 4 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë e Kavajë kanë regjistruar respektivisht 3 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Pogradec, Kukës e Dibër kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë 2 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kurbin, Lushnje, Krujë, Sarandë, Mat e Pukë, kanë regjistruar më pak se 1 % të numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Përmet e Tropojë nuk kanë regjistruar procedime gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i IV “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia”:

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 91 Plagosja e rëndë nga pakujdesia	2	0	0	0	1	4	1	2	1	0
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	2	0	0	0	0	7	0	0	0	0
Totali	4	0	0	0	1	11	1	2	1	0

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale për “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” të regjistruara në vitin 2019 është rritur në 11, ndaj 4 procedimeve të regjistruara në vitin 2018. Për këtë periudhë rezulton 1 procedim i dërguar në gjykatë, 2 të pandehur të regjistruar, 1 i pandehur dërguar në gjykatë dhe nuk rezultojnë të pandehur të dënuar.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,30 %. Ky tregues për vitin 2018 ka qenë 1,41 %, pra vihet re ulje e tij për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 13,94, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 15,47.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në seksionin V të kreut të dytë të Kodit Penal “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës”:

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Neglizhenca në trajtimin mjekësor ³⁵	44	7	9	15	9	58	12	13	16	6
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	7	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	391	1	5	1	1	339	1	3	2	1
Totali	444	8	14	16	10	399	13	16	18	7


TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 10,14 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, në

³⁵ Dispozita është ndryshuar me ligjin 44/2019

krahasim me vitin 2018. Numri i procedimeve dërguar në gjykatë ka pësuar rritje në krahasim me vitin 2018 nga 8 në 13, numri i të pandehurve të regjistruar është rritur nga 14 në 16 dhe numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur nga 16 në 18. Ndërkohë vërehet ulje në lidhje me numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata nga 10 të pandehur në vitin 2018 në 7 të pandehur të dënuar në vitin 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit rezultojnë të moshës madhore, ku 64 % e përbëjnë meshkujt dhe 36 % femrat.

Në këtë grup veprash është marrë si të pandehur edhe 1 shtetas i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 88 % e të pandehurve janë me arsim të lartë, me arsim të mesëm janë 8 % e të pandehurve dhe me arsim deri në 9 vjeçar, 4 % e të pandehurve.

Rezultoni se 92 % e të pandehurve e kanë vendbanimin në qytet ndërsa pjesa tjetër në fshat, ndërsa në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Neglizhenca në trajtimin mjekësor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës” është 14,54 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 9,91 %.

Të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2019 për këtë vepër penale është rritur me 31,82 % krahasuar me vitin 2018.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Shkaktimi i vetëvrasjes

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 84,96 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 88,06 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 13,30 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në krahasim me vitin 2018.

KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,51 %, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 0,36 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 5,52, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 3,94.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VI të Kodit Penal “Krime Seksuale”:


KRIME SEKSUALE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 100 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur	18	6	17	6	4	28	13	26	23	9
Neni 101 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	11	2	7	2	2	14	10	12	10	3

Neni 102 Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura	11	3	7	3	3	16	6	15	7	1
Neni 102/a Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 103 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur	3	0	2	0	2	11	2	4	2	2
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 105 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 106 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari	0	0	0	0	0	3	0	4	0	0
Neni 107 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale ne vende publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 107/a Dhuna seksuale	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	18	13	15	15	11	27	13	19	13	11
Neni 108/a Ngacmimi seksual	51	18	27	18	13	57	34	34	34	23
Totali	113	42	75	44	35	158	78	115	89	49

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka rritje prej 39,82 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2018, ndërkohë që kemi rritje prej 85,71 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 53,33 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë 2 herë më shumë ose me 102 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 40 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e krimeve seksuale për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë dhe moshën për të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 99,10 % e të pandehurve (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 0,90 % janë femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve meshkuj, 13,64 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Në këtë grup veprash është marrë si i pandehur edhe 1 shtetas i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 66,36 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 26,36 % me arsim të mesëm dhe 7,28 % me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 72,41 % e të pandehurve janë të papunë, 22,41 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 5,17 % të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezultojnë se 63,06 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 36,94 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 93,64 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 4,54 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohen dhe 1,82 janë përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” në vitin 2019 është 17,72, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 15,93 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori) :



Siç pasqyrohet në grafik, në vitin 2019 vihet re rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, prej 55,56 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë veprë penale:




Rezulton se në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 6 procedime penale ose 21 % që është edhe numri më i lartë i regjistruar në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Korçë janë regjistruar 5 procedime ose e shprehur në përqindje rreth 18 %, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 3 procedime penale ose 11 % e procedimeve dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 2 procedime penale që përbën 7 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Dibër, Kavajë, Kukës, Kurbini e Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose respektivisht rreth 4 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, në vitin 2019.

Ngacmimi seksual


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” është 36,08 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 45,13 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi krahasuar me vitin 2018.

Ecuria e kësaj veprë penale paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Në vitin 2019, në grupin e krimeve seksuale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal “Ngacmimi seksual”, prej 11,76 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë vepër penale:



Rezultoni se në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë është regjistruar 35 % e totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër, që është edhe numri më i lartë në shkallë vendi e konkretisht 20 procedime penale. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 7 procedime penale ose 12 %, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 6 procedime penale ose 11 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 5 procedime penale ose 9 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat e Fier janë regjistruar respektivisht nga 4 procedime penale ose 7 % e procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë, Sarandë e Shkodër janë regjistruar respektivisht 3 procedime penale dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kavajë e Përmet është regjistruar 1 procedim. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal “Ngacmimi seksual”.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,36 % dhe për vitin 2018 ka qenë 0,27 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 3,81, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 2,93.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII “Vepra penale kundër lirisë së personit”:


VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 109 Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit	7	0	1	0	1	7	0	4	0	0
Neni 109/a Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese	0	0	0	0	0	1	0	2	0	0
Neni 109/b Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë	29	15	11	21	18	68	6	37	9	6
Neni 109/c Zhdukja me forcë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	33	16	39	32	22	20	10	15	27	9
Neni 111 Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

mjeteve të tjera										
Neni 112 Dhunimi i banesës	15	6	11	8	4	13	3	3	4	4
Totali	84	37	62	61	45	109	19	61	40	19

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 29,76 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2018. Ndërkaq kemi ulje prej 48,65 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit e regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 1,61 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 34,43 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 57,78 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër lirisë së personit për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë, 95,35 % e të pandehurve janë meshkuj (mbi 18 vjeç), ndër të cilët 4,88 të mitur dhe 4,65 % janë femra (mbi 18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 38,37 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 58,14 % me arsim të mesëm dhe 3,49 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 50 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin shtetëror janë 4,29 % e të pandehurve dhe të papunë 45,71 %.

Rezulton se 58,14 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 41,86 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 96,39 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 3,61 % janë përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT


Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 6,42 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 8,33 %. Në vitin 2019 për këtë vepër janë regjistruar 7 procedime penale po aq sa në vitin 2018.

Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2019, në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 62,39 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 34,52 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2019 vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë” prej 2,3 herë, në krahasim me vitin 2018.

Heqja e paligjshme e lirisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër lirisë së personit” është 18,35 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 39,29 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”, në vitin 2019, prej 39,39 % në krahasim me vitin 2018.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,90 %, tregues i njëjtë me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 9,64, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 9,82.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VIII të Kodit Penal “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”:


VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 113 Prostitucioni	11	3	14	16	13	12	4	13	23	28
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	39	11	27	33	23	28	8	15	9	12
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion	3	1	3	6	0	3	0	4	0	0
Neni 117 Pornografia	8	1	0	1	0	8	2	0	3	1

Neni 118 Dhunimi i varreve	17	1	3	1	1	19	3	3	3	0
Neni 119 Fyerja	3	0	1	0	1	2	0	1	0	1
Neni 120 Shpifja	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private	8	1	1	1	1	14	3	7	3	0
Neni 121/a Përndjekja	191	116	137	116	78	188	91	123	92	85
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	1	1	0	1	0	1	0	0	0	1
Totali	282	135	186	175	118	276	111	166	133	128

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 2,13 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2018. Ndërkaq kemi ulje prej 17,78 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018, ulje në lidhje me numrin e të pandehurve regjistruar për këtë grup veprash penale prej 10,75 % përkundrejt këtij totali në vitin 2018, ulje me 24 % të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë dhe rritje me 8,47 % të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, krahasuar me vitin 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 76,74 % janë meshkuj ndër të cilët 1,52 % të mitur dhe 23,26 % femra.

Në këtë grupveprash rezulton 1 i pandehur i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 41,28 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 43,60 % me arsim të mesëm dhe 15,12 % të pandehur me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore, rezulton se nga sektori privat janë regjistruar 51,22 % e të pandehurve dhe 48,78 % rezultojnë të papunë.

Rezulton se 70,18 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 29,82 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 90,64 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 8,19 % e tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 1,17 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shfrytëzimi i prostitucionit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 10,14 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 13,83 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”, në vitin 2019 me 28,21 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit është regjistruar në

prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, konkretisht 25 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 14 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan, Fier e Korçë kanë regjistruar respektivisht 11 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat e Shkodër kanë regjistruar 7 % të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Krujë, Lezhë e Sarandë kanë regjistruar respektivisht rreth 4 % të procedimeve në shkallë vendi, e ndërkaq në prokuroritë e tjera nuk është regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”.

Përndjekja


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 68,12 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 67,73 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2019 janë regjistruar 1,57 % më pak procedime penale sesa në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal “Përndjekja”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) për veprën penale të përndjekjes:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve për veprën penale të përndjekjes është regjistruar në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, konkretisht 54 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier ka regjistruar 7 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Berat ka regjistruar 6 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan, Vlorë, Gjirokastër e Korçë kanë regjistruar respektivisht rreth 4 % të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës, Lezhë e Shkodër kanë regjistruar rreth 3 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnjë ka regjistruar rreth 2 % të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e tjera kanë regjistruar respektivisht një numër procedimesh më të ulët se 1 % të totalit. Ndërkaq në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Pogradec e Pukë nuk është regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal “Përndjekja”.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 4,04 %, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 4,3 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 43,28 ndërsa në vitin 2018 ka qenë 47.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IX-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal “Vepra Penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”:

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES ³⁶	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur	62	20	33	20	12	43	16	22	16	14
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit	56	19	28	21	13	27	22	20	24	11
Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë	2	0	0	0	1	2	0	0	0	0
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit	7	3	2	3	1	4	3	2	3	3
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës	5	0	1	0	1	15	1	4	1	0
Neni 128 Ndërrimi i fëmijëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 129 Shtytja e të miturve në krim	2	0	1	0	0	2	1	0	1	0
Neni 130 Shtyrërimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë 130/a Dhuna në familje	6	1	2	1	5	6	1	3	1	0
	1209	1007	1195	1069	826	1140	834	1024	888	793
Totali	1349	1050	1262	1114	860	1239	878	1075	934	821


TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore në vitin 2019 ka një ulje të gjithë treguesve për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”. Kështu, rezultojnë ulje prej 8,15 % e numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2018 e ndërkaq

³⁶ Veçuar nga ky grup kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit dhe trajtuar te grupveprat penale të korrupsionit, si dhe trafikimi i të miturve i cili është trajtuar në grupveprat penale lidhur me trafiket.

kemi ulje prej 16,38 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 14,82 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 16,16 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4,53 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër fëmijëve martesës dhe familjes për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

90,82 % e të pandehurve janë meshkuj ku 1,40 % e përbëjnë të miturit dhe 9,18 % janë të pandehura femra ndër të cilat rezultojnë 1,98 % të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 60,26 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 35,07 % me arsim të mesëm dhe 4,67 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 1,92 % e të pandehurve, në sektorin privat 21,78 % e të pandehurve dhe të papunë 76,30 %. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë me arsimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 54,97 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 45,03 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 89,99 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2,50 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 7,51 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Braktisja e fëmijëve të mitur

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2019 është 3,47 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 4,60 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 30,65 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal “Braktisja e fëmijëve të mitur”, në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Keqtrajtimi i të miturit


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2019 është 2,18 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 4,15 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 51,79 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”, në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Ndërsa tendenca në vitet 2015-2019 për këtë veprë, paraqitet si vijon:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë, të dhënat paraqiten në grafikun në vijim, ku vërehet se numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara e ka prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë.




Dhuna në familje

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2019 është 92,01 % në vitin 2018, pesha e kësaj vepre rezulton në masën 89,62 %.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë veprë në vitin 2019 është 39,83, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 42,12.

Ecuria e kësaj vepre penale, për vitet 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 5,71 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal “Dhuna në familje”, në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2019, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të dhunës në familje është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 31 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim sipas numrit më të madh të procedimeve të regjistruara renditen, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 10 % të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Fier që kanë regjistruar rreth 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar rreth 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lushnje, Berat e Korçë që kanë regjistruar rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a “Dhuna në familje”, ndërkohë që prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Përmet nuk ka regjistruar asnjë procedim për vitin 2019.

VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e X-të të Kreut të dytë të Kodit Penal, veprat penale kundër lirisë së besimit, ku siç vërehet gjatë vitit 2019 janë regjistruar 2 procedime penale me 1 të pandehur për veprën penale “Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit”.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit	1	1	1	1	0	1	0	1	0	0
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1	1	1	1	0	2	0	1	0	0

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

VJEDHJA E PASURISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 30,94 %, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 33,21 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 331,78, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 363,20.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e parë të Kreut të tretë të Kodit Penal, “Vjedhja e Pasurisë”:

VJEDHJA E PASURISË ³⁷	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 134 Vjedhja	9219	908	1209	1081	839	8682	759	1028	950	758
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	114	41	69	47	45	85	45	49	69	37


³⁷ Veçuar nga ky grup dhe trajtuar me vete trafiqet

Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit	14	4	5	5	12	16	0	2	0	2
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	918	731	625	731	504	575	390	589	393	312
Neni 137 /a Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës	2	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 139 Vjedhja me dhunë	118	48	68	66	56	117	34	69	51	33
Neni 140 Vjedhja me armë	35	7	13	9	3	15	6	11	8	7
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen	4	2	8	3	1	1	1	0	3	4
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje	0	0	0	0	1	4	1	4	4	3
Totali	10425	1741	1997	1942	1461	9497	1236	1752	1478	1156


TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 8,90 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë dhe një ulje prej 29,01 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 12,27 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 23,89 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,88 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të vjedhjes së pasurisë për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



Për vitin 2019 procedimet penale për veprat e këtij seksioni krahasuar me vitin 2018 paraqesin tendencat si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

92,53 % e të pandehurve janë meshkuj ku 10,57 % e përbëjnë të miturit, dhe 7,47 % janë të pandehura femra ndër të cilat rezultojnë të jenë 5,69 % të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 64,94 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 31,50 % me arsim të mesëm dhe 3,56 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 1,43 % e të pandehurve, në sektorin privat 12,47 % e të pandehurve dhe të papunë 86,10 %.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 22 shtetas të huaj.

Rezultoni se 59,82 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 40,18 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezultoni se 81,66 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 10,30 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 8,04 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vjedhja


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është 91,42 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 88,43 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat vihet re se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në vitin 2019 janë ulur me 5,82 % në krahasim me vitin 2018.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj veprë në vitin 2019 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vjedhjes është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 38 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 8 %, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan e Fier janë regjistruar përkatësisht 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Lushnje janë regjistruar respektivisht 4 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Sarandë e Kavajë janë regjistruar 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”.


Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë veprë penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2019 është 0,90 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues ka qenë 1,09 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore në vitin 2019 vërehet tendenca në ulje prej 25,44 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2019 për këtë veprë, rezulton si më poshtë vijon:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që përbën 39 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, në vijim prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë me 9 % të totalit të procedimeve dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier me 8 % të totalit të procedimeve të regjistruara. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Elbasan kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën secila 7 % të totalit të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 6 % të totalit të procedimeve dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Pogradec ka regjistruar 4 % të totalit të procedimeve. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Kukës, Lezhë, Sarandë e Shkodër kanë regjistruar rreth 2 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Kavajë, Krujë, Lushnjë, Pukë dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, kanë regjistruar rreth 1 % të numrit total të procedimeve. Ndërkaq, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Kurbin, Mat, Përmet e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 135 të Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”.

Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2019 është 0,17 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues ka qenë 0,13 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2019 vërehet trendi në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit”, në krahasim me vitin 2018, nga 14 procedime në 16 procedime të regjistruara.

Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2019 është 6,05 %, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 8,81 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” i Kodit Penal, ka një ulje prej 37,36 % në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2019 për këtë veprë, rezulton si më poshtë vijon:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër që përbën 41 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, në vijim prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan me 14 % të totalit të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë e Tiranë me 11 % të totalit të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë që ka regjistruar një numër procedimesh që përbën 8 % të totalit të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës që ka regjistruar 3 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kurbin e Dibër që kanë regjistruar respektivisht 2 % të totalit të procedimeve. Ndërkohë, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Krujë, Lushnje, Pukë, Kukës, Fier, Sarandë, Korçë, Pogradec, Kavajë e Mat kanë regjistruar rreth 1 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Përmet e Tropojë nuk kanë regjistruar procedime penale për vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”.

Vjedhja me dhunë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2019 është 1,23 % ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 1,13 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka ulje të lehtë prej 0,85 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal "Vjedhja me dhunë", në krahasim me vitin 2018.

Vjedhja me armë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale "Vjedhja e pasurisë" për vitin 2019 është 0,16 % ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 0,34 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore të vitit 2019 vërehet se numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal "Vjedhja me armë" është ulur me 57,14 % krahasuar me vitin 2018.

MASHTRIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,45 %, ndërsa në vitin 2018 është 2,61 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 24,11, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 28,57.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e II, të Kreut të Tretë të Kodit Penal "Mashtrimet":

MASHTRIMET	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dën uar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pan d. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënu ar
Neni 143 Mashtrimi	704	212	207	292	157	613	231	234	310	152
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut	1	0	0	0	0	3	2	2	2	0


Neni 143/a/2 Përdorimi i paaautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/3 Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paaautorizuar e tyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paaautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 144 Mashtrimi në subvencione	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 144/a	4	11	22	28	12	4	5	0	44	20
Neni 145 Mashtrimi në sigurime	70	83	49	86	111	32	23	27	23	40
Neni 146 Mashtrimi në kredi	13	5	7	17	9	16	5	7	9	15
Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 149 Shkelja e të dejtave të autorit ³⁸	1	0	1	0	0	3	0	0	0	0
Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale	19	3	3	4	0	15	4	6	4	3
Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	820	314	289	427	289	690	270	276	392	230

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 numri i procedimeve të regjistruara për veprat penale të mashtrimit ka një ulje prej 15,85 % krahasuar me vitin 2018, e ndërkaq kemi ulje prej 14,01 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 4,50 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 8,20 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,42 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të mashtrimeve për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:

³⁸ Dispozita është ndryshuar me ligjin 44/2019



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Rezulton se 83,25 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 16,75 % e të pandehurve janë femra (ndër të cilat rezultojnë 2 të mitura).

Për sa i përket arsimit të të pandehurve rezulton se 27,63 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 45,79 % me arsim të mesëm dhe 26,58 % me arsim të lartë.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 9 shtetas të huaj.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 0,74 % e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror, në sektorin privat rezultojnë 24,63 % e të pandehurve dhe 74,63 % janë të papunë.

Rezulton se 73,75 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 26,25 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 1,32% e tyre rezultojnë përsëritës për të njëjtën veprë, 5,52 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, ndërsa 93,16 % janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 88,84 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 85,85 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Në këtë grup veprash penale vihet re një tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, në vitin 2019, prej 12,93 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, gjatë vitit 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, edhe për këtë vepër penale numri më i lartë i procedimeve të regjistruara është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 44 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës që përbën 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë që përbën 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 6 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier e Lezhë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën 4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Krujë, Gjirokastrë, Korçë, Lushnjë e Kavajë rezulton se janë regjistruar 2 % i numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi. Në prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 1 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”.

Mashtrimi në sigurime


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Mashttrimet” është 4,64 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 8,5 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori);



Nga të dhënat statistikore vihet re ulje prej 54,29 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, në vitin 2019.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, gjatë vitit 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të mashtrimit në sigurime është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, që përbën 28 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim rezultojnë në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 22 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që ka regjistruar 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Mat që kanë regjistruar respektivisht 2 procedime penale ose rreth 6 % të numrit total të procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Elbasan, Krujë, Pogradec, Pukë e Tropojë që kanë regjistruar respektivisht rreth 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Në prokuroritë e tjera nuk rezultojnë asnjë procedim i regjistruar në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”.

Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit për vitin 2019 është 2,17 %, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 2,3 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, në vitin 2019, prej 21,05 % krahasuar me vitin 2018.

SHKATËRRIMI I PRONËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 4,10 %, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 3,97 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 43,95, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 43,37.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e III, të Kreut të III të Kodit Penal:


SHKATËRRIMI I PRONËS	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	514	35	78	40	28	543	32	129	44	32
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	426	24	33	24	13	509	21	47	23	19
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	51	2	4	2	1	56	5	10	8	0
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmblytje	0	0	0	0	0	1	0	3	0	0

Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera	7	1	3	3	0	8	1	4	2	2
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve	8	0	0	0	0	3	2	7	6	3
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik	27	1	2	1	1	24	0	2	0	1
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes	5	0	1	0	0	1	1	0	1	0
Neni 158	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit	150	57	73	57	35	35	16	11	24	23
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	53	2	9	3	3	78	8	17	8	3
Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1245	122	203	130	82	1258	86	230	116	83

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2019 ka trend të lehtë rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të shkatërrimit të pronës në krahasim me vitin 2018, e konkretisht 1,04 %. Ndërkohë vërehet ulje 29,51 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018, rritje 13,30 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundëjt këtij totali në vitin 2018, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 10,77 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 1,22 % përkundëjt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të shkatërrimit të pronës për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit 6,11 % janë femra dhe 93,89 % meshkuj, ndër të cilët 1,63 % janë të pandehur të mitur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 49,61 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 47,29 % me arsim të mesëm dhe 3,10 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektor shtetëror janë regjistruar 1,32 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë 44,73 % e të pandehurve dhe 53,95 % janë të papunë.

Rezulton se 50,38 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 49,62 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë, 92,27 % e të pandehurve, 6,87 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,87 % janë përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shkatërrimi i pronës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 43,16 % për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 41,29 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës” në vitin 2019 është në rritje me 5,64 % në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2019, të dhëna të detajuara jepen në grafikun e mëposhtëm:




Sikurse vërehet edhe nga paraqitja grafike për këtë veprë penale numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, 25 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi e më pas prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë e Berat që kanë regjistruar përkatësisht 11 % të numrit total të procedimeve. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier ka regjistruar 6 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Sarandë, Durrës e Shkodër kanë regjistruar 5 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Lezhë kanë regjistruar respektivisht rreth 4 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Kukës, Përmet e Pogradec kanë regjistruar 2 % të procedimeve. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më se 1,5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, ndërsa prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Pukë nuk ka regjistruar procedime penale gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 150 të Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës”.

Shkatërrimi i pronës me zjarr

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 40,46 % për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 34,22 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2019, vihet re tendenca në rritje me 19,48 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, në krahasim me vitin 2018.

Shkatërrimi i pronës me eksploziv


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” për vitin 2019 është 4,45 %, ndërsa në vitin 2018 ky tregues ka qenë 4,1 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, prej 9,80 % në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2019, të dhëna të detajuara jepen në grafikun e mëposhtëm:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj veprë janë prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë që ka regjistruar 14 procedime penale ose 25 % të totalit të numrit të procedimeve dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që ka regjistruar 12 procedime ose 21 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale në shkallë vendi. Në vijim, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 7 procedime penale, që përbëjnë 13 % të numrit të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 6 procedime penale ose 11 % të totalit të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Dibër kanë regjistruar nga 4 procedime ose 7 % të totalit të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë ka regjistruar nga 3 procedime penale ose rreth 5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë ka regjistruar nga 2 procedime penale ose rreth 4 % të numrit total të procedimeve të regjistruara dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lushnje, Mat, Shkodër e Tropojë kanë regjistruar nga 1 procedim penal që përbën 1 % të numrit total të procedimeve të regjistruara. Ndërkaq, prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”.

Shkatërrimi i rrjetit elektrik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 1,91 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018, pesha specifike e kësaj vepre ka qenë 2,17 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”, prej 11,11 %, krahasuar me vitin 2018.

Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit” është 2,78 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018, pesha specifike e kësaj vepre është 12 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal, prej 76,67 %, krahasuar me vitin 2018.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,25 %, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 0,35 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 2,69, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 3,87.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IV të Kreut të III të Kodit Penal "Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare":


VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 163 Përpilimi i deklaratave të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 164 Shpërdorimi i kompetencave	10	4	2	4	2	12	4	1	4	2
Neni 165 Falsifikimi i nënshkrimeve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 166 Emetimi i parregullt i aksioneve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 167 Mbajtja e padrejtë e dy cilësive	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0
Neni 168 Dhënia e informacioneve të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 169 Zbulimi i sekreteve të shoqërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170 Mosbërja e shënimeve të detyrueshme	3	1	1	1	1	1	0	0	0	0
Neni 170/a Punësimi i paligjshëm	95	47	61	48	19	63	40	36	41	39
Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës	2	1	0	1	2	1	1	1	1	0
Totali	111	53	64	54	24	77	45	38	47	41

TENDENCA

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 numri i procedimeve penale të regjistruara dhe numri i të pandehurve të regjistruar është ulur respektivisht 30,63 % dhe 40,63 % në krahasim me vitin 2018, ndërsa numri i procedimeve të dërguara në gjykatë dhe numri i të pandehurve të dërguar gjykatë është ulur respektivisht 15,09 % dhe 12,96 %, krahasuar me vitin 2018, ndërkohë që numri i të pandehurve të dënuar është rritur 70,83 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, tregojnë se, 82,98 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 17,02 % femra, të moshës madhore.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 23,40 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 65,96 % me arsim të mesëm dhe 10,64 % të pandehur me arsim të lartë.

Rezultojnë 2 shtetas të huaj ndër të pandehurit për këto grup vepra.

Lidhur me vendbanimin rezulton se 76,60 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 23,40 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 95,74 % janë të padënuar më parë dhe 4,26 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohet.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Punësimi i paligjshëm


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare” në vitin 2019 është 81,82 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 85,59 %.

Ecuria e kësaj veprave penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”. Kështu në vitin 2019 janë regjistruar 63 procedime penale, kundrejt 95 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2018 ose 33,68 % më pak.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara gjatë vitit 2019:



Sikurse vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave, për këtë vepër penale numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, 22 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi e më pas prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Tiranë që kanë regjistruar përkatësisht 14 % të numrit total të procedimeve. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 8 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Lushnje kanë regjistruar respektivisht 5 %, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kukës e Përmet kanë regjistruar respektivisht 3 %, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kavajë, Krujë, Lezhë, Pogradec e Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 2 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Kurbin, Mat, Pukë, Shkodër e Tropojë nuk kanë regjistruar procedime gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,06 %, ndërsa në vitin 2018 ky tregues ka qenë 0,12 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 0,63, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 1,29.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE E FINANCIARE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 170/c Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare	10	7	10	7	6	5	1	2	1	2
Neni 170/ç Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare	27	20	18	20	9	13	14	15	18	9
Totali	37	27	28	27	15	18	15	17	19	11

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, në vitin 2019 numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare në krahasim me vitin 2018 ka pësuar një ulje me 51,35 % dhe ulje me 39,29 % të numrit të të pandehurve regjistruar. Numri i procedimeve të dërguara gjyqit është ulur me 44,44 % ndërsa numri i të pandehurve dërguar gjyqit me 29,63 %, ndërkohë që të pandehurit e dënuar nga gjykata rezultojnë me ulje 26,67 % në krahasim me vitin 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore gjatë vitit 2019 vihet re se 95 % e tyre janë meshkuj madhorë dhe 5 % femra.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se të gjithë të pandehurit janë të punësuar në sektorin privat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 80 % e të pandehurve rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Edhe në vitin 2019, në këtë grup veprash peshën më të madhe e ka vepra penale e parashikuar nga neni 170/ç i Kodit Penal, "Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare", që përbën 72,22 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë grup. Për këtë veprë vërehet tendenca në ulje me 51,85 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara, krahasuar me vitin 2018.

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,52 %, ndërsa për vitin 2018 është 0,61 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 5,59, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 6,65.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:


KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar	3	1	2	1	1	2	0	1	0	0
Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	27	14	26	16	18	20	15	22	18	9
Neni 173 Kontrabanda me	5	3	6	3	1	2	3	1	4	3

mallra të licencuar										
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	73	37	30	56	23	43	28	41	36	21
Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore	0	0	0	0	0	4	0	0	3	0
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	10	4	2	4	1	12	3	11	3	2
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	45	35	36	40	26	40	27	33	41	26
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë	5	5	5	6	2	12	8	9	8	5
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	23	21	16	21	23	22	18	22	18	18
Neni 179/b Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë së autoriteteve doganore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 179/c Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet	0	0	0	0	0	3	0	2	0	0
Neni 179/ç Kontrabanda e kapitenit, pilotit ose ekuipazhit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	191	120	123	147	95	160	102	142	131	84

TENDENCA

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 16,23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2018. Ndërkaq kemi ulje prej 15 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 15,45 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur me 10,88 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 11,58 % krahasuar me vitin 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e doganave për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve rezulton se 96,59 % e të pandehurve janë të rritur (mbi 18 vjeç) meshkuj dhe 3,41 % të rritur femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 26,29 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 57,71 % me arsim të mesëm dhe 16 % të pandehurve janë me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2019 gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 0,96 % e të pandehurve, ndërkohë të punësuarit në sektorin privat zënë 61,54 % të numrit të të pandehurve dhe 37,50 % rezultojnë të papunë.

Po kështu rezultojnë edhe 13 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2019.

Sa i përket vendbanimit, 73,84 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 26,16 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 95,27 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 1,18 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale dhe 3,55 % përsëritës për vepra të tjera të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2018 në grupin e krimeve në fushën e doganave është 12,50 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues ka qenë 14,14 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në vitin 2019, prej 25,93 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre sipas prokurorive të shkallës së parë ku ka pasur procedime penale të regjistruara:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra që paguhet akcizë është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Pogradec, 7 procedime penale që përbëjnë 35 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 3 procedime ose 15 % e numrit total të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ka regjistruar nga 2 procedime penale ose 10 % e procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë ka regjistruar 1 procedim penal ose 5 % të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar procedime gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”.

Kontrabanda me mallra të tjera


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 26,88 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 38,22 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re se procedimet penale të regjistruara për këtë veprë janë ulur me 41,10 %, konkretisht në vitin 2019 janë regjistruar 43 procedime penale kundrejt 73 procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra të tjera është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë ku janë regjistruar përkatësisht 30 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës, Gjirokastrë, Korçë e Kukës janë regjistruar 9 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër janë regjistruar 7 % e totalit të procedimeve penale dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë, Pogradec, Sarandë e Shkodër janë regjistruar 5 % e totalit të procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier, Përmet e Vlorë janë regjistruar 2 % e procedimeve penale. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar procedime penale gjatë vitit 2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal.

Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2019 vihet re tendenca në ulje me 11,11 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, ku kjo vepër ka një peshë prej 25 % të procedimeve të regjistruara.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2019 vihet re tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë”, ku kjo vepër ka një peshë prej 13,75 % të procedimeve të regjistruara.

Nga të dhënat statistikore vërehet se për vitin 2019 janë regjistruar 22 procedime penale ndaj 23 procedimeve të regjistruara në vitin 2018, që përbën tendencë në ulje me 4,35 %.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,35 %, ndërsa për vitin 2018 është 1,06 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 14,50, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 11,60.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun III, Seksionin e VI “Veprat penale në lidhje me taksat e tatimet” i Kodit Penal:


VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	216	55	76	64	51	273	61	120	74	55
Neni 180/a	21	7	9	9	4	17	3	7	3	5
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	73	30	31	40	25	102	34	42	48	29
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	5	1	2	1	1	2	0	1	0	0
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse	2	2	1	2	1	4	0	2	0	1
Neni 182/a	16	11	11	11	6	17	5	4	5	6
Totali	333	106	130	127	88	415	103	176	130	96

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 24,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2018. Ndërkaq rezulton ulje prej 2,83 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar

përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 35,38 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 2,36 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 9,09 %.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë të gjithë të rritur ku 10,66 % femra dhe 89,66 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 21,67 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 66,67 % me arsim të mesëm dhe 11,66 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për këto vepra rezultojnë të marrë si të pandehur edhe 5 shtetas të huaj.

Sa i përket gjendjes shoqërore, 85,90 % e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin privat, 2,56 të punësuar në sektorin shtetëror dhe pjesa tjetër prej 11,54 % janë të papunë.

Lidhur me vendbanimin, rezulton se 70,49 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 29,51 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 95,50 % janë të padënuar më parë dhe 4,50 % e tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Fshehja e të ardhurave


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 65,78 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 64,86 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore të vitit 2019 vërehet tendenca në rritje prej 26,39 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave” në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për këtë vepër në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2019 në shkallë vendi:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprën penale të fshehjes së të ardhurave është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë ku janë regjistruar 25 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, ku janë regjistruar 12 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër ku janë regjistruar 11 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Elbasan ku janë regjistruar respektivisht rreth 8 % e procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar rreth 4 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë Fier, Korçë, Pogradec e Lezhë kanë regjistruar përkatësisht rreth 3 % të numrit total të procedimeve, ndërsa prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Tropojë, Dibër, Kurbin, Lushnje, Kukës, Kavajë, Krujë e Përmet kanë regjistruar më pak se 2,5 % të totalit të procedimeve penale në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Mat e Pukë nuk kanë regjistruar procedime penale në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”.

Mospagimi i taksave dhe i tatimeve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 24,58 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 21,92 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve”, prej rreth 39,73 % krahasuar me procedimet e regjistruara në vitin 2018.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,28 %, ndërsa në vitin 2018 ky tregues ka qenë 0,26 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 2,97, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 2,86.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu III, Seksioni VII “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” i Kodit Penal:


	2018	2019

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. Dënuar
Neni 183 Falsifikimi i monedhave	80	36	29	40	24	82	24	37	25	21
Neni 184 Falsifikimi i letrave me vlerë	2	2	5	3	3	3	0	0	0	2
Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	82	38	34	43	27	85	24	37	25	23

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 3,66 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2018 dhe ulje prej 36,84 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 8,82 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 41,86 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 14,81 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 89,47 % janë meshkuj, ndër të cilët 11,76 % të mitur dhe 10,53 % janë femra, ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 28,95 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 65,79 % me arsim të mesëm dhe 5,26 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Në lidhje me gjendjen shoqërore rezulton se 65,22 % e të pandehurve kanë qenë të papunë, 30,43 % të punësuar në sektorin privat dhe 4,35 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezultojnë se 81,58 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 18,42 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 13,52 % rezultojnë përsëritës për vepra penale të ndryshme, 2,70 % përsëritës për të njëjtën vepër dhe 83,78 % e të pandehurve rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i monedhave


Për vitin 2019 pesha specifike e kësaj vepre përbën 96,47 % të procedimeve të regjistruara për grupin e veprave penale “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë”, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 97,56 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore në vitin 2019 vërehet tendencë e lehtë rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”, prej 2,50 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës ka regjistruar 24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë e Fier kanë regjistruar përkatësisht 9 % dhe 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Korçë e Lezhë kanë regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Lushnje e Sarandë kanë regjistruar nga 2 % të procedimeve, ndërsa prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Përmet, Pogradec e Shkodër kanë regjistruar 1 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkohë prokuroritë Dibër, Krujë, Kurbin, Mat, Pukë e Tropojë, nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 3,79 %, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 3,50 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 40,63, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 37,94.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII të Kreut të III të Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”:


FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	618	141	157	182	142	648	197	179	221	108
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore	32	15	12	40	20	25	7	10	10	31
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore	9	4	4	4	7	25	14	13	14	12
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	281	119	205	135	88	323	196	220	199	122
Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	140	56	85	62	97	125	53	44	58	40
Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile	6	1	2	1	2	14	3	2	3	2
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve	3	2	8	5	5	3	0	0	0	0

Totali	1089	339	473	430	361	1163	470	468	505	315
---------------	-------------	------------	------------	------------	------------	-------------	------------	------------	------------	------------

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka rritje prej 6,80 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2018, rritje të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë me 38,64 %, ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 1,06 %, rritje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 17,44 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 12,72 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të dhënat lidhur me gjininë e të pandehurve tregojnë se 85,63 % e tyre janë meshkuj dhe 14,37 % janë femra.

Në vitin 2019 rezultojnë të pandehur 52 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezultojnë se 28,84 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 55,06 % me arsim të mesëm dhe 16,10 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë 9,90 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin privat janë 29,21 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër prej 60,89 % e të pandehurve, rezultojnë të papunë.

Rezultojnë se 63,67 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 36,33 % e të pandehurve në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 95,27 % e tyre janë të padënuar më parë, 4,16 % të dënuar për vepra penale të ndryshme dhe 0,57 % rezultojnë të dënuar për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i dokumenteve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 55,72 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 56,75 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet rritje prej 4,85 % e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, “Falsifikimi i dokumenteve”.


Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2019 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e ka prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 32 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Pukë, Sarandë, Elbasan e Korçë kanë regjistruar respektivisht rreth 4 % të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat e Përmet kanë regjistruar respektivisht rreth 3 % të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë, Gjirokastër, Pogradec, Lushnje, Kukës, Kurbin, Kavajë, Krujë, Tropojë, Mat, Dibër e prokuroria për krime të rënda kanë regjistruar në vitin 2019 një

numër procedimesh më të ulët se 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.


Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë veprë penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i Dokumenteve” për vitin 2019 është 27,78 %, ndërkohë që vitin 2018 është 25,80 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2019 procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, kanë pësuar një rritje prej 14,95 % krahasuar me një vit më parë.

Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 10,75 % për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2018 rezulton 12,86 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore, në vitin 2019 vërehet ulje prej 10,71 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, në krahasim me vitin 2018.

VEPRAT PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e IX-të të Kreut të tretë të Kodit Penal, veprat penale në fushën e falimentimit, ku siç vërehet gjatë vitit 2019 nuk është regjistruar asnjë procedim penal.

VEPRA PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 193 Falimentimi i provokuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 194 Fshehja e gjendjes së falimentimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 195 Fshehja e pasurisë pas falimentimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 196 Shkelja e detyrimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,47 %, ndërsa për vitin 2018 është 0,60 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 5,03, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 6,58.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e III, seksioni X i Kodit Penal “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”:


ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 197 Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të	183	117	136	120	98	133	55	56	59	64

lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin ³⁹ Neni 197/a Paracaktimi i rezultatit në garat sportive Neni 197/b Shtrembërimi i konkurrencës në garat sportive Neni 198 Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara Totali	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	5	1	3	3	2	10	3	2	4	4
	189	118	139	123	100	144	58	58	63	68

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje të gjithë treguesve e konkretisht: ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”, në krahasim me vitin 2018 me 23,81 %, ulje të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë me 50,85 %, ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale me 58,27 % përkundrejt këtij totali në vitin 2018, ulje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 48,78 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 32 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



³⁹ Dispozita është ndryshuar me ligjin 44/2019

TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit rezultojnë 98,84 % meshkuj të rritur dhe 1,16 % femra të rritura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 17,44 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 59,30 % me arsim të mesëm dhe 23,26 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Sa i përket gjendjes shoqërore, të punësuar në sektorin privat rezultojnë 72 % e të pandehurve dhe 28 % rezultojnë të papunë.

Nga treguesit vërehet se 79,01 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 20,99 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve, 93,90 % janë të padënuar më parë, 2,44 % e tyre rezultojnë të dënuar për të njëjtën vepër dhe 93,90 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Organizimi i lotarive të palejuara


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” është 92,36 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 96,83 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”, në vitin 2019, me 27,32 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që përbën 32 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 14 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lushnje, Pogradec e Berat kanë regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier e Krujë, kanë regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve, ndërsa prokuroritë Sarandë e Kavajë kanë regjistruar secila një numër procedimesh që përbën rreth 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Tropojë, Mat e Vlorë kanë regjistruar respektivisht rreth 2 % të totalit të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë, Përmet, Kurbin e Shkodër kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë 1 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Kukës e Pukë nuk kanë regjistruar procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”, në vitin 2019.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 6,22 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues ka qenë 4,75 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 66,69, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 51,95.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin XI, të Kreut të III të Kodit Penal “Vepra Penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës”:


RREGJIMI JURIDIK I TOKËS	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	16	3	5	3	3	44	2	1	2	3
Neni 199/a Ndërtimi i paligjshëm	1310	854	748	851	797	1743	935	1043	953	648
Neni 199/b Dhënia e ndihmës për ndërtim të	1	3	7	11	7	3	0	5	4	9

paligjshëm										
Neni 200 Pushtimi i tokës	164	47	78	58	44	119	49	40	58	37
Totali	1491	907	838	923	851	1909	986	1089	1017	697

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 28,03 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës në krahasim me vitin 2018 dhe rritje prej 8,71 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje prej 29,95 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 10,18 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 18,10 % krahasuar me vitin 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rregjimit juridik të tokës për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë të gjithë të pandehurit të rritur ku 6,50 % e përbëjnë femrat dhe 93,50 % meshkujt.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 38,17 % janë me arsim të mesëm, 3,25 % të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër prej 58,58 % me arsim 9 vjeçar.

Në sektorin privat rezultojnë të punësuar në sektorin privat 42,88 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 1,28 % dhe pjesa tjetër e të pandehurve prej 55,84 janë të papunë.

Nga treguesit vërehet se 34,05 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 65,95 % prej tyre në fshat. Pra për këtë grup vërehet tendenca më e lartë në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 98,06 janë të padënuar më parë, 0,20 % e të pandehurve përsëritës për të njëjtën veprë dhe 1,74 % përsëritës për vepra të ndryshme penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndërtimi i paligjshëm


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës është 91,30 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 87,86 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga paraqitja grafike vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm” në vitin 2019 prej 33,05 % në krahasim me vitin 2018.


Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj veprë në vitin 2019 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë e Elbasan që përbëjnë respektivisht 16 % dhe 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në vijim prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës që ka regjistruar 12 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë e Berat që kanë regjistruar respektivisht 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnjë që ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë ka regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Krujë, Lezhë, Sarandë e Kurbin kanë regjistruar nga 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Fier, Kukës, Tropojë e Gjirokastër kanë regjistruar respektivisht 2 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Pogradec, Kavajë, Mat, Pukë e Përmet kanë regjistruar një numër procedimesh më të vogël se 1,5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi

gjatë vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm”.

Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë veprë penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,87 %, ndërkohë që për vitin 2018 është 0,79 %. Pra vihet re rritje e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 9,29, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 8,60.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”:

	2018	2019
--	------	------

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT ⁴⁰										
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 201 Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës	62	38	50	48	40	36	20	29	24	10
Neni 201/a Menaxhimi i mbetjeve						0	0	0	0	0
Neni 201/b Transportimi i mbetjeve										
Neni 201/c Aktivitetet e rrezikshme						0	0	0	0	0
Neni 201/ç materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme										
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 202/a Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër						0	0	0	0	0
Neni 202/b Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore						0	0	0	0	0
Neni 203 Substancat ozonholluese	9	2	2	4	0	8	0	1	0	1
Neni 204 Peshkim i ndaluar	6	5	7	8	6	5	3	5	3	4
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	143	29	84	35	20	163	40	74	43	30
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë	10	2	5	3	5	20	0	5	0	2
Neni 206/a Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	12	1	1	1	1	14	0	1	0	0
Neni 206/b Shkatërrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve	5	1	1	3	1	13	2	5	2	1
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	0	0	0	0	0	5	0	0	0	0
Neni 207/a Braktisja e kafshës së shoqërim						1	1	1	1	0
Neni 207/b Vrasja me dashje e kafshës së shoqërim										
Neni 207/c Keqtrajtimi i kafshës						1	0	0	0	0
Neni 207/ç Ndeshjet ndërmjet kafshëve										
Totali	247	78	150	102	73	266	66	121	73	48


TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 7,69 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2018 dhe ulje prej 15,38 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej

⁴⁰ Në këtë kre, me ligjin 44/2019, është ndryshuar neni 201, janë shtuar nenet 201/a deri 201/ç, është ndryshuar neni 202, janë shtuar nenet 202/a dhe 202/b, është ndryshuar neni 203, janë shtuar nenet 207/a deri 207/ç

19,33%, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 28,43 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 34,25 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër mjedisit për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit, janë meshkuj të rritur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40,22 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 46,74 % me arsim të mesëm dhe 13,04 % e të pandehurve janë me arsim të lartë.

Të punësuar në sektorin privat rezultojnë 52,38 % e të pandehurve dhe të papunë rezultojnë të jenë 47,62 %.

Ndërsa lidhur me vendbanimin rezulton se 54,35 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 45,65 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 94,38 % janë të padënuar më parë, 3,37 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 2,25 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndotja e ajrit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 13,53 % për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 25,10 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore në vitin 2019, vërehet tendenca në ulje prej 41,94 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit” në krahasim me vitin 2018.

Prerja e paligjshme e pyjeve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” për vitin 2019 është 61,28 %, ndërsa në vitin 2018, 57,89 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”, në vitin 2019 prej 13,99 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ka regjistruar numrin më të madh të procedimeve penale për këtë veprë, 32 të tilla ose 20 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi për këtë veprë. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kurbin e Tiranë kanë regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë ka regjistruar 5 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Shkodër kanë regjistruar respektivisht 4 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat e Mat kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën 3 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Tropojë, Gjirokastrë, Përmet, Lushnje, Kukës, Lushnje, Sarandë, Vlorë e Fier kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 %, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kavajë e Pukë nuk kanë regjistruar procedime në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”.

KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES

dhe

KRIME QË CËNOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA

Pesha specifike që zënë krimet kundër rendit kushtetues dhe krimet që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019, është 0,013 % ndërsa në vitin 2018 ka qenë 0,016 %.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra:

KREU V - KREU VI	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Krime kundër Pavarësisë e Rendit Kushtetues	5	0	0	0	0	4	2	2	2	0
Krime që çënojnë Marrëdhëniet me Shtetet e tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	5	0	0	0	0	4	2	2	2	0

Krime kundër rendit kushtetues

Të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 4 procedime penale me 2 të pandehur për krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues dhe janë dërguar për gjykim 2 procedime me 2 të pandehur.

Konkretisht, janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 223 i Kodit Penal “Thirrjet publike për veprime të dhunshme” dhe 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 225 i Kodit Penal “Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese”.

VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE

Pesha specifike që zënë veprat me qëllime terroriste në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2019 është 0,03 %, ndërsa në vitin 2018 ky tregues ka qenë 0,013.

VEPRA PENALE ME QËLLIME TERRORISTE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykat ë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pan d dënu ar
Neni 230 Vepra me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 230/a Financimi i terrorizmit	4	0	0	0	0	3	0	4	0	0
Neni 230/b Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/c Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/ç Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 231 Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232 Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 232/a Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232/b Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 233 Krijimi i turmave të armatosura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234 Prodhimi i armëve luftarake	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/a Organizata terroriste	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 234/b Banda e armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	4	0	0	0	0	10	0	4	0	0

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore rezulton se totali i procedimeve të regjistruara për vepra penale me qëllime terroriste në vitin 2019 është 10, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 4.

Prokuroria në vitin 2019 ka regjistruar:

3 procedime penale për nenin 230 të Kodit Penal “Vepra me qëllime terroriste”;

3 procedime penale për nenin 230/a të Kodit Penal “Financimi i terrorizmit”

2 procedime penale për nenin 232 të Kodit Penal “Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”;

2 procedime penale për nenin 234/a të Kodit Penal “Organizata terroriste”.

**VEPRA PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR
DHE ORGANIZATA KRIMINALE**

Pesha specifike që zënë veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2019 është 0,17 %, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 0,13 %.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra:


KRIMI I ORGANIZUAR	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. Pand. Regj	Nr. Pand. për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 333 Organizata kriminale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 333/a Grupi i strukturuar kriminal	41	6	70	30	51	51	13	111	126	13
Neni 334 Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	0	0	0	0	9	0	0	0	0	0
Totali	41	6	70	30	60	51	13	111	126	13

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 janë regjistruar 51 procedime penale me 111 të pandehur për vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të gjitha këto procedime të regjistruara për nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”. Ndërsa në vitin 2018 rezultojnë 41 procedime të regjistruara për këto grup vepra penale.

Ndërkaq në vitin 2019, 13 procedime penale me 126 të pandehur janë dërguar në gjykatë dhe janë dënuar 13 të pandehur për këto vepra penale.

Grafikisht tendenca e veprave penale të krimit të organizuar për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë 97,76 % meshkuj të rritur dhe 2,24 % femra të rritura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 6,72 % janë me arsim të lartë, 83,21 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe 10,07 % me arsim 9-vjeçar.

Rezultojnë 8 shtetas të huaj ndër të pandehurit për këto grupvepra.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 10,07 % e të pandehurve, në sektorin privat janë punësuar 75,37 % e të pandehurve, ndërsa 14,55 % e tyre rezultojnë të papunë.

Lidhur me vendbanimin rezulton se 66,79 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 33,21 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 4,10 % rezultojnë përsëritës për vepra penale të ndryshme ndërsa pjesa tjetër 95,90 %, janë të padënuar më parë.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,89 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 1,98 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 20,30, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 21,60.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e VIII, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit”:

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	48	27	28	27	22	38	19	26	22	21
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	172	150	266	224	163	181	124	379	237	108
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës	103	71	96	83	78	94	66	90	89	57
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	32	8	15	8	13	48	3	16	5	2
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik	257	198	221	214	120	210	145	164	159	137
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore	0	0	0	0	1	3	0	0	0	0
Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	6	1	3	1	0	7	3	3	3	2
Totali	620	455	629	557	397	581	360	678	515	327

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2019 ka një ulje prej 6,29 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” në krahasim me vitin 2018. Ndërkaq kemi ulje prej 20,88 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje 7,79 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundërt këtij totali në vitin 2018, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 7,54 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 17,63 % përkundërt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër autoritetit të shtetit për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, rreth 1,16 % kanë qenë të pandehur të mitur. Të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) janë regjistruar 98,84 %, nga të cilët 98,17 % janë meshkuj dhe 1,83 % femra.

Në këtë grup veprash rezultojnë edhe 1 i pandehur i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 39,86 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 49,87 % me arsim të mesëm dhe 10,47 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 5,56 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 52,19 % e të pandehurve dhe të papunë 69,25 %.

Rezulton se 69,24 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 30,76 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve rreth 89,73 % janë të padënuar më parë ndërsa 10,27 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT


Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 6,54 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 7,74 %. Për këtë vepër gjatë vitit 2019 janë regjistruar 38 procedime ose 20,83 % më pak se në vitin 2018.

Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 31,15 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 27,74 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” prej 5,23 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 33 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Vlorë kanë regjistruar respektivisht 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë ka regjistruar 6 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier e Shkodër kanë regjistruar 4 %, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër, Berat, Lezhë e Pogradec kanë regjistruar 3 % të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Krujë, Kavajë, Përmet e Sarandë kanë regjistruar përkatësisht 2 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kurbini, Lushnje, Kukës, Tropojë, Dibër e Pukë kanë regjistruar në vitin 2019, një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 1,5 % të numrit total të procedimeve, ndërkaq prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Mat nuk ka regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

Goditjet për shkak të detyrës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” në vitin 2019 është 16,18 %.

Për këtë vepër penale rezulton tendenca në ulje prej 8,74 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 36,14 % në vitin 2019, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 41,45 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësimit të policisë së rendit publik”, në vitin 2019, prej 18,29 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 37 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë e Durrës kanë regjistruar respektivisht 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Kurbin ka regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier e Kukës, kanë regjistruar 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Gjirokastër, Krujë, Pogradec, Lezhë e Lushnje kanë regjistruar respektivisht 2 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Kavajë, Pukë, Rasandë e Përmet kanë regjistruar në vitin 2019 një numër procedimesh më të vogël se 2 % të procedimeve në shkallë vendit, ndërsa prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tropojë nuk ka regjistruar procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 3,07 % ndërsa në vitin 2018 pesha e kësaj vepre ka qenë 2,62 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 32,87, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 28,60.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu VIII, Seksioni II, “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik”:

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. d. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 248 Shpërdorim detyre	737	75	169	184	93	881	82	234	186	92
Neni 248/a Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij	1	0	0	0	0	4	1	2	1	0
Neni 250 Kryerja e Veprimeve arbitrare	42	4	9	8	6	36	5	10	8	6
Neni 251 Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0
Neni 252 Mbajtja në burg pa vendim	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 253 Shkelja e barazisë së shtetasve						0	0	0	0	0
Neni 254 Shkelja e paprekshmërisë së banesës	1	0	2	0	0	0	0	0	0	0
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës						0	0	0	0	0
Neni 256 Shpërdorim i kontributeve të dhëna nga shteti	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 257 Përfitim i paligjshëm i interesave	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 257/a Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë	24	14	13	14	11	11	6	2	6	6
Neni 258 Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike	14	1	0	0	0	8	1	0	6	0
TOTALI	821	94	193	207	111	941	95	248	207	104

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 ka një rritje prej 14,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, në krahasim me vitin 2018 dhe rritje të lehtë prej 1,06 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 28,50 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është i njëjtë me atë të një viti më parë, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 6,31 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit rezultojnë të rritur (mbi 18 vjeç) ku 11,63 % femra dhe 88,37 % meshkuj.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë 71,58 % e të pandehurve. Nga këta, 8,40 % janë funksionarë; 6,11 % nëpunës të nivelit të lartë; 13,74 % e të pandehurve janë nëpunës të nivelit të mesëm; 6,11

% janë nëpunës të nivelit të ulët; 54,95 % e të pandehurve janë punonjës të nivelit ekzekutiv dhe 10,69 % punonjës policie.

Rezulton se 86,42 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 13,58 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 97,64 % e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shpërdorim detyre


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2019 në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” është 93,62 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues ka qenë 89,77 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”, në vitin 2019, prej 19,54 % në krahasim me vitin 2018.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2019 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve për këtë veprë penale e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës, që përbën 23 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë ka regjistruar 18 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 12 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë, Lezhë e Berat kanë regjistruar respektivisht 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë ka regjistruar përkatësisht 4 % të procedimeve penale, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë e Sarandë kanë regjistruar respektivisht 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier, Kavajë, Dibër, Krujë, Lushnjë, Kukës, Kurbin, Pogradec, Tropojë, prokuroria për krime të rënda, Pukë, Përmet, e Mat kanë regjistruar më pak se 2 % të procedimeve penale në shkallë vendi gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”.


Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë veprë penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



Kryerja e veprimeve arbitrare

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” në vitin 2019 është 3,83 % ndërsa në vitin 2018 ka qenë 5,12 %. Pra ky tregues rezulton në ulje për vitin 2019.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal "Kryerja e veprimeve arbitrare" në vitin 2019, prej 14,59 % në krahasim me vitin 2018.

Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë në vitin 2019 është 1,17 % ndërsa në vitin 2018 ka qenë 2,92 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në vitet 2014-2018 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet se për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” ka tendencë në ulje të numrit të procedimeve e konkretisht nga 24 procedime të regjistruara në vitin 2018, në 11 procedime të regjistruara në vitin 2019 ose e shprehur në përqindje, ulje me 54,17 %.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë në vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e ka prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që ka regjistruar 5 procedime ose 46 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Kavajë ka regjistruar 2 procedime penale ose 18 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Elbasan, Sarandë e Shkodër kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 9 % të procedimeve gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 17,89 % ndërsa në vitin 2018 ka qenë 18,12 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 191,83, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 198,20.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun VIII, Seksioni III, “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”:

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënua r
Neni 261 Pengimi në ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	32	2	28	16	11	51	4	95	9	0
Neni 263 Organizimi i grumbullimeve e manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 264 Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve	2	2	0	2	0	4	0	0	0	0
Neni 265/a Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265/b Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265/c Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik	1	0	0	0	0	4	0	1	0	0
Neni 268 Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 269 Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 270 Rebelimi i të burgosurve	0	0	0	0	0	2	2	24	24	7
Neni 271 Disinformimi i ekipeve të urgjencës	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit	20	10	6	10	6	19	3	4	3	5
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	257	90	95	93	82	268	81	75	87	58

Neni 274 Prishja e qetësisë publike	77	41	40	56	35	93	41	68	52	38
Neni 274/a Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv ⁴¹						1	0	0	0	0
Neni 274/b Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive										
Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrjeve telefonike	432	52	57	53	22	384	27	55	29	23
Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblems së Kryqit të Kuq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 277 Vetëgjyqësia	211	81	86	102	85	228	86	97	101	64
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit	400	183	263	212	150	361	183	259	216	183
Neni 278/b Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore ose kimike										
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta	116	63	94	66	47	90	71	93	79	59
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjutisë dhe sportive	64	42	46	43	38	50	21	36	23	26
Neni 281 Shkelja e rregullave mbi lëndët helmuese	0	0	0	0	0	3	1	1	1	0
Neni 282 Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese	5	2	3	4	4	5	1	3	1	1
Neni 282/b Stërvitja për prodhimin dhe përd. e paligjshëm të armëve e lend. të tjera të rrezik.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
282/c	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 283/b Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përd. e drogës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/ç Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/d Prodhimi dhe tregtimi i barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin	1	0	1	0	0	3	0	12	0	0
Neni 285/a Përshtatja e lokalit për përdorim droge	2	0	2	0	0	5	3	6	4	0

⁴¹ Shtuar nenet 274/a, 274/b, 278/b, ndryshohet neni 282/a dhe 288, shtohen nenet 288/c dhe 288/ç dhe ndryshohet neni 293 me ligjin 44/2019


Neni 285/b Hedhja ose braktisja e shiringave	5	0	2	0	0	0	1	0	2	0
Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0
Neni 286/a Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288 Importimi, prodhimi, shitja dhe ruajtja e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin ose jetën e njerëzve	17	2	2	2	1	5	0	2	0	2
Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrial dhe ushqimorë	48	13	28	13	12	22	20	16	21	17
Neni 288/b Tregtimi dhe hedhja për konsum e lëndëve djegëse në kundërshtim me standardet ligjore të cilësisë	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 288/c mashtrimi me produktet ushqimore										
Neni 288/ç Prishja e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore										
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	121	11	29	17	10	104	14	34	18	12
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	880	356	665	366	260	929	296	665	311	272
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	2984	2897	3178	2907	2371	2841	2467	2948	2490	2002
Neni 292 Shkelja e disiplinës së punës në transport	3	0	0	0	3	3	0	1	0	0
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit	4	3	3	8	16	14	0	4	1	0
Neni 293/d Shitja e paautorizuar e kartave SIM	4	3	5	4	1	1	0	0	0	0
Totali	5689	3854	4634	3975	3157	5491	3322	4499	3472	2769

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore për “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” rezulton se në vitin 2019 ka një ulje të gjithë treguesve e konkretisht, ulje prej 3,48 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje prej 13,80 % të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundëjt këtij totali në vitin 2018 prej 2,91 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë

dërguar në gjykatë prej 12,65 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 12,29 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Nga të pandehurit, 4,18 % kanë qenë të pandehur të mitur dhe 95,82 % të rritur (mbi 18 vjeç). Të pandehurit meshkuj përbëjnë edhe për këtë grup veprash pjesën më të madhe e konkretisht 97,75 % ndër të cilët 4,28 % të mitur dhe 2,25 % femra ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura.

Rezultojnë 23 të pandehur me shtetësi të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 46,62 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 43,77 % me arsim të mesëm dhe 9,61 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë rreth 1,36 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë të punësuar 29,95 % e të pandehurve dhe të papunë 68,69 %.

Rezulton se 62,17 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 37,83 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 94,76 % e tyre janë të padënuar më parë, 4,76 % prej tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 0,48 % përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 0,93 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 0,56 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet rritje prej 59,38 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” në vitin 2019, ku konkretisht rezultojnë 51 procedime të regjistruara kundrejt 32 procedimeve në vitin 2018.

Largimi nga vendi i aksidentit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 4,88 % për vitin 2019, ndërsa në vitin 2018 pesha specifike e kësaj vepre ka qenë 4,52 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, në vitin 2019 janë rritur 4,28 % krahasuar me vitin 2018.

Prishja e qetësisë publike


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 1,69 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 1,35 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet rritje prej 20,78 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal “Prishja e qetësisë publike” në vitin 2019, ku konkretisht rezultojnë 93 procedime të regjistruara kundrejt 77 procedimeve në vitin 2018.

Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 6,99 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 7,59 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, në vitin 2019, prej 11,11 % në krahasim me vitin 2018.

Vetëgjyqësia


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2019 është 4,15 %, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 3,71 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”, në vitin 2019, prej 8,06 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ku janë regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier, Sarandë, Durës, lezhë e Vlorë ku janë regjistruar rreth 7 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastër ku janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Kukës ku janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë, Tropojë, Berat, Kavajë, Kurbin, Lushnje e Pukë janë regjistruar respektivisht 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Krujë, Pogradec, Shkodër, Mat e Përmet është regjistruar një numër procedimesh më i ulët se 2 % i numrit total të procedimeve të regjistruara për vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2019 është 6,57 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 7,03 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” i Kodit Penal në vitin 2019, prej 9,75 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 27 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Elbasan janë regjistruar përkatësisht 9 % dhe 8 % e procedimeve penale, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë, Shkodër e Vlorë janë regjistruar 7 % e procedimeve penale, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Lushnje janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Krujë, Mat, Dibër e Kukës janë regjistruar respektivisht rreth 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kavajë, Gjirokastrë, Pogradec, Sarandë, Tropojë, Përmet, Pukë dhe prokuroria për krime të rënda, kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 1,5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2019 për nenin 278 të Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve ushtarake dhe municionit”.


Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë vepër penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2019 është 1,64 %, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 2,04 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në vitin 2019 prej 22,41 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 31 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 20 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 6 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 5 % e procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat e Shkodër janë regjistruar përkatësisht rreth 4 % e procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë, Lushnje, Kavajë, Pogradec, Dibrë, Kurbin e Tropojë është regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Mat, Përmet, Pukë e Sarandë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” në vitin 2019 është 0,91 %, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 1,12 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, në vitin 2019 prej 21,86 % në krahasim me vitin 2018.

Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2019 është 0,40 %, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 0,84 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 288/a i Kodit Penal "Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë", në vitin 2019, prej 54,17 % në krahasim me vitin 2018.

Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike" për vitin 2019 është 1,89 %, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 2,13 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, në vitin 2019, prej 14,05 % në krahasim me vitin 2018.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2019 është 16,92 %, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 15,47 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në vitin 2019, prej 5,57 % në krahasim me vitin 2018.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2019 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Krujë, Kurbin e Lushnje janë regjistruar përkatësisht 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Berat janë regjistruar përkatësisht 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e tjera është regjistruar një numër procedimesh më i vogël se 2,5 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2019 dhe në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Pukë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.


Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë vepër penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2019 është 51,74 %, që përbën edhe peshën më të lartë, ndërsa në vitin 2018 ky tregues ka qenë 52,44 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" në vitin 2019, prej 4,79 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë për vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që përbën 36 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Durrës janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë, Shkodër e Fier janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lushnje, Berat e Vlorë janë regjistruar përkatësisht 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Kavajë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Sarandë e Dibër janë regjistruar përkatësisht rreth 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2019, ndërkohë që prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Përmet nuk ka regjistruar procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”.

VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,77 %, ndërsa në vitin 2018 ky tregues ka qenë 0,86 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 8,24, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 9,37.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale:

PASTRIMI I PARAVE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pan d. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. pand. Regj	Nr. Pan d. në gjyk.	Nr. Pan d dën uar
Neni 287 Produktet e veprës penale ose veprimtarisë kriminale	257	17	35	30	13	232	19	32	31	9
Neni 287/a Llogari anonime	2	0	1	0	2	0	0	0	0	0
Neni 287/b Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale	10	6	14	26	12	4	5	9	16	13
Totali	269	23	50	56	27	236	24	41	47	22

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 12,27 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në krahasim me vitin 2018. Ndërkaq kemi rritje 4,35 %, të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar me 18 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur me 16,07 % ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 18,52 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër pastrimit të parave për vitet 2018-2019 paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) meshkuj 91,38 % dhe femra 8,62 %.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 31,04 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 60,34 % me arsim të mesëm dhe 8,62 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se 53,85 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 46,15 % janë të papunë.

Rezulton se 67,24 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 32,76 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 79,31 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, ndërsa 20,69 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale për vitin 2019 është 98,31 % ndërsa në vitin 2018 ka qenë 95,54 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Gjatë vitit 2019 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, prej 9,73 % në krahasim me vitin 2018.

Sa i përket shpërndarjes gjeografike të procedimeve, grafiku në vijim paraqet të dhëna të detajuara sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 27 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës, Fier, Elbasan e Vlorë janë regjistruar përkatësisht 8 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë e Kurbin janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastër janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër e Korçë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Sarandë, Lushnje, Krujë, Kukës, Mat, Tropojë, Kavajë e prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 2 % të numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Nga ana tjetër, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Përmet, Pogradec e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.


Të dhënat në lidhje me procedimet e regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë për këtë vepër në dy vitet e fundit si dhe krahasimi në përqindje, paraqitet në grafikun në vijim:



Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprave penale, në vitin 2019 është 1,69 %, ndërsa në vitin 2018 pesha e kësaj vepre brenda grupit ka qenë 3,72 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Gjatë vitit 2019 vërehet trend në ulje në numrin e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, nga 10 procedime penale në vitin 2018 në 4 procedime penale.

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËTORË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2019 është 4,75 %, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 3,83 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është, 50,90 ndërsa në vitin 2018 ka qenë 41,84.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me “Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë”:


VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËTORË	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj.	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj.	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj.	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar

Neni 294 Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 295 Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete	2	0	0	0	0	6	0	0	0	0
Neni 296 Humbja e dokumenteve sekrete	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 297 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	1096	630	1082	661	477	1325	623	1364	642	456
Neni 298 Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit	99	27	102	44	14	124	36	139	56	23
Neni 299 Shkelja e rregullave mbi fluturimet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	1201	657	1184	705	491	1457	660	1504	699	479

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është rritur 21,32 % në krahasim me vitin 2018 dhe numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur 0,46 % në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 27,03 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 0,85 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 2,44 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 98,05 % meshkuj dhe 1,95 % femra.

Të pandehur të huaj rezultojnë 22.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 54,18 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 44,99 % me arsim të mesëm dhe 0,83 % me arsim të lartë.

Të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 5,06 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 2,33 % dhe pjesa tjetër prej 92,61 % rezulton e papunë.

Rezulton se 47,68% e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 52,32 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 97,10 % e tyre janë të padënuar më parë, 2,66 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,24 % përsëritës për të njëjtën vepër.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT


Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 janë regjistruar 6 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 295/a i Kodit Penal “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, kundrejt 2 procedimeve të regjistruara në vitin 2018.

Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” në vitin 2019 është 90,94 %, ndërsa në vitin 2018 ky tregues ka qenë 91,26 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, në vitin 2019, prej 20,89 % në krahasim me vitin 2018.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhënat lidhur me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale për këtë veprë në vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë pranë gjykatës së

shkallës së parë Tiranë, që përbën 45 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 19 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Pogradec e Dibër janë regjistruar respektivisht 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë vërehet një numër procedimesh i barabartë me 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Kukës janë regjistruar përkatësisht 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier, Elbasan, Tropojë, Lezhë e Mat janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 1 % të numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Nga ana tjetër, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lushnje, Përmet e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”.


Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë veprë penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” për vitin 2019 është 8,51 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues ka qenë 8,24 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, në vitin 2019, prej 25,25 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, për nenin 298 të Kodit Penal gjatë vitit 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër, 29 procedime penale që përbëjnë 23 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi e në vijim në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë ku janë regjistruar 24 procedime penale ose 19 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë ku janë regjistruar 16 procedime ose 13 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Pogradec ku janë regjistruar nga 16 procedime ose 13 % e numrit total të procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Kukës ku janë regjistruar 11 procedime ose 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 4 procedime penale ose 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2019. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier, Sarandë, Vlorë, Elbasan, Lezhë, Përmet, Pukë e prokuroria për krime të rënda, kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % të numrit total të procedimeve e ndërkaq, prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror”.

Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë veprë penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,11 % ndërsa për vitin 2018 ka qenë 2,42 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 22,64, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 26,44.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e IX “Vepra penale kundër drejtësisë”:


VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 300 Moskallëzimi i krimi	20	29	93	136	98	19	20	62	79	67
Neni 301 Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës	14	10	19	24	13	8	10	15	20	12
Neni 302 Përkrahja e autorit të krimi	2	1	4	8	3	7	5	16	7	3
Neni 303 Fshehja ose asgjësimi i kufomës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 304 Detyrimi për të kallëzuar provën	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 305 Kallëzimi i rremë	66	45	60	49	35	46	42	40	47	35
Neni 305/a Deklaratat e rreme përpara prokurorit	2	1	1	1	2	0	0	0	0	0
Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara of.pol.gjyq.	11	9	16	19	12	19	13	13	21	11
Neni 306 Dëshmia e rreme	12	5	8	5	3	7	7	4	8	8
Neni 307 Refuzimi për të dëshmuar	1	0	0	0	1	1	0	1	0	0
Neni 308 Përkthimi i rremë						1	0	0	0	0
Neni 309 Ekspertimi i rremë	38	5	10	7	2	26	2	2	2	3
Neni 310 Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 311 Kanosja për të mos kallëzuar	6	2	4	2	2	6	3	4	4	2
Neni 312/a Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë	3	0	1	0	0	1	1	1	1	0
Neni 313 Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 313/a Zhdukja ose humbja e fashikullit						3	0	0	0	0
Neni 313/b Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 314 Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 316 Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit	7	3	5	3	2	2	3	0	4	2

Neni 317 Kanosja e gjyqtarit	8	2	7	2	0	10	3	5	3	2
Neni 318 Fyerja e gjyqtarit	23	5	16	6	1	15	7	7	7	4
Neni 320 Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës	138	35	44	39	21	102	29	25	30	19
Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës	6	0	0	0	2	3	1	0	1	0
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës	125	76	76	70	34	123	65	79	66	46
Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit	45	31	44	32	24	55	44	47	45	30
Neni 324 Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim	1	1	1	1	0	2	0	1	0	0
Neni 324/a Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim	231	125	117	135	127	190	74	101	86	86
Totali	759	385	526	539	382	648	329	423	431	330

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 14,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2018 e ndërkaq kemi ulje prej 14,55 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar prej 19,58 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 20,04 %, përkundrajt këtij totali në vitin 2018 dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13,61 % krahasuar me një vit më parë.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër drejtësisë për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, vetëm 2,07 % rezultojnë të mitur dhe 97,93 % të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç). Sa i përket gjinisë së të pandehurve, rezulton se 10,56 % janë femra dhe 89,44 % meshkuj.

Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 3 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 45,44 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 44,40 % me arsim të mesëm dhe 10,16 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 1,55 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 19,69 % e të pandehurve dhe të papunë 78,76 %.

Sa i përket vendbanimit, vërehet se 71,49 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 28,51 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 73,61 % janë të padënuar më parë, 25,75 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,64 % janë përsëritës për të njëjtën veprë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kallëzimi i rremë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2019 në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” është 7,10 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues përbënte 8,70 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë e lartë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal “Kallëzimi i rremë”, në vitin 2019, prej 30,30 % në krahasim me vitin 2018.

Ekspertimi i rremë


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2019 në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” është 4,01 %, ndërsa për vitin 2018 ky tregues përbënte 5 % të grupit.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal “Ekspertimi i rremë”, në vitin 2019, prej 31,58% krahasuar me vitin 2018, e konkretisht nga 38 në 26 procedime penale.

Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2019 është 15,74 %, tregues në ulje krahasuar me vitin 2018 gjatë të cilit pesha specifike e kësaj vepre ishte 18,18 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, në vitin 2019, prej 26,09 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale sipas prokurorive, për këtë vepër penale në vitin 2019:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 30 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 12 % e procedimeve, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier ka regjistruar 9 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 7 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastër, Lezhë e Vlorë kanë regjistruar 6 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Kavajë ka regjistruar 3 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Mat, Berat, Krujë, Kurbin, Lushnje, Pogradec, Pukë e Shkodër kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkohë, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë, Kukës, Përmet e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” gjatë vitit 2019.

Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2019 është 18,98 %, ndërsa në vitin 2018 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë vepër përbënte 16,47 % të totalit të grupit.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, në vitin 2019, prej 1,60 % në krahasim me vitin 2018.

Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2019 është 8,49 %, ndërsa në vitin 2018 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë vepër përbënte 5,93 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, në vitin 2019, prej 22,22 % në krahasim me vitin 2018.

Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim

Kjo vepër penale ka peshën specifike më të lartë në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” edhe për vitin 2019, e konkretisht 29,32 %, ndërkohë që në vitin 2018 ky tregues ishte 30,43 %.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2019 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, prej 17,75 % në krahasim me vitin 2018.

Treguesit e ndjekjes penale për këtë vepër rezultojnë në shifrat si më poshtë:



Ecuria e kësaj vepre penale gjatë, 2016⁴²-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):

⁴² Dispozita është shtuar me ligjin nr. 135/2015, datë 5.12.2015



VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e X, “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve⁴³”.

Siç vërehet nga të dhënat, gjatë vitit 2019 janë regjistruar 23 procedime penale me 15 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 5 të pandehur për këto vepra dhe 4 të pandehur janë dënuar.

VEPRAT PENALE PËR ZGJEDHJET E LIRA	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 325 Pengimi i subjekteve zgjedhore	0	0	0	0	0	7	0	8	0	0
Neni 326 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve	0	2	0	13	0	5	1	1	4	4
Neni 327 Shkelja e fshehtësisë së votimit	0	0	0	0	2	3	0	0	0	0
Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 328/a Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0
Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

⁴³ Veçuar nga ky grup veprat penale të korrupsionit në zgjedhje dhe trajtuar në grupveprat penale të korrupsionit

Neni 330 Pengimi i zgjedhësit	0	0	0	0	0	5	1	6	1	0
Neni 330/a Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 331 Shkelja e të drejtës së zgjedhjes						0	0	0	0	0
Neni 331/a Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit ⁴⁴	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtarak						0	0	0	0	0
Neni 332/a Shpërdorimi i autoritetit policor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	2	0	13	3	23	2	15	5	4

VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,50 % ndërsa për vitin 2018 ky tregues ka qenë 0,55 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 5,41, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 6.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të korrupsionit:

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. d. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 124/a Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit	0	0	0	0	0	2	0	1	0	0
Neni 164/a Korrupsion aktiv në sektorin privat	1	1	2	2	0	1	0	0	0	2
Neni 164/b Korrupsion pasiv në sektorin privat	2	0	0	0	0	4	2	2	2	0
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	29	24	38	33	21	30	22	27	23	20
Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë	3	0	0	0	4	3	0	4	4	1
Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	23	19	21	27	22	23	19	27	35	27

⁴⁴ Shtuar me ligjin nr.89/2017


Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike	74	13	42	17	13	52	12	32	22	12
Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë	6	0	1	0	2	4	1	1	1	0
Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	3	0	7	4	2	2	0	7	2	2
Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	29	2	5	4	2	31	2	7	2	4
Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje	2	0	0	0	3	2	0	0	0	0
Neni 328/b Korrupsioni pasiv në zgjedhje	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Totali⁴⁵	172	59	116	87	69	155	58	109	91	68

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një ulje prej 9,88 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, në krahasim me vitin 2018 dhe ulje prej 1,69 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 6,03 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,60 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 1,45 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër korrupsionit për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:

⁴⁵ Korrigjuar totali i viti 2018, për shkak të gabimit aritmetik në shumën e neneve



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezulton se të gjithë të pandehurit janë të rritur (mbi 18 vjeç) ku, 13,48 % janë femra dhe 86,52 % meshkuj.

Rezulton 1 shtetas i huaj i pandehur për këto vepra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 10,11 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 35,39 % janë me arsim të mesëm dhe 54,49 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 61,63 % e të pandehurve (ndër të cilët 9,43 % janë punonjës policie), në sektorin privat rezultojnë të punësuar 22,09 % e të pandehurve dhe 16,28 % prej tyre rezultojnë të papunë.

Rezulton se 84,83 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 15,17 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 91,16 %, janë të padënuar më parë dhe 2,84 janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2019 në grupin e veprave penale të korrupsionit është 19,35 %, ndërsa në vitin 2018 pesha që zinte kjo vepër ka qenë 16,86 %. Pra vërehet rritje e peshës specifike të kësaj veprë në totalin e veprave penale të grupit.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Për vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, organi i prokurorisë ka regjistruar 30 procedime penale, që përbën rritje prej 3,45 % në krahasim me vitin 2018. Janë dërguar në gjykatë 22 procedime penale, ndërsa në vitin 2018 rezultojnë 22 procedime të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, krahasuar me vitin 2018 vihet re ulje nga 38 në 27 të pandehur të regjistruar dhe ulje nga 33 në 23 të pandehur dërguar në gjykatë në vitin 2019. Edhe numri i të pandehurve të dënuar në vitin 2019 është ulur nga 21 në 20.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë e kanë prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë që ka regjistruar 14 procedime ose 47 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës që ka regjistruar 4 procedime ose 13 % të numrit total të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Kurbin që ka regjistruar 3 procedime ose 10 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan, Shkodër e Vlorë kanë regjistruar respektivisht nga 2 procedime penale ose 7 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Lezhë e Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, gjatë vitit 2019.

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në vitin 2019 në grupin e veprave penale të korrupsionit është 14,84 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", nuk ka ndryshuar gjatë dy viteve të fundit.

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale të korrupsionit për vitin 2019 është 33,55 %, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 43,02 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2019, prej 29,73 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë veprë penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara edhe për këtë veprë penale e ka prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë konkretisht, 13 procedime që përbëjnë 25 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 10 procedime ose 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 7 procedime ose 13 % të numrit total të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë ka regjistruar 5 procedime ose 10 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër, Durrës, Kavajë, Pogradec e prokuroria për krime të rënda kanë regjistruar 2 procedime penale ose 4 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier, Korçë, Krujë, Lezhë, Lushnje, Shkodër e Tropojë kanë regjistruar respektivisht 1 procedim ose 2 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”.

Korrupsioni aktiv e pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendor

Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 3 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” po aq sa në vitin 2018. Sa i përket nenit 260 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, janë regjistruar 4 procedime penale kundrejt 6 procedimeve të regjistruara në vitin 2018 për këtë veprë, dhe 1 procedim penal është dërguar për gjykim.


Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Për vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, organi i prokurorisë ka regjistruar 2 procedime penale me 7 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2018 rezultojnë 3 procedime penale të regjistruara me 7 të pandehur regjistruar.

Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale të korrupsionit për vitin 2019 është 20 %, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 16,86 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”. Konkretisht organi i prokurorisë ka regjistruar 31 procedime penale me 7 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2018 janë regjistruar 29 procedime me 5 të pandehur. Janë dërguar në gjykatë 2 procedime penale me akuzë ndaj 2 të pandehurve dhe janë dënuar 4 të pandehur për vitin 2019 për këtë vepër penale.

KRIMI KIBERNETIK

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2019, është 0,37 %, po aq sa edhe në vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 4,02, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 4,01.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale kundër krimit kompjuterik për vitet 2018 e 2019:


KRIMI KIBERNETIK	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. kompj.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik	52	5	0	8	6	55	1	4	2	5
Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik	19	3	2	4	8	17	3	3	3	10
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik	11	0	0	0	2	8	1	2	1	0
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike	31	4	3	4	2	31	4	3	4	3
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike	2	0	2	0	0	3	1	1	1	0
Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	115	12	7	16	18	115	10	13	11	18

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 numri i procedimeve të regjistruara, është i njëjtë me një vit më parë, ka një ulje të numrit të procedimeve dërguar në gjykatë, nga 12 procedime në vitin 2018 në 10 procedime dërguar

në gjykatë në vitin 2019 (16,67 %), rritje të numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2019 përkundrejt këtij totali në vitin 2018 nga 7 në 13 (85,71 %), ulje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë nga 16 në 11 (31,25 %) dhe numri i të pandehurve të dënuar për vepra penale kundër krimit kompjuterik është i njëjtë me atë të vitit 2018.

Grafikisht tendenca e krimit kibernetik për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë të gjithë meshkuj të rritur (mbi 18 vjeç) nga të cilat 90 % meshkuj dhe 10 %.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 70 % e tyre janë me arsim të mesëm, 20 % me arsim të lartë, 10 % me arsim deri 9-vjeçar.

Rezulton se 50 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet dhe 50 % në fshat.


Ndërsa lidhur me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi kompjuterik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” për vitin 2019 është 47,83 %, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 45,22 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik” në vitin 2019, prej 5,77 % në krahasim me vitin 2018.

Shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale për vitin 2019, paraqitet më poshtë:




Siç vërehet nga paraqitja grafike, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë ka regjistruar numrin më të madh të procedimeve për këtë vepër penale, 38 procedime duke përbërë 69 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier ka regjistruar 4 procedime ose 7 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës e Kukës kanë regjistruar nga 3 procedime penale ose 5 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan, Krujë e Lezhë kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 4 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër ka regjistruar nga 1 procedim penal ose 2 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik”.

Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 26,96 % për vitin 2019, tregues i njëjtë me vitin 2018.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 293/b i Kodit Penal, “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, nuk ka ndryshuar në krahasim me vitin 2018.

TRAFIQET E PALIGJSHME

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,96 %, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 0,90 %. Pra, vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 10,31, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 9,89.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale kundër trafikëve të paligjshme:


TRAFIKIMI	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 110/a Trafikim i Personave të rritur	17	1	5	3	0	19	2	8	4	2

Neni 128/b Trafikimi i të miturve	5	1	2	3	4	6	1	0	2	4
Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës	4	0	4	0	0	1	2	0	2	0
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	139	3	14	5	2	170	10	14	12	2
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit	11	3	5	3	1	10	3	7	3	4
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive	3	0	2	0	0	2	2	1	3	0
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve	105	39	118	91	83	87	36	65	74	52
Totali	284	47	150	105	90	295	56	95	100	64

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 3,87 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafiqeve të paligjshme në krahasim me vitin 2018. Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur 19,15 % ndërsa në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vërehet një ulje prej 36,67 % e të pandehurve të regjistruar, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,76 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 28,89 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale të trafiqeve për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Sipas gjinisë, rezultojnë se 3,75 % janë femra dhe 96,25 % janë meshkuj.

Në vitin 2019 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 13 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 1,25 % janë me arsim të lartë, 35,00 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 63,75 % me arsim të mesëm.

Në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve rezulton se 58,97 % janë të punësuar në sektorin privat dhe 41,03 % janë të papunë.

Rezultojnë se 60,25 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 39,75 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 94,37 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 5,63 % prej tyre rezultojnë përsëritës në vepra të ndryshme penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Trafikimi i personave të rritur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2019 është 6,44 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave të rritur” në vitin 2019, prej 11,76 % në krahasim me vitin 2018, nga 17 në 19 procedime. Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur nga 1 procedim me 3 të pandehur në vitin 2018, në 2 procedime me 4 të pandehur për vitin 2019.

Trafikimi i të miturve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2019 është 2,03 % ndërsa në vitin 2018 ka qenë 1,76 %.

Numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”, në vitin 2019 është 6, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 5, ndërkohë numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është 1, po aq sa në vitin 2018. Edhe dënimet, në vitin 2019 rezultojnë po aq sa në vitin 2018, konkretisht 4 të dënuar.

Trafikimi i mjeteve motorike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” është 57,63 % për vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2018 ka qenë 48,94 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”, në vitin 2019, prej 22,30 % në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale për vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, për këtë veprë penale numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e ka prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, konkretisht 24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 14 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës ka regjistruar 12 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka regjistruar një numër procedimesh që përbën 10 % të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë ka regjistruar një numër procedimesh që përbën 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë ka regjistruar rreth 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier ka regjistruar rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë, Kukës e Shkodër kanë regjistruar rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Berat, Pogradec, Krujë, Kurbin, Dibër e Lushnjë kanë regjistruar më pak se 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kavajë, Korçë, Mat, Përmet, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”.

Trafikimi i armëve dhe i municionit

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 3,39 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, është ulur nga 11 procedime penale të regjistruara në vitin 2018, në 10 procedime penale në vitin 2019.

Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 0,34 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet ulje e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2019 krahasuar me një vit më parë, nga 4 në 1 procedim penal.

Trafikimi i narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2019 është 29,49 %, ndërkohë që në vitin 2018 ky tregues ka qenë 36,97 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve”, në vitin 2019 prej 17,14 % në krahasim me vitin 2018.

VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PRODHIMIN DHE KULTIVIMIN E NARKOTIKËVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2019 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 4,76 %, ndërsa për vitin 2018 ka qenë 4,52 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 51,04, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 49,44.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për veprat penale në lidhje me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve:

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2018					2019				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	1127	447	1099	614	483	833	383	843	517	401
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	292	46	99	66	60	628	66	238	104	72
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	1419	493	1198	680	543	1461	449	1081	621	473

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 ka një rritje prej 2,96 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2018 e ndërkaq kemi ulje prej 8,92 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2018 prej 9,77 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 8,68 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 12,89 % përkundrejt vitit 2018.

Grafikisht tendenca e veprave penale për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 96,30 % të pandehur meshkuj të rritur (mbi 18 vjeç) dhe 1,73 % meshkuj të mitur (14 deri 18 vjeç). Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 1,85 % femra të rritura dhe 0,12 % femra të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 49,81 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 44,90 % me arsim të mesëm dhe 5,29 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Në vitin 2019 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 2 shtetas të huaj.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 11,16 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin shtetëror 0,22 % dhe të papunë 88,62 %.

Rezulton se 64,93 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 35,07 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 90,13 % e tyre janë të padënuar më parë, 1,41 % janë përsëritës për të njëjtën vepër, ndërsa 8,46 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Prodhimi dhe shitja e narkotikëve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në këtë grup është 57,02 % për vitin 2019, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 79,42 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vihet re se për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2019 është ulur me 26,09 % krahasuar me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në shifra e përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2019:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara për këtë veprën penale e ka prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 27 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, e në vijim prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 10 % të totalit të procedimeve, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier që ka regjistruar rreth 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë, Pogradec, Shkodër e Korçë që kanë regjistruar respektivisht një numër procedimesh që përbën rreth 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë e Berat që kanë regjistruar respektivisht një numër procedimesh që përbën rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë ka regjistruar rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e tjera të shkallës së parë kanë regjistruar në vitin 2019, një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.


Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë veprën penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



Kultivimi i bimëve narkotike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale këtë grup është 42,98 % për vitin 2019, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 20,58 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje në vitin 2019 e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”, prej më shumë se dy herë (115 %) në krahasim me vitin 2018.

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2019 grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë që përbën 39 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Shkodër e Gjirokastrë kanë regjistruar respektivisht 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së Fier e Tiranë kanë regjistruar respektivisht 5 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Berat ka regjistruar 4 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë e Kurbin kanë regjistruar rreth 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Elbasan, Tropojë e Pukë kanë regjistruar përkatësisht rreth 2 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 1 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë prokuroria Kavajë nuk ka regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”.

Krahasuar me vitin 2018, trendi i numrit të procedimeve të regjistruara në çdo prokurori për këtë vepër penale në vitin 2019, rezulton si në grafik:



2.10 PËRMBLEDHJE E TENDENCAVE TË KRIMINALITETIT SIPAS GRUPVEPRAVE PENALE

Për vitin 2019 vërehet **tendenca në ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale** si më poshtë:

“Krimet Kundër jetës të kryera me dashje”, **17,14 %**;

“Veprat Penale kundër shëndetit të kryera me dashje”, **0,55 %**;

“Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, **10,14 %**;

“Veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit”, **2,13 %**;

“Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes⁴⁶”, **8,15 %**;

“Veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë⁴⁷”, **8,90 %**;

“Veprat penale të mashtrimit⁴⁸”, **15,85 %**;

“Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare⁴⁹”, **30,63 %**;

“Veprat penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare”, **51,35 %**;

“Krimet në fushën e doganave”, **16,23 %**;

“Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”, **23,81 %**;

“Veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale”, **12,27 %**;

“Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit⁵⁰”, **6,29 %**;

“Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike⁵¹”, **3,48 %**;

“Veprat penale kundër drejtësisë”, **14,62 %**;

“Veprat penale të korrupsionit”, **9,88 %**;

⁴⁶ Veçuar trafiku i të miturve

⁴⁷ Veçuar trafiku i mjeteve motorike dhe veprave të artit

⁴⁸ Veçuar mashtrimi kompjuterik

⁴⁹ Veçuar korrupsioni në sektorin privat

⁵⁰ Veçuar korrupsioni

⁵¹ Veçuar veprat lidhur me narkotikët

Për sa i përket veprave penale të mëposhtme, vihet re **një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara** për vitin 2019. Kështu:

- “Krimet kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi”, **75 %**;
- “Krimet kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi”, 2,75 herë ose 175 %;
- “Krimet seksuale”, **39,82 %**;
- “Veprat penale kundër lirisë së personit⁵²”, **29,76 %**;
- “Veprat penale të shkatërrimit të pronës”, **1,04 %**;
- “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet”, **24,62 %**;
- “Veprat penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë”, **3,66 %**;
- “Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve”, **6,80 %**;
- “Veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës”, **28,03 %**;
- “Veprat penale kundër mjedisit”, **7,69 %**;
- “Veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale”, **24,39 %**;
- “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik⁵³”, **14,62 %**;
- “Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë”, **21,32 %**;
- “Veprat penale të trafikeve të paligjshme”, **3,87 %**;
- “Veprat penale kundër prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve”, **2,96 %**.

Ndërkohë, numri i procedimeve të regjistruara për “Veprat penale kundër krimit kompjuterik” është i njëjtë në të dy vitet.

⁵² Veçuar trafiku i personave të rritur


⁵³ Veçuar korrupsioni

2.11 TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK

Nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak ka qenë si më poshtë:


Në vitin 2015 janë përfunduar hetimet për 20148 të pandehur nga të cilët 16906 janë dërguar në gjykatë ose 84 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3242 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 16 % të të pandehurve. Në vitin 2016 janë përfunduar hetimet për 17803 të pandehur nga të cilët 14746 janë dërguar në gjykatë ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3057 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve. Në vitin 2017 janë përfunduar hetimet për 16176 të pandehur nga të cilët 12808 janë dërguar në gjykatë ose 79 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3368 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 21 % të të pandehurve. Në vitin 2018 janë përfunduar hetimet për 16247 të pandehur nga të cilët 13403 janë dërguar në gjykatë ose 82 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2844 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 18 % të të pandehurve. Në vitin 2019 janë përfunduar hetimet për 14423 të pandehur nga të cilët 12158 janë dërguar në gjykatë ose 84 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2232 të pandehur janë pushuar hetimet ose për rreth 16 % të të pandehurve.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2019:




Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në dënimin e të pandehurve

Grafiku i mëposhtëm përmban të dhëna të detajuara lidhur me numrin e të pandehurve dënuar dhe ata që kanë marrë pafajësi në pesë vitet e fundit:




Të dhëna mbi kërkesën e prokurorit dhe vendimet e gjykatës

Më poshtë paraqiten në përqindje të dhënat lidhur me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykatës gjatë vitit 2019, lidhur me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë:




Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **dënimin “Burgim i përjetshëm”** për periudhën 2015-2019:



Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2018 në masën 58,33 %, në vitin 2018 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2017 në masën 7,69 %, në vitin 2017 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2016 në masën 45,8 %, në vitin 2016 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2015 në masën 26,3 %, në vitin 2015 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2014 në masën 18,75 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2018 në masën 60 %, në vitin 2018 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2017 në masën 9 %, në vitin 2017 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2016 në masën 21,4 %, në vitin 2016 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2015 në masën 55,55 %, në vitin 2015 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë në të njëjtin nivel me një vit më parë.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **dënimin e të pandehurve me burgim sa maksimumi** i parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete për vitet 2015-2019:



Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2019 ka një ulje prej 57,52 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2018, vihet re se në vitin 2018 ka një ulje prej 6,13 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2017, në vitin 2017 ka një ulje prej 48,6 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2016, në vitin 2016 ka një rritje prej 11,6 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2015 ka një ulje prej 19,77 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit.

Lidhur me vendimet e dënimit në maksimumin e masës së dënimit të parashikuar për veprën penale konkrete, gjatë vitit 2019 vërehet ulje prej 52,08 % krahasuar me vitin 2018, gjatë vitit 2018 vërehet ulje prej 9,43 % krahasuar me vitin 2017, gjatë vitit 2017 vërehet e njëjta shifër me vitin 2016, gjatë vitit 2016 vërehet ulje në masën 22,6 % në krahasim me vitin 2015, gjatë vitit 2015 vërehet ulje në masën 32,8 % në krahasim me vitin 2014.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e **dënimit me burgim në minimumin** e parashikuar nga ligji:



Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum, vihet re se në vitin 2019 kërkesat e prokurorit janë ulur me 4,60 % krahasuar me vitin 2018, në vitin 2018 kërkesat e prokurorit janë ulur me 27,64 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 kërkesat e prokurorit janë ulur me 15 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2016 kërkesat e prokurorit janë ulur me 27,7 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2015 kërkesat e prokurorit janë rritur me 70,52 % krahasuar me vitin 2014.

Vihtet re se në vitin 2019 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 15,14 % krahasuar me vitin 2018, në vitin 2018 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 18,93 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 16,7 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2016 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 10,2 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2015 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë rritur me 22,23 % krahasuar me vitin 2014.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar **“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”** si kërkime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:



Nga të dhënat statistikore, vihet re se në vitin 2019 ka një ulje prej 4,51 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në vitin 2018 ka një rritje prej 16,28 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg, në vitin 2017 ka një rritje prej 13 %, në vitin 2016 ka një ulje prej 1 %, ndërkohë që në vitin 2015 ka një rritje prej 11,63 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në krahasim me vitin 2014.

Ndërkohë që edhe vendimet e gjykatës kanë pësuar një ulje prej 6,63 % në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2015-2019:



Të dhënat statistikore tregojnë ulje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë në vitin 2019 prej 11,97 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton rritje prej 12,98 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton ulje prej 48,4 % në krahasim me vitin 2016, po kështu vërehet ulje e kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë edhe në vitin 2016 prej 15,78 % në krahasim me vitin 2015, ndërkohë që vërehet rritje e kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë në vitin 2015 prej 30,68 % krahasuar me vitin 2014.


Sa i përket të dhënave lidhur me vendimet e dënimit me gjobë, vihet re se në vitin 2019 ka një ulje prej 11,92 % në krahasim me vitin 2018, vihet re se në vitin 2018 ka një rritje prej 13,03 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 ka një ulje prej 43 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2016 ka një ulje prej 18,2 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2015 ka një rritje prej 31,77 % në krahasim me vitin 2014.

2.12 TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2019

Të dhëna lidhur me të pandehurit regjistruar, dërguar gjyqit dhe dënimet për **veprat penale ushtarake** gjatë vitit 2019, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Vepra penale ushtarake	Të pandehur regjistruar	Të pandehur dërguar gjyqit	Të pandehur të dënuar	Të pandehur të pafajshëm
Totali	48	31	29	0

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit në hetim⁵⁴ (sipas Kodit Penal civil) në pesë vitet e fundit (2015 – 2019):



Në lidhje me të pandehurit e regjistruar në vitin 2019, nga të dhënat statistikore rezulton se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:

Në vitin 2015 janë regjistruar 18076 të pandehur që do të thotë ulje prej 2,7 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë regjistruar 18264 të pandehur që do të thotë rritje prej 1 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 janë regjistruar 17022 të pandehur që do të thotë ulje prej 6,8 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 janë regjistruar 15793 të pandehur që do të thotë ulje prej 7,22 % në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 janë regjistruar 15561 të pandehur që do të thotë ulje prej 1,47 % në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me të pandehurit mbartur në hetim, duke marrë në referencë vitet 2015-2019 rezulton se:

Në vitin 2015 janë mbartur 6549 të pandehur që do të thotë rritje prej 73,7 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë mbartur 5548 të pandehur që do të thotë ulje prej 15,3 % në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 janë mbartur 5226 të pandehur që do të thotë ulje

⁵⁴ Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur çështjet e të cilëve janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë.


prej 5,8 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 janë mbartur 6281 të pandehur që do të thotë rritje prej 20,19 % në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 janë mbartur 6947 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,60 % në krahasim me vitin 2018.

Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezultojnë se:

Në vitin 2015 janë rifilluar hetimet për 162 të pandehur që do të thotë rritje prej 8,7 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2016 janë rifilluar hetimet për 161 të pandehur, shifër që është pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2015 gjatë të cilit janë rifilluar hetimet për 162 të pandehur, në vitin 2017 janë rifilluar hetimet për 105 të pandehur që do të thotë ulje prej 34,8 % në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 janë rifilluar hetimet për 116 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,48 % në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 janë rifilluar hetimet për 123 të pandehur që do të thotë rritje prej 6,03 % në krahasim me vitin 2018.


Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2017-2019:



Nga të dhënat statistikore rezultojnë se raporti i të pandehurve meshkuj-femra në vitin 2017 është 93,49 % meshkuj dhe 6,51 % femra, në vitin 2018 raporti i të pandehurve sipas gjinisë është 94,09 % meshkuj dhe 5,91 % femra dhe në vitin 2019 raporti i të pandehurve sipas gjinisë është 94,25 % meshkuj dhe 5,75 % femra.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2017-2019:




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2017 rezultojnë 52,10 % e të pandehurve me arsim deri 9 vjeçar që përbën rritje në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezultojnë 47,34 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën ulje në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 të pandehurit me arsim deri 9 vjeçar zënë 47,15 % të të pandehurve, që tregon ulje në krahasim me vitin 2018.

Me arsim të mesëm në vitin 2017 rezultojnë 40,09 % e të pandehurve, që përbën ulje krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 rezultojnë 43,98 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën rritje krahasuar me vitin 2017 dhe në vitin 2019 rezultojnë 43,30 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor, që tregon ulje në krahasim me vitin 2018.

Me arsim të lartë, në vitin 2017 rezultojnë 7,81% e të pandehurve që tregon rritje në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezultojnë 8,68 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që tregon rritje në krahasim me vitin 2017 dhe në vitin 2019 rezultojnë 9,55 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor, që tregon rritje në krahasim me vitin 2018.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitet 2017-2019:




Për sa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2017 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 6,06 % e të pandehurve, në vitin 2018 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 5,65 % e të pandehurve dhe në vitin 2019 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 4,62 % e të pandehurve.

Të pandehurit e punësuar në sektorin privat në vitin 2017 përbëjnë 30,92 % të numrit të të pandehurve, në vitin 2018 të pandehurit e punësuar në sektorin privat përbëjnë 29,49 % të numrit të të pandehurve dhe në vitin 2019 përbëjnë 27,99 % të numrit të të pandehurve.

Në vitin 2017 rezultojnë 63,02 % e të pandehurve si të papunë, në vitin 2018 rezultojnë 64,87 % e të pandehurve si të papunë dhe në vitin 2019 rezultojnë 67,38 % e të pandehurve si të papunë.


Pra ajo që vërehet nga të dhënat statistikore është se gjatë tre viteve të fundit më shumë se 63 % e të pandehurve janë të papunë dhe ky është një nga faktorët kryesor kriminogjenë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve për vitet 2017- 2019:



Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat, edhe për vitin 2019 ku tendencat tregojnë se 60,21 % e të pandehurve rezultojnë me vendbanim në qytet dhe 39,79 % rezultojnë me banim në fshat.

Grafiku në vijim paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitet 2017-2019:



Për sa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2019 rezulton se 1,78 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën veprë penale që do të thotë se ky tregues është ulur krahasuar me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton se 2,77 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën veprë penale që do të thotë se ky tregues është rritur krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton se 2,26 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën veprë penale.

Përsëritës për vepra penale të ndryshme në vitin 2019 rezulton se janë 6,03 % e të pandehurve, që do të thotë rritje krahasuar me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton se janë 5,00 % e të pandehurve, që do të thotë ulje krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton se janë 5,66 % e të pandehurve përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo për të cilën janë proceduar.


Të pandehurit e padënuar më parë në vitin 2019 përbëjnë 92,19 % të të pandehurve, në vitin 2018 përbëjnë 92,23 % të të pandehurve dhe në vitin 2017 përbëjnë 92,08 % të të pandehurve.

Shtetësia e të pandehurve


Për sa i përket shtetësisë së të pandehurve, gjatë vitit 2019 rezulton se 98,82 % e tyre janë me shtetësi shqiptare dhe 1,18 % me shtetësi të huaj.

Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, në vitin 2017 janë regjistruar 164 të pandehur të huaj që përbëjnë 0,96 % të numrit total të të pandehurve të regjistruar, në vitin 2018 janë regjistruar 241 të pandehur të huaj që përbëjnë 1,53 % të numrit total të të pandehurve të regjistruar dhe në vitin 2019 janë regjistruar 184 të pandehur të huaj që përbëjnë 1,18 % të numrit total të të pandehurve të regjistruar.

Ky tregues rezulton në ulje 23,65 % krahasuar me numrin e të pandehurve të huaj të regjistruar në vitin 2018.



Të pandehurit me shtetësi të huaj lidhen me procedime për veprat penale si vijon: falsifikime 28 % e të pandehurve, vjedhje e mashtrime 16 % e të pandehurve të huaj, kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror dhe ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve 12 % e të pandehurve, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt dhe shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor 10 % e të pandehurve dhe po 10 % zënë edhe krimet në fushën e tatimeve e doganave, krime lidhur me narkotikët 7 % e të pandehurve dhe grupi i strukturuar kriminal 4 % e të pandehurve. Pjesa tjetër e pandehurve me shtetësi të huaj, lidhen me vepra penale të tjera të cilat të veçuara kanë peshë specifike më të vogël se 2 % brenda totalit.




Të miturit 2019


Gjatë vitit 2019, bazuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë regjistruar 397 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin.

Nga të dhënat rezulton se janë regjistruar 388 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale. Ndaj tyre janë vendosur 41 masa sigurimi, ose për rreth 10,6 % të të miturve, ku masa me arrest për 6 % të të pandehurve të mitur.

Masat e sigurimit të vendosura ndaj të miturve paraqiten në grafikun më poshtë:



Lidhur me vendimarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin, të dhënat tregojnë se është vendosur mosfillimi për 146 referime/kallzime penale, janë pushuar 189 çështje dhe janë dërguar për gjykim 141 çështje.




Shkaqet e vendimarrjes në rastet e pushimit të çështjes, tregojnë se në 80,4 % të çështjeve janë vendosur masa alternative të shmangies dhe pjesa tjetër është pushuar për shkaqe të tjera proceduriale.


Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat rezulton se është aplikuar shmangia në 167 raste, ndër të cilat në 4 raste është vendosur ndërmjetësimi, në 3

raste këshillim për të miturin dhe familjen, në 6 raste është vendosur paralajmërim me gojë, në 142 raste është vendosur paralajmërim me shkrim, në 9 raste janë vendosur masa detyruese dhe në 3 raste i mituri është vendosur nën kujdes.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me aplikimin e masave të shmangies:



Kriminaliteti te të miturit sipas grupveprave penale paraqitet si vijon:



Siç vihet re nga grafiku “Drejtimet të automjeteve në mënyrë të parregullt” përbën veprën penale të kryer më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç, duke zënë 33 % të procedimeve me të pandehur të mitur.

Vjedhja e pasurisë mbetet problematike edhe në vitin 2019, pasi për të janë regjistruar 26 % e procedimeve.

Veprat penale kundër personit, rezulton se përbëjnë 22 % të procedimeve, veprat penale lidhur me narkotikët përbëjnë 3 % dhe për veprat penale lidhur me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve janë regjistruar 2 % e procedimeve me të pandehur të mitur.

Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.

Sa i përket viktimave të mitura, të dhënat tregojnë se janë regjistruar 218 çështje me 241 viktima të mitura.

III. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme është një strukturë e specializuar në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar tashmë në çështjet penale të juridiksionit të përgjithshëm, në përmbushje të kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm, e konkretisht asaj të parashikuar në nenin 38, pika 2, gërma “ë” të Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se, Prokurori i Përgjithshëm përfaqëson Prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët dhe ndihmën e ndërsjelltë në çështje penale të juridiksionit të përgjithshëm.

Kjo Drejtori funksionon si një njësi ndihmëse dhe koordinuese për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet Prokurorive me Juridiksion të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe autoriteteve ligjzbatuese të huaja.

Gjatë vitit 2019, përveç detyrave të kryera në përputhje me strategjinë afatmesme 2018-2020 të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, e cila ndër të tjera ka parashikuar si objektiv forcimin e bashkëpunimit me autoritetet homologe, jo vetëm nëpërmjet përgjigjes së saj në kohë e me efikasitet lidhur me trajtimin e letërkërkesave të autoriteteve të huaja, por edhe nëpërmjet rritjes së komunikimeve të drejtpërdrejta, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë ka pasur në fokus të veçantë edhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në Eurojust.

Më konkretisht, në datë 05.10.2018 Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me EUROJUST, e cila u ratifikua me Ligjin nr. 113/2018. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it në luftën kundër krimeve të rënda, veçanërisht kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Marrëveshja në fjalë parashikon në nenin 4 se, autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e saj është Prokuroria e Përgjithshme.

Duke qenë se për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje ishte e nevojshme përmbushja e disa kërkesave ligjore që lidhen specifikisht me *respektimin e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale*, nga ana e Prokurorisë u ndërmorën një sërë masash me qëllim përmbushjen e këtyre kërkesave, e konkretisht:

U ngrit një grup i përbashkët pune me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, një përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përfaqësues të Projektit IPA 2017 “*Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor*”.

Prokurori i Përgjithshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (këtej e tutje referuar si Komisioneri), nënshkruan më 25.02.2019 një Planveprim në kuadër të Nënshkrimit dhe Zbatimit të Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust.

Sa i përket Planit të Veprimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionerit të nënshkruar më 25.02.2019 janë përmbushur të gjitha parashikimet në këtë Planveprim, konkretisht:

Prokuroria e Përgjithshme më datë 05.03.2019 i ka komunikuar Komisionerit caktimin e Oficerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Prokurorinë e Përgjithshme dhe ndërkohë më 27.05.2019 i është kërkuar zyrtarisht gjithë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe gjithë Prokurorive të Apeleve caktimi i Oficerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në datë 16.07.2019, Komisionerit i është komunikuar lista e të gjithë Oficerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të caktuar në të gjitha Prokuroritë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Komisioneri në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, në muajt Maj – Qershor 2019, zhvilluan disa takime vlerësuese dhe konsultuese në Prokurorinë e Përgjithshme, sa i përket organizimit të proceseve përpunuese në përputhje me legjislacion e mbrojtjes së të dhënave personale dhe detyrimet e Marrëveshjes me EUROJUST. Gjithashtu, këto takime u zhvilluan edhe në disa nga Prokuroritë e Rretheve gjyqësore, konkretisht, Prokurorinë e Tiranës, Prokurorinë e Durrësit, Elbasanit, Vlorës, Shkodrës, Korçës dhe Gjirokastrës.

Në vijim, në datë 07.06.2019 Komisioneri ka transmetuar Raportin Monitorues për Kontrolluesin “Prokuroria e Përgjithshme”, duke dhënë rekomandimet përkatëse.

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur grupi i punës me Urdhrin nr. 103, datë 13.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Më 27.06.2019 me ftesë të Prokurores hollandeze të Projektit IPA 2017 “Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor” zhvilloi një vizitë në Shqipëri një Zyrtar i Lartë Ligjor në Eurojust. Qëllimi i vizitës ishte që të diskutohej lidhur me hapat e mëtejshëm me qëllim përmbushjen e kushteve për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Me urdhrin nr. 140, datë 03.09.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm u miratua Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shkëmbimin e Informacionit me Eurojust (e cila u hartua në bashkëpunim të ngushtë me Komisionerin dhe përfaqësuesin e Eurojust për mbrojtjen e të dhënave personale). Kjo Rregullore është publikuar në faqen zyrtare të Eëb-it të Prokurorisë së Përgjithshme si dhe një kopje iu shpërnda për njohje dhe zbatim të gjithë punonjësve në çdo Prokurori.

Prokuroria e Përgjithshme draftoi një Politikë Privacie (Njoftim mbi Ruajtjen e Privatësisë) dhe pasi mori mendimin e Komisionerit Për Mbrojtjen e të dhënave Personale e publikoi në Faqen e Ëeb-it të Prokurorisë së Përgjithshme. Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë i tregon përdoruesve të faqes së ËEB-it se çfarë duhet të presin kur Prokuroria e Përgjithshme mbledh të dhënat personale, si pasojë e ndërveprimit të përdoruesve me këtë faqe ëeb-i.

Më 28.06.2019 Komisioneri ka përcjellë Raportin Monitorues për Kontrolluesit “Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore” me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, i cili u dërgua tek të gjitha Prokuroritë në RSH.

Të gjitha Prokurorive në shkallë vendi iu dërgua një qarkore me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, duke vendosur stenda informuese në ambientet e brendshme ose të jashtme, apo duke vendosur parashikime specifike për të dhënat personale në kontratat e punës.

Në datë 22 Korrik 2019, në ambjentet e Prokurorisë së Përgjithshme, u zhvillua një trajnim në kuadër të kërkesave për mbrojtjen e të dhënave personale që burojnë nga Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST e nënshkruar më 23.10.2018 dhe ratifikuar me Ligjin Nr. 113/2018. Në këtë trajnim morën pjesë të gjitha Pikat e Kontaktit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në të gjitha Prokuroritë e të gjitha niveleve.

Jemi të vetëdijshëm se procesi i garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale është një proces i vazhdueshëm dhe Komisioneri dhe Prokuroria e Përgjithshme do ta vijojnë bashkëpunimin në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje efektive e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Raste konkrete bashkëpunimi me Eurojust pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Që pas nënshkrimit të Marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Eurojust bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Eurojust është rritur ndjeshëm gjatë vitit 2019. Që nga muaji Janar 2019 Pika e Kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme ka marrë të paktën 23 kërkesa për ndihmë juridike nga Vendet Anëtare si Italia, Greqia, Republika Çeke, Zvicra, Hungaria, Mali i Zi.

Anëtarët e sipërpërmendur kombëtarë kanë paraqitur kërkesa me objekt dërgimin e informacionit të mëposhtëm:

- Nëse UAE-të (Urdhrat e Arrestit Evropian) mund të konsiderohen si kërkesë për ekstradimin e shtetasve në kërkim dhe nëse mund të shihen mundësi të mëtejshme për ekzekutimin e këtyre Urdhrave në Shqipëri;

- Informacion mbi fazën e ekzekutimit të disa kërkesave për ndihmë juridike të dërguara nga shtete të caktuara;
- Si të lehtësohet dhe përmirësohet ekzekutimi i UAE-ve, që janë qarkulluar nëpërmjet kanaleve policore (INTERPOL, SIRENE);
- Verifikimi i të dhënave personale të një të dyshuari, duke dërguar ndërkohë të dhënat që dispononte autoriteti i huaj, si: emri, emri i nënës, ID ose numri i pasaportës, adresa e përkohshme ose e përhershme;
- Dorëzimi i përkohshëm i mundshëm në një shtet të tjetër;
- Në një rast korrupsioni dhe pastrami parash autoritetet kanë kërkuar organizimin e një takimi koordinues në Hagë, ndërmjet prokurorëve Shqiptarë dhe Hollandezë, për të shkëmbyer informacion mbi hetimet në secilin vend dhe për të diskutuar mbi mundësitë e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar;
- Si dhe është bashkëpunuar në mënyrë të ngushtë (duke negociuar dhe tekstin) në kuadër të ngritjes së Skuadrave të Përbashkëta Hetimore (specifikisht me Italinë), konkretisht ndërmjet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe Prokurorive të Torinos, Firences, Bergamos dhe Barit, për vepra penale të kryera nga organizata kriminale (janë kryer një sërë veprimesh hetimore nga të dyja palët, si arrestime personash, kontrolle banesash, vendosje pajisjesh GPS nëpër makina, remotizim i përgjimeve, marrje në pyetje, etj.

Më poshtë paraqesim treguesit sasiorë dhe cilësorë në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale për vitin 2019, sipas fushave respektive.

3.1 Ekstradime

i. Ekstradime nga jashtë

Gjatë vitit 2019 janë trajtuar gjithsej 171 praktika ekstradimi, për shtetas shqiptarë apo të huaj të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Prokuroria shqiptare mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të dhënë nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë. Këta shtetas janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të huaja, duke iniciuar kështu procedurën e ekstradimit për në Shqipëri.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2019, në raport me vitin e kaluar vërehet rritje e lehtë e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e subjekteve nga jashtë, e konkretisht në masën 5,2 %.

Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2016-2019:

	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Nr. kërkesave për ekstradim	132	194	171	180




Referuar të dhënave statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2019, numri më i madh i i personave të arrestuar jashtë vendit me qëllim ekstradimi në Shqipëri vijon të jetë me shtete si, 41 në Itali, 39 në Greqi, 11 në Gjermani, 13 në Angli, 11 në Francë, 4 në SHBA dhe Hungari, 7 në Spanjë, 6 në Kosovë etj. Ndërsa në shtete të tjera rezultojnë të jenë arrestuar përkatësisht 3 persona në Maqedoninë e Veriut, 2 në Austri, Slloveni etj., si dhe 1 në Paraguaj, Uruguaj, Finlandë, Kanada etj.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për këtë tregues (*ekstradime nga jashtë*), si dhe grafiku përkatës sipas shteteve të cilëve i janë drejtuar kërkesat për ekstradim:

Shteti	Viti 2018	Viti 2019
Kosovë	3	6
Zvicër	5	4
Spanjë	6	7
Hungari	6	4
SH.B.A	6	4

Francë	11	11
Angli	14	13
Gjermani	19	11
Greqi	26	39
Itali	47	41

Ekstradime nga Jashtë



ii. Ekstradime për jashtë


Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2019 janë arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimin drejt shteteve të tjera 157 shtetas

(shqiptarë apo të huaj), një tregues ky i cili i krahasuar me një vit më parë rezulton me rritje në masën 22,6%.

Ekstradime për jashtë		
Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
145	128	157

Vlen të theksohet se, ashtu sikurse edhe vitet e kaluara për disa subjekte të arrestuar me qëllim ekstradimi në Itali, autoritetet italiane kanë paraqitur në 34 raste, kërkesë për njohjen e vendimeve penale duke konvertuar kështu, procedurën e ekstradimit me atë të njohjes me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të dhënë nga këto autoritete në ngarkim të shtetasve shqiptarë.

Sikurse paraqitet në grafikun e mëposhtëm përsa i takon volumit të ekstradimeve për jashtë gjatë periudhës 2017-2018, rezulton se viti 2017 zë 53 % të volumit në raport me periudhën 2-vjeçare, ndërsa viti 2018 përbën 47 %.



Gjatë vitit 2019 numri më i lartë i kërkesave të ekstradimit për shtetasit shqiptarë ose të huaj, të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur nga Italia me 70 kërkesa (pasi sikurse u cituar më lart 34 kërkesa janë paraqitur për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale italiane), Kosova 7 kërkesa, Gjermania 8 kërkesa, Zvicra 3 kërkesa, Franca 4, Mali i Zi dhe Serbia me nga 2 kërkesa, ndërsa shtete si Austria, Maqedonia e Veriut etj. kanë paraqitur nga 1 kërkesë.

Sa më sipër, paraqitet grafikisht:

Shteti	Viti 2018	Viti 2019
Maqedonia e Veriut	1	1
Serbi	2	2
Austri	4	1
Kroaci	4	0
Mali i Zi	4	2
Indi	0	3
Francë	1	4
Gjermani	6	8
Zvicër	6	3
Kosovë	8	7
Itali	71	104

Theksojmë se, në kuadër të trajtimit të kërkesave të ardhura nga autoritetet e huaja (për ekstradimin e shtetasve nga Shqipëria drejt shteteve kërkuuese apo për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë), Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë gjatë vitit 2019 i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë në **43 raste**, zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së këtyre shtetasve, në mbështetje të nenit 35/4 dispozitë kalimtare e Ligjit 70/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

3.2 Letërporositë

i. Letërporositë nga jashtë

Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale të ardhura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2019 janë transmetuar gjithsej 625 letërporosi, tregues i cili rezulton me


ulje në masën 6,4% krahasuar me vitin 2018, vit në të cilin janë transmetuar 668 letërporosi.



Duke iu referuar të dhënave statistikore konstatohet se, ashtu si vitet e kaluara numri më i lartë i kërkesave për ndihmë juridike ka ardhur nga shtetet kufitare si, Kosova me 108 letërporosi, Greqia me 105 letërporosi, Portugalia 82, Gjermania 43, Italia 42, Maqedonia e Veriut 37, Turqia 26, Mali i Zi dhe Holanda kanë dërguar 22 letërporosi, Kroacia dhe Hungaria përkatësisht nga 20 letërporosi, Sllovenia e Belgjika nga 13 letërporosi, Franca 8, Bullgaria 5 letërporosi etj.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Letërporosi nga Jashtë



Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar në Shqipëri kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:


- **30 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **trafikeve të paligjshme**, ndër janë dërguar nga shtete si Belgjikë, Kosovë, Itali, Republika Çeke, Hollandë, Norvegji, Spanjë, Turqi etj;
- **77 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **falsifikimit të dokumenteve**, ndër të cilat janë dërguar nga shtete si Portugalia, Hollandë, Kroaci, Mali i Zi, Greqi, Maqedoni, Hungari etj;

- **19 letërporosi** për vepra penale të kryera nga **organizata kriminale**, ndër të cilat janë dërguar nga shtete Belgjikë, Francë, Itali, Gjermani, Hollandë, mali i Zi, Spanjë etj;
- **37 letërporosi** për veprën penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**, nga shtete si Hollanda, Mbretëria e Belgjikës, Italia, Indi, Luksemburg, Mali i Zi, Hollanda, Norvegjia, Polonia etj;
- **16 letërporosi** për veprën penale të **mashtrimit**, nga shtete si Gjermania, Italia, Luksemburgu, Hollanda, Polonia etj.;
- **1 letërporosi** për veprat penale të **terrorizmit** e dërguar nga Turqia;
- **1 letërporosi** për veprat penale të **krimin kibernetik** e dërguar nga Gjermania;
- **1 letërporosi** për veprën penale të **dhunës në familje** e dërguar nga Italia.

ii. Letërporositë për jashtë


Gjatë vitit 2019, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore i kanë drejtuar autoriteteve të huaja gjyqësore gjithsej 639 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të ushtrimit në vendin tonë të ndjekjes penale ndaj shtetasve shqiparë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar ulje me 18% krahasuar me vitin 2018, ku janë dërguar rreth 782 letërporosi.

Letërporosi për jashtë	
Viti 2018	Viti 2019
782	639



Sa i takon shpërndarjes gjeografike sipas Prokurorive pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore rezulton se, Prokuroria Tiranë për periudhën raportuese ka dërguar jashtë vendit 132 letërporosi, Prokuroria Durrës 69 letërporosi, Ish Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda 67, Fieri dhe Korça përkatësisht 57 letërporosi, Elbasani 42, Berati 24, Shkodra e Lushnja nga 19, Saranda 18 letërporosi etj.

Letërporosi për jashtë Viti 2016



iii. *Letërkërkesat sipas veprave penale të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda*

Gjatë vitit 2019, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë dërguar pranë autoriteteve të huaja kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:

- **164 letërporosi për autoritetet e huaja (ose 25,6 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **trafiqeve të paligjshme**, përfshirë këtu trafikimin e personave të rritur, të të miturve, trafikimin e narkotikëve dhe trafikimin e mjeteve motorike;
- **168 letërporosi (ose 26,2 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprës penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**;
- **51 letërporosi (ose 7,9 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **krimit kibernetik**, të cilat i janë drejtuar shteteve si, SHBA, Britani e Madhe, Nigeri, Gjermani, Suedi etj;


- **109 letërporosi (ose 17 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **falsifikimit të dokumenteve**;
- **70 letërporosi (ose 10,9 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **mashtimit**;
- **24 letërporosi (ose 4 % e totalit të letërporosive)** në kuadër të procedimeve për kryerjen e **krimeve kundër jetës të kryera me dashje**;
- **2 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **dhunës në familje**;
- **4 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **korrusionit** aktiv apo pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, apo korrupsionit të personave që ushtrojnë funksione publike;
- **19 letërporosi** drejtuar autoriteteve të huaja të drejtësisë në kuadër të veprës penale të **grupit të strukturuar kriminal dhe organizatave kriminale**;

3.3 Njohjet e vendimeve penale

i. Njohjet e vendimeve penale të huaja

Referuar të dhënave statistikore rezulton se, për vitin 2019 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej 44 kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, tregues ky i cili rezulton me ulje në masën 8 % krahasuar me vitin 2018, në të cilin është kërkuar njohja e vendimeve penale në 48 raste.


Njohje Vendimesh Penale të Huaja



Sikurse vërehet në tabelën e mëposhtme por edhe në të dhënat e tjera statistikore rezulton se, Italia dhe Greqia kanë vijuar të zënë pjesën më të madhe të kërkesave për njohje vendimi penal, ndërsa shtete si Belgjika, Hungaria, Republika Çeke kanë paraqitur sejcila nga një kërkesë për njohjen me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të dhënë prej tyre në ngarkim të shtetasve shqiptarë.

Njohje vendimesh penale të huaja

	Viti 2018	Viti 2019
Belgjikë	3	1
Itali	29	37
Greqi	5	4



ii. Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2019 autoritetet shqiptare kanë paraqitur gjithsej 20 kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit, tregues me rritje krahasuar me vitin 2018, në të cilin u paraqitën 11 kërkesa.




Në tabelën e mëposhtme, shihet qartë se numri më i lartë i kërkesave i është dërguar autoriteteve kosovare me 7 të tilla, duke vijuar më pas me nga 1 kërkesë drejtuar Greqisë, Turqisë, 5 Maqedonisë, 2 Bullgarisë dhe 1 Spanjës.

Njohje vendimesh penale shqiptare jashte vendit		
	Viti 2018	Viti 2019
Kosovë	7	7
Greqi	1	1
Turqi	1	1
Maqedoni	1	5
Bullgari	0	2
Spanjë	0	1
Totali	11	20

3.4 Transferimet e procedimeve penale

i. Transferimet e procedimeve penale

Gjatë vitit 2019 është kërkuar në 27 raste transferimi i procedimeve penale nga jashtë me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, duke konstatuar rritje të këtij treguesi krahasuar me vitin 2018, në të cilin është kërkuar transferimi në 20 raste, ndërsa për periudhën raportuese janë transferuar nga Shqipëria gjithsej 18 procedime penale.



Më konkretisht, autoritetet e huaja gjyqësore kanë paraqitur kërkesa për transferimin në Shqipëri të procedimeve penale të cilët në terma sasiorë paraqiten përkatësisht, Bosnjë-Herzegovina 1, Republika Çeke dhe Franca përkatësisht nga 2, Kosova 8 dhe Mali i Zi gjithsej 14 kërkesa.


Ndërsa, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore shqiptare kanë vendosur transferimin e 8 procedimeve penale drejt Kosovës, 4 drejt Italisë, 1 Malit të Zi, 1 Maqedonisë së Veriut, 1 Mbretërisë së Bashkuar.

3.5 Transferimet e personave të dënuar

i. Transferimet nga jashtë vendit të personave të dënuar

Gjatë vitit 2019 janë paraqitur 34 kërkesa për transferimin e subjekteve të dënuar nga jashtë, e më konkretisht nga Anglia 5 kërkesa dhe Italia 29 kërkesa.

Viti	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Transferimi i të dënuarve nga jashtë	33	9	4	34



ii. *Transferimet për jashtë vendit të personave të dënuar në Shqipëri*

Në vitin 2019 janë paraqitur 8 kërkesa për transferimin jashtë vendit të subjekteve të dënuar nga autoritetet shqiptare, duke konstatuar ulje krahasuar me vitin 2018, në të cilin është kërkuar transferimi nga 10 të dënuar.




3.6 Urdhrat e arrestit ndërkombëtar

Referuar të dhënave statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2019 Prokuroria Shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 235 shtetas (shqiptarë apo të huaj) të cilët janë

dënuar me vendim të formës së prerë ose ndaj tyre me vendim Gjykate është caktuar një masë sigurimi personal “*Arrest në burg*”. Ky tregues ka pësuar ulje në masën 8,2 % krahasuar me vitin 2018, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 256 persona.

Gjithashtu, Prokuroria ka kërkuar që Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 172 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar, kjo për shkaqe të ndryshme si, arrestimi i tyre në territorin shqiptar apo shuarja e dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit të dhënë me vendim të formës së prerë.



Urdhrat e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë

Vlerësojmë të theksojmë se, përveç volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2019 ka trajtuar në kohë reale rreth **651 kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja. Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana ka njoftuar në **234 raste** shpalljen e shtetasve shqiptarë në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e huaja, me të cilët Republika e Shqipërisë nuk ka marrëveshje ekstradimi (*për ekstradimin e shtetasve shqiptarë*). Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme për çdo rast i ka kërkuar ZQK Interpol Tiranës kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për identifikimin dhe lokalizimin në territorin shqiptar të këtyre subjekteve, në mënyrë që më pas të njoftohen autoritetet e huaja për të vlerësuar paraqitjen e kërkesës për transferimin e procedimeve penale apo njohjen e vendimeve penale të huaja në Shqipëri. Nga të dhënat statistikore

rezulton se për periudhën raportuese, Greqia ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 52 shtetas shqiptarë, Belgjika 49, Gjermania 47, Franca 41, Holanda 8, Zvicra 19 etj.

Skadrat e përbashkëta hetimore

Gjatë vitit 2019 është nënshkruar 1 Marrëveshje e re për ngritjen e Skadrës së Përbashkët Hetimore ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, në kuadër të çështjes penale të regjistruar për veprën penale të “*Organizatës kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike*”.

Objekti i veprimtarisë së skuadrës së përbashkët hetimore, përfshin kryerjen e veprimeve hetimore në territoret e dy Shteteve Palë të Marrëveshjes, ndër të cilat,

- Identifikimi i aktiviteteve dhe strukturave të organizatave kriminale;
- Identifikimi i roleve respektive të anëtarëve të organizatës, furnizuesve të lëndëve narkotike dhe pritësve të tyre;
- Identifikimi i vendeve të kultivimit dhe depozitimit të lëndëve narkotike si dhe mjetet dhe mënyrat e përgatitjes dhe maskimit/fshehjes;
- Verifikimi i mënyrës së transportit dhe gatishmërisë së mjeteve që përdoren për transportin e tyre;
- Verifikimi i ekzistencës së financuesve eventualë të trafikut të lëndëve narkotike si dhe mënyrat e riinvestimit të të ardhurave të mëdha të siguruara, duke treguar dhe emra përkatës.

3.7 Trajnime, vizita të prokurorëve dhe nënpunësve të Prokurorisë jashtë vendit

Gjatë vitit 2019 Institucioni i Prokurorisë ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare si, trajnime, vizita, konferenca, takime operative etj, duke u përfaqësuar me prokurorë, OPGJ dhe ndihmës ligjorë. Ndër këto aktivitete përmendim:

Konferenca/aktivitete me pjesëmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm

- Në datat **16 - 17 Maj 2019, në Tallin, Estoni** u zhvillua Takimi i Rrjetit të Prokurorëve të Përgjithshëm të Bashkimit Europian (NADAL 2019).
- Në datat **24 - 26 Qershor 2019, në Budva, Mal i Zi** u zhvillua Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave të Larta dhe të Prokurorëve të Përgjithshëm me temë “*Terrorizmi Ndërkombëtar dhe Emigracioni i Paligjshëm*”. Ky aktivitet u organizua nga Gjykata Supreme e Malit të Zi në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA në Podgoricë.
- Në datat **16 - 18 Tetor 2019 në Izmir, Turqi**, u zhvillua *Forumi i I-rë i Punës së Prokurorëve të Përgjithshëm të Shteteve Ballkanike*. Ky aktivitet organizohej nga Zyra e

Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Bullgarisë.

- Në datat **25 – 27 Nëntor 2019, në Dresden, Gjermani**, u zhvillua Forumi i 20-të Ndërkombëtar i Prokurorëve në Luftën kundër Krimin të Organizuar Ndërkufitar, aktivitet i cili u organizua nga Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit, (TAIEX) të Komisionit Evropian.

Vizita Studimore

- Në datat **20 – 24 Prill 2019, në Londër, Mbretëri e Bashkuar**, u zhvillua një Vizitë Studimore mbi *Praktikat më të Mira në Kthimin e Aseteve*. Ky aktivitetet u organizua nga Qendra për Këshillimin e të Drejtave Individuale në Evropë (AIRE) dhe Sekretariati i Inisiativave Rajonale Anti-korrupsion (RAI).

- Në datat **1 – 5 Korrik 2019, në Hagë dhe Amsterdam** u zhvillua një vizitë studimore/internship, e organizuar nga Projekti IPA 2017 “*Countering Serious Crime in the Eastern Balkans*”.

- Në datat **15-18 Tetor 2019 në Zagreb, Kroaci** u zhvillua një vizitë studimore e organizuar nga PAMECA V.

- Në datat **10 - 11 Dhjetor 2019 në Paris, Francë** u zhvillua një vizitë studimore në Paris Francë, organizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Interpolit në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorisë Publike të Parisit.

Takime në kuadër të Moneyval/FATF/Integritet Evropian

- Në datat **07 - 08 Shkurt 2019 në Bruksel, Belgjikë**, u zhvillua takimi shpjegues në kuadër të procesit screening për Kapitullin negociues 7 të MSA-së “*Pronësia intelektuale*”. (Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian më datë 26 Qershor 2018 ka miratuar Konkluzionet për Zgjerimin dhe Procesin e Stabilizim Asociimit. Këshilli ka vendosur që t’i përgjigjet pozitivisht përparimit të bërë nga Shqipëria, duke përcaktuar rrugën për hapjen e negociatave të anëtarësimit në muajin Qershor 2019. Po ashtu, Këshilli i ka dhënë mandat të plotë politik Komisionit për të filluar procesin *screening* (analiza e detajuar e përfrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian).

- Në datë **06 Maj 2019, në Gjenevë, Zvicër**, u zhvillua shqyrtimi i Raportit të tretë kombëtar në kuadër të Mekanizmit Universal Periodik (UPR), pranë Këshillit të së Drejtave të Njeriut të OKB-së.

- Në datat **16 - 19 Korrik 2019, në Strasburg, Francë**, u zhvillua seanca e 58-të Plenare e Komitetit Moneyval të Këshillit të Europës.
- Në datë **14 nëntor 2019, në Bruksel, Mbretërinë e Belgjikës** u zhvillua Takimi i 10-të i Komitetit të Stabilizim Asociimit (KSA), në zbatim të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit, rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2019, rekomandimeve të takimit të nëntë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, si dhe rekomandimeve të nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit.
- Në datë **16 Dhjetor 2019** në Paris, Francë u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Institucioneve shqiptare dhe ekipit të vlerësuesve të FATF (*Financial Action Task Force*) lidhur me progresin e deritanishëm të vendit tonë në zbatim të Rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Europës.
- Më datë **24 Prill 2019**, është zhvilluar në Bruksel, takimi i 11-të, i Nënkomitetit të Bashkimit Evropian-Shqipëri, "*Drejtësia, Liria dhe Siguria*".
- Në datën **13 Maj 2019, në Bruksel, Belgjikë**, u zhvillua *Takimi i 18-të i Platformës së Zyrave të Rimëkëmbjes*, i organizuar nga Komisioni Evropian, me qëllim nxitjen në nivel rajonal dhe evropian të zbulimit dhe konfiskimit të produkteve të veprave penale.

Takime/konferenca të ndryshme

- Në datat **23 - 26 Janar 2019, në Sussex, Britani e Madhe** u zhvillua Konferenca me temë "*Trafikimi dhe blerja e paligjshme e armëve, krimi i organizuar dhe terrorizmi, që përbën një kërcënim shumëdimensionësh për paqen, sigurinë dhe zhvillimin*", e organizuar nga Ëilton Park.
- Në datat **24 - 25 Prill 2019, në Strasburg, Francë**, u zhvillua një Konferencë e Nivelit të Lartë mbi "*Përgjigjet ndaj mbipopullimit të burgjeve*".
- Në datat **13 - 15 Maj 2019, në Zagreb, Kroaci**, u zhvillua një seminar rajonal me temë "*Sigurinë Kibernetike në vendet e Ballkanit Perëndimor*", i organizuar nga Atasheu i Sigurisë së Brëndshme pranë Ambasadës Franceze në Kroaci.
- Në datat **16 - 17 Maj 2019 në Strasburg, Francë**, në kuadër të Projektit "*End online child sexual exploitation and abuse @ Europe*" *EndOCSEA@Europe* u zhvillua Konferenca "*Bashkëpunimi ndërsektorial për parandalimin dhe luftimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet*".
- Në datat **21 deri më 23 Maj 2019** në Zagreb, Kroaci, është zhvilluar Trajnimi me temë "*Korrupsioni publik, Pastrimi i parave dhe bllokimi i aseteve*" i cili zhvillohej dhe finançohej nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe OPDAT.

- Në datën **28 Maj 2019** në Sarajevë, Bosnie Hercegovinë, është zhvilluar Takimi i Parë Koordinues Rajonal, mbi gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme, për mbajtjen pa leje të armëve të vogla të zjarrit dhe keqpërdorimin e tyre.
- Në datat **30 Qershor – 4 Korrik 2019, në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë** u zhvillua Shkolla Verore e Antikorrupsionit, që organizohej nga iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI).
- Në datat **8 – 9 Gusht 2019, në Petrovac, Mali i Zi** u zhvillua Takimi Rajonal i Grupit të Punës mbi praktikën më të mira për riatdhesimet për Ballkanin, organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Departamenti Amerikan i Shtetit dhe OPDAT.
- Në datat **1 - 8 Shtator 2019 në Cambridge, Mbretërinë e Bashkuar** u zhvillua Simpoziumi Ndërkombëtar për Krimin Ekomomik, i organizuar në Kolegjin Jesus Cambridge.
- Në datat **17 - 18 Shtator 2019 në Herzeg-Novi, Mali i Zi**, në kuadër të përmirësimit të statistikave u zhvillua trajnimi i organizuar nga UNODC me temë *“Matja dhe vlerësimi i krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor: treguesit mbështetës – bazuar në politikëbërje”*.
- Në datat **22 - 23 Tetor 2019, në Strasburg, Francë**, u zhvillua Takimi i 11-të i Konferencës së Palëve për Konventën e Këshillit të Europës *“Mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimit të terrorizmit”*.
- Në datat **12-13 Nëntor 2019 në Zagreb, Kroaci**, në vijim të trajnimit të organizuar me datat 14-16 maj 2019 nga Projekti i BE IMPEL (Rrjeti Europian për Forcimin dhe Zbatimin e Legjislacionit Mjedisor) në bashkëpunim me Departamentin e Qeverisjes së Mirë pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri zhvilloi *“Konferencën Spider Ëeb”*.
- Në datat **12 - 14 Nëntor 2019 në Shkup, Maqedoninë e Veriut**, u zhvillua Trajnimi Rajonal *“Për financimin e terrorizmit dhe hetimet online”*.
- Në datat **19 – 20 Nëntor 2019, në Opatija, Kroaci**, u zhvillua një seminar rajonal me temë *“Lufta kundër trafikut të drogës në vendet e Europës juglindore në vendet e Ballkanit Perëndimor”*, i organizuar nga Atasheu i Sigurisë së Brendshme pranë Ambasadës Franceze në Kroaci.
- Në datat **16 - 19 Tetor 2019, në Tashkent, Uzbekistan** u zhvillua Takimi i 10-të i Rrjetit të zbatimit të ligjit (LEN) i OECD Rrjeti Antikorrupsion për vendet e Europës Lindore dhe Azisë Qendrore (ACN).

- Në datat **17 - 19 Dhjetor 2019 në Shkup, Maqedoninë e Veriut**, u zhvillua trajnimi rajonal me temë “*Hetimet online për armët e zjarrit*”, i organizuar nga EMPACT Firearms me mbështetjen e Komisionit Europian, SEESAC dhe TAIEX.

Takime koordinuese Eurojust

- Në datën **9 Maj 2019, në Hagë, Mbretëri e Hollandës (Eurojust)**, u zhvillua takimi koordinues në kuadër të Marrëveshjes për ngritjen e skudrës së përbashkët hetimore ndërmjet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Firenze.

- Në datën **23 Maj 2019, në Hagë, Mbretëri e Hollandës (Eurojust)**, u zhvillua takimi koordinues në kuadër të Marrëveshjes për ngritjen e skudrës së përbashkët hetimore ndërmjet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (per procedimin penal nr. 157 të vitit 2018 të kësaj Prokurorie, për veprën penale të “*Organizatës kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike*”) dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Torinos.

- Në datën **11 Shtator 2019, në Eurojust, Hagë, Mbretëri e Hollandës**, u zhvillua takimi koordinues në kuadër të çështjes nr. 52963 regjistruar nga autoritetet hollandeze, për të cilën ishte e nevojshme që të shkëmbehjt informacion me autoritetet e prokurorisë shqiptare, të cilat kanë të regjistruar një procedim penal për veprën penale të “*Pastrimit të parave*”.

- Në datën **20 Nëntor 2019, në Hagë, Mbretëri e Hollandës**, u zhvillua një vizitë në Eurojust, aktivitet i cili u mbështetet nga Misioni Pameca V. Qëllimi i kësaj vizite ishte bashkëpunimi operacional dhe prezantimi tek anëtarët e tjerë të Eurojust, i një modeli marrëveshjeje për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore, bazuar veçanërisht në eksperiencën e Shqipërisë me Italinë.

- Në datat **30 Shtator – 1 Tetor 2019, në Hagë, Hollandë**, u zhvillua “Konferenca Ndërkombëtare mbi Hetimin e Krimin kibernetik, (darkëeb-i dhe abuzimi online ndaj fëmijëve)”, organizuar nga Këshilli i Europës në bashkëpunim me Eurojust.

Aktivite në kuadër të EJNI (Rrjeti Gjyqësor Evropian)

- Në datat **10 – 12 Qershor 2019, në Sarajevë, Bosnia & Hercegovina** u zhvillua takimi i Pikave të Kontaktit të EJNI. Në këtë aktivitet u diskutua mbi përdorimin e formave të kërkesave për ndihmë juridike dhe organizimi u mbështet nga Projekti IPA 2017 “*Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor*”.

Takime për çështje konkrete

- Në datat **16 – 18 Prill 2019**, në **Braşov, Rumani**, u zhvillua një takim i përbashkët mes përfaqësuesve të Prokurorisë shqiptare dhe asaj rumune në kuadër të një hetimi të përbashkët lidhur me dosjen penale nr. 104D / P/ 2017 të DIICOT. Qëllimi i takimit ka qenë rivlerësimi i hetimit mbi bazën e standarteve më të mira ndërkombëtare ligjore dhe operationale, në mënyrë që të vlerësohet kjo përvojë në raste të tjera në të ardhmen. Në takim ka marrë pjesë dhe një prokuror nga Eurojust dhe të gjitha aspektet logjistike janë mbuluar nga Projekti SANCAS.

- Në kuadër të procedimit penal **nr. 40, të vitit 2006**, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale të “*Vrasjes me dashje*” dhe “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, parashikuar nga nenet 76-22, 278/2 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, grupi i hetimor do të udhëtojë në Torino, Itali me qëllim kryerjen e veprimeve proceduriale në funksion të hetimit (në datat **13 - 15 Shkurt 2019**). Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është caktuar Prokurori i çështjes që do të udhëtojë në Itali:

Projekti i PROCEEDS

- Në datën **29 Mars 2019 në Bukuresht, Rumani**, u zhvillua Mbledhja e 6-të e Komitetit Drejtues të Projektit iPROCEEDS “Për krimin kibernetik”.

- Në datën **30 Prill 2019 në Zagreb, Kroaci**, u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare me temë “*On Digital Evidence – DataFocus*”, në kuadër të Projektit iPROCEEDS Për krimin kibernetik.

- Në datat **8 - 9 Maj 2019 në Bukuresht, Rumani**, në kuadër të Projektit iPROCEEDS “*Për krimin kibernetik*” u zhvillua trajnimi me temë “*Tryezë ekspertize për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet e krimit kibernetik*”.

- Në datat **6 - 7 Maj 2019 në Mynih, Gjermani**, u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare me temë “*Lufta kundër trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore*”, në kuadër të Projektit iPROCEEDS Për krimin kibernetik.

- Në datat **25 – 27 Qershor 2019, në Singapor** u zhvillua trajnimi “*Mbi kanalet dhe rrugët e komunikimit për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet e krimit kibernetik*”, që organizohet nga Zyra e Këshillit të Europës për Krimin Kibernetik në bashkëpunim me Projektin iPROCEEDS dhe Interpol.

- Në datat **8 - 11 Korrik 2019 në Strasburg, Francë** u zhvillua Takimi i 21-të Plenar i Komitetit të Konventës së Krimit Kibernetik të Këshillit të Europës (T-CY) dhe Mbledhja e

4-t për Planin e Draftimit të Protokollit, aktivitete të cilat organizohen në kuadër të Projektit iPROCEEDS për krimin kibernetik.

- Në datat **3 - 6 Shtator 2019 në Strasburg, Francë**, u zhvillua Konferenca me temë “*Underground Economy Conference 2019*”, në kuadër të Projektit iPROCEEDS “*Për krimin kibernetik*”.

- Në datat **9 - 11 Tetor 2019 në Hagë, Hollandë**, u zhvillua Konferenca Vjetore për Krimin Kibernetik me temë “*Laë enforcement in a connected future- Agjensitë ligjzbatuese në një të ardhme të ndërlidhur*”, organizuar në kuadër të Projektit iPROCEEDS “*Për krimin kibernetik*” në bashkëpunim me Europol-Interpol.

- Në datat **9-10 Dhjetor 2019 në Strasburg, Francë**, u zhvillua Takimi Përmbyllës i Projektit të Këshillit të Europës iPROCEEDS “*Për krimin kibernetik*”.

ENPE (Rrjeti Evropian i Prokurorëve për Mjedisin)

- Në datat **28 - 29 Mars 2019 në Nikosia, Qipro** u zhvilluan trajnimet me temë “*Ndërgjegjësimi dhe rritja e kapaciteteve në luftën kundër krimeve mjedisore*” dhe “*Ndërgjegjësimi dhe rritja e kapaciteteve në luftën kundër ndotjes së ajrit*”, të cila janë organizuar nga Rrjeti ENPE (Rrjeti Evropian i Prokurorëve për Mjedisin).

- Në datat **28 - 30 Tetor 2019 në Hagë, Hollandë**, Rrjeti Evropian i Prokurorëve për Mjedisin (ENPE) në bashkëpunim me EUROJUST organizoi Konferencën Vjetore të ENPE “*Për krimin mjedisor*”.

Projekti IPA 2017 “Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor”

- Në datat **12 - 13 Shkurt 2019, në Mynih, Gjermani**, është zhvilluar Ëorkshop i Komitetit Drejtues të Projektit IPA 2017 “*Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor*”, me qëllim monitorimin e punës së Projektit, ecurisë së tij dhe për planifikimin e aktiviteteve për periudhën deri në dhjetor 2019.

- Në datën **28 Shkurt 2019, në Romë, Itali**, është zhvilluar takimi i dytë i Komitetit Drejtues të Projektit IPA 2017 “*Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor*”.

Trajnime në Shqipëri

- Në datën **12 Mars 2019, në Vlorë**, PAMECA V organizoi një tranim rajonal mbi narkotikët në juglindje të Shqipërisë. Në këtë aktivitet morën pjesë 16 prokurorë dhe 10 opgj.
- Në datën **4 Prill 2019, në Vlorë**, PAMECA V organizoi një tranim mbi ekspertizën e ADN-së në procesin hetimor me prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Përmet dhe Saranda. Morën pjesë 11 prokurorë.
- Në datën **24 Prill 2019, në Vlorë**, PAMECA V organizoi një tranim me temë “ Hetimet në renë informatike dhe uebin e erret, marrja e provave, problemet dhe sfidat kryesare. Morën pjesë rreth prokurorë dhe OPGJ.
- Në datën **17 Korrik 2019, në Shkodër**, PAMECA V organizoi seminarin e tretë mbi ekspertizën e ADN-së në procesin hetimor me prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Kukës, Lezhë, Peshkopi, Tropojë dhe Laç. Morën pjesë 10 prokurorë.
 - Në datën **22 korrik 2019**, në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme (Salla e Mbledhjeve) u organizua një takim informues/trajnuës me të gjitha Pikat e Kontaktit në të gjitha Prokuroritë e të gjitha niveleve në territorin e Republikës së Shqipërisë, së bashku me ekspertët e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas Raportit Monitorues nr. 1035/1 Prot., datë 28.06.2019 për Kontrolluesit “Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore” dhe Raportit Monitorues nr. 903/1, dt. 07.06.2019 për Kontrolluesin “Prokuroria e Përgjithshme”. Raportet monitoruese janë kryer në zbatim të Planveprimat ndërmjet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Prokurorisë së Përgjithshme nënshkruar më 25.02.2019, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST. Në këtë trajnim morën pjesë rreth 40 persona.
- Në datat **9-11 Tetor 2019, në Tiranë**, nga Instituti i Sirakuzës, është zhvilluar trajnimi me temë: Dialogu Strategjik Rajonal për tregtinë e paligjshme në Europën Juglindore, ku u diskutua për sa më poshtë: Vështrim i përgjithshëm i projektit, tregtia e paligjshme si kërcënim ndërsektorial dhe gjetjet paraprake Prezantimi i SEE-IMPACT, si një kuadër bashkëpunues për forcimin e luftës kundër tregtisë së paligjshme Analiza interaktive e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve (SËOT) kombëtare në luftën kundër tregtisë së paligjshme. Në këtë aktivitet morën pjesë 13 Prokurorë.
- Në datat **10 – 11 Tetor 2019, në Tiranë**, u zhvillua një seminar dy-ditor të udhëhequr nga prokurorë dhe hetues me përvojë nga Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria dhe Kroacia për të shkëmbyer përvojën e ndjekjes penale të veprave që lidhen me korrupsionin dhe ndihmën e ndërsjelltë ligjore ndërkombëtare. Ky aktivitet u organizua nga Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe Euralius. Morën pjesë Prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

IV. GARANTIMI INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE

Në sektorin e dekriminalizimit për vitin 2019, janë regjistruar **204** praktika/ kërkesa për verifikim, nga të cilat:


- janë **përfunduar 163** (*njëqind e gjashtëdhjetë e tre*), me 15 (*pesëmbëdhjetë*) subjekte të përfshirë në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione Publike” dhe 148 (*njëqind e dyzet e tetë*) subjekte që nuk përfshihen në këtë ligj.
- kanë **mbetur** në proces verifikimi **41** (*dyzet e një*) subjekte/kërkesa, mbartur për vitin 2020. (*Grafiku me poshtë në përqindje*).



Kërkesat për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga institucionet, si më poshtë :

- **71**⁵⁵ (*shtatëdhjetë e një*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga Departamenti Administrates Publike;
- **40** (*dyzet*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga Keshilli i Emerimeve ne Drejtesi;
- **21** (*njëzet e një*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga Kuvendi i Shqipërisë;
- **50** (*pesëdhjetë*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga Keshilli i Larte Gjyqesor;
- **9** (*nëntë*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- **8** (*tetë*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga Gjykata e Larte;
- **3** (*tre*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga 500 votues me të drejtë vote;
- **2** (*dy*) kërkesa për verifikim të subjekteve kanë ardhur nga Individë; (Shiko grafikun me poshtë).

⁵⁵ Për 1 subjekt është ndërprerë verifikimi.




- Për vitin 2019 janë mbartur, nga vitet 2016 deri 2018, në vijim në proces verifikimi, **53** (*pesëshjet e tre*) praktika/ kërkesa për verifikim të subjekteve, nga të cilat:
 - **43** (*dyzet e tre*), janë **përfunduar gjatë vitit 2019**;
 - **10** (*nëntë*) kanë mbetur **në proces verifikimi** për vitin 2020. Nga këto: - 1 është kërkesë e vitit 2016; - 3 janë kërkesa të vitit 2017 dhe - 6 janë kërkesa të vitit 2018. (Shiko grafikun në përqindje).




- Për periudhën **Janar – Dhjetor 2019**, në vendim marrjen e kërkesave, për verifikim të subjekteve, rezulton:
 - Për pozicionin “Zyrtarët e Lartë” janë dhënë në total **131** (njëqind e tridhjetë e një) vendime, nga të cilat rezultojnë **2** (dy) praktika me përfundimin “Përfshihet”: 1 (një) sipas nenit 3/ç dhe 1 (një) sipas nenit 2/1/a dhe 3/ç;
 - Për pozicionin “Nivel i Ekzekutiv” janë dhënë në total **38** (tridhjetë e tetë) vendime, nga të cilat rezultojnë **6** (gjashtë) praktika me përfundimin “Përfshihet”: 1 (një) me nenin 2/1/ç, 1 (një) me nenin 2/b, 1 (një) me nenin 2/1/a/ç, 2 (dy) me nenin 3/ç dhe 1 (një) me nenin 2/1/ç dhe 3/ç;
 - Për pozicionin “Nivel Drejtues” janë dhënë në total **20** (njëzet) vendime, nga të cilat rezultojnë **6** (gjashtë) praktika me përfundimin “Përfshihet”: 3 (tre) me nenin 2/1/ç, 2 (dy) me nenin 3/ç dhe 1 (një) me nenin 2/1/b dhe 3/ç;
 - Për pozicionin “Nivel i Mesëm” janë dhënë në total **17** (shtatëmbëdhjetë) vendime, nga të cilat rezultojnë **3** (tre) praktika me përfundimin “Përfshihet”: 2 (dy) me nenin 2/1/ç, dhe 1 (një) me nenin 3/ç; (Shiko grafikun me poshtë në përqindje).


Subjekte që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 138/2015



- Përsa i përket statusit të vendimit “Nuk përfshihet”, janë të specifikuara si më poshtë:
 - Për pozicionin “Zyrtar i Lartë” rezultojnë **129** (njëqind e njëzet e nëntë) subjekte;
 - Për pozicionin “Nivel Ekzekutiv” rezultojnë **32** (tridhjet e dy) subjekte;
 - Për pozicionin “Nivel Drejtues” rezultojnë **14** (katërbëdhjetë) subjekte;
 - Për pozicionin “Nivel i Mesëm” rezultojnë **14** (katërbëdhjetë) subjekte; (Shiko tabelën më poshtë).



- Për të gjitha praktikat/rastet për të cilat është marrë vendim dhe kanë rezultuar të “Përfshira” -17, është bërë kallëzim në institucionin përkatës.
- **Për periudhën Janar 2020** janë regjistruar të reja gjithsej **21** (njëzet e një) praktika/ kërkesa për verifikim të subjekteve, si më poshtë:
 - **7** (shtatë) kërkesa kanë ardhur nga Departamenti Administrates Publike;
 - **9** (nëntë) kërkesa kanë ardhur nga Keshilli i Emerimeve ne Drejtesi;
 - **1** (një) kërkesë ka ardhur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
 - **1** (një) kërkesë ka ardhur nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve;
 - **1** (një) kërkesë ka ardhur nga Lëvizja Qytetare Sopot;
 - **2** (dy) kërkesa kanë ardhur nga Partia Demokratike. (Grafiku me poshtë me përqindje).



V. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORIVE PËR VITIN 2019

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kanë sanksionuar se Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- ç) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në vitin 2019, numri i përgjithshëm i miratuar i prokurorëve ishte 336. Shpërndarja ⁵⁶ e tyre në prokurori sipas niveleve ka qenë, 291 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 28 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 309.

Në vitin 2019 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për çdo prokurori paraqitet si vijon:

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë	Prokurorë		Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	77	76	52	52	63	61	192	189
Berat	6	5	3	3	8	7	17	15
Dibër	6	6	2	2	7	6	15	14
Durrës	26	26	15	15	21	18	62	59

⁵⁶ Janar 2019

Elbasan	25	25	9	9	17	15	51	49
Gjirokastrë	5	5	2	2	10	9	17	16
Fier	14	14	8	8	15	14	37	36
Korçë	13	11	5	5	17	16	35	32
Krujë	6	4	3	3	6	5	15	12
Kukës	4	4	1	1	7	6	12	11
Lushnje	7	7	3	3	9	8	19	18
Lezhë	10	9	6	6	11	9	27	24
Mat	3	3	2	2	4	3	9	8
Përmet	2	2	1	1	4	3	7	6
Pukë	3	2	1	1	4	3	8	6
Pogradec	4	4	2	1	6	5	12	10
Sarandë	5	5	2	2	6	5	13	12
Shkodër	19	18	11	11	17	14	47	43
Tropojë	3	3	1	1	4	3	8	7
Vlorë	20	18	9	8	16	15	45	41
Kavajë	7	6	2	2	7	6	16	14
Kurbin	4	4	2	2	7	5	13	11
Prokuroria për Krime të Rënda	22	19	14	14	25	24	61	57

Prokuroritë pranë	Prokurorë	Administrata	Gjithsej
-------------------	-----------	--------------	----------

gjykatave të apelit	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	9	7	9	8	18	15
Durrës	4	3	5	4	9	7
Gjirokastrë	2	2	2	2	4	4
Vlorë	5	4	4	3	9	7
Shkodër	4	2	4	4	8	6
Korçë	2	2	4	4	6	6
Apeli për Krime të Rënda	2	1	6	6	8	7

Prokuroria e Përgjithshme	Prokurorë		Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	17	12	35	34	76	62	128	108

Duke iu referuar të dhënave statistikore vjetore të përcjella nga prokuroritë, volumi i punës dhe ngarkesa mesatare analizohet në vijim:

I. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë


I.1 Volumi në hetim

Volumi i punës në hetim në shkallë vendi

Gjatë vitit 2019, në organin e prokurorisë janë trajtuar 59888⁵⁷ materiale kallëzuese që përbën një rritje prej 3,73 % në krahasim me vitin 2018. Janë ndjekur gjithsej 44289 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 3,45 % në krahasim me vitin 2018, nga të cilat 30748 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 2,10 % në krahasim me vitin 2018 dhe 584 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 20,16 % në krahasim me vitin 2018. Janë mbartur nga viti 2018, 12957 procedime penale me një rritje prej 18,66 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2018. Është vendosur mosfillimi për 15599

⁵⁷ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura nga viti 2018; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2019 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2019; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2019.

referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një rritje prej 4,55 % në krahasim me vitin 2018.




Volumi në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2019 sipas prokurorive të shkallës së parë është si më poshtë:

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë ndjekur 2212 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë ndjekur 943 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë ndjekur 5812 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë ndjekur 4294 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë ndjekur 2864 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastër janë ndjekur 1786 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë ndjekur 1101 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë ndjekur 2864 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë ndjekur 1335 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë ndjekur 666 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë ndjekur 898 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë ndjekur 1723 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë ndjekur 1791 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë ndjekur 340 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë ndjekur 224 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë ndjekur 1012 çështje;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë ndjekur 299 çështje;


Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë ndjekur 2276 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë ndjekur 3004 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë ndjekur 19168 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë ndjekur 390 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë ndjekur 4091 çështje;
Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda janë ndjekur 795 çështje;

Grafikisht këto të dhëna paraqiten si vijon:



Në vitin 2019 volumi i punës që ka patur çdo prokuror⁵⁸ sipas prokurorisë ku ushtron funksionet është mesatarisht si më poshtë:

⁵⁸ Mesatarja është përlogaritur si raport i volumit në hetim me numrin faktik të prokurorëve, përfshirë drejtuesit dhe zëvendësdrjtuesit.



I.2 Sipas prokurorive të shkallës së parë, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2019 është si vijon:

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 994 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 514 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 2819 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 2551 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 1727 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 742 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë regjistruar 552 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 1406 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 834 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 402 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 470 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 1042 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 849 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë regjistruar 172 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë regjistruar 108 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 499 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë regjistruar 137 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 1065 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 1671 procedime penale;


Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 9612 procedime penale;

Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë regjistruar 181 procedime penale;


Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 2078 procedime penale;

Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda janë regjistruar 270 procedime penale.


Grafiku më poshtë paraqet të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2019:



Ndërkohë, numri i të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë, paraqitet në grafikun më poshtë:



Mesatarisht⁵⁹ prokurorët kanë ndjekur sipas prokurorive ku ushtrojnë funksionet një numër procedimesh të regjistruara si vijon:



II. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të apelit

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka shqyrtuar 410 çështje themeli dhe 351 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar 105 çështje themeli dhe 88 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë ka shqyrtuar 146 çështje themeli dhe 128 çështje lidhur me masat e sigurimit;


Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar 384 çështje themeli dhe 286 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka shqyrtuar 1089 çështje themeli dhe 996 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka shqyrtuar 449 çështje themeli dhe 372 çështje lidhur me masat e sigurimit;


⁵⁹ Mesatarja është përlogaritur si raport i numrit të procedimeve të regjistruara me numrin faktik të prokurorëve, përfshirë drejtuesit dhe zëvendësdrejtuesit.

Grafikisht të dhënat paraqiten si vijon, ku siç vërehet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë edhe për vitin 2019 ka patur ngarkesën më të madhe:



Raporti i numrit të çështjeve⁶⁰ me numrin e prokurorëve sipas prokurorisë përkatëse paraqitet në grafikun në vijim:

⁶⁰ Përlogaritje mesatare e raportit të totalit të çështjeve të trajtuara me numrin faktik të prokurorëve.



III. Ngarkesa e punës së Prokurorisë së Përgjithshme

III.1 Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 5 çështje dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 1 çështje.

III.2 Mosmarrëveshje për kompetencë

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2019 kanë marrë 62 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore.

III.3 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2019, ka trajtuar:

- Ekstradime nga jashtë - 180 kërkesa;
- Ekstradime për jashtë - 157 shtetas;
- Letërporositë nga jashtë - 625 letërporosi;
- Letërporositë për jashtë - 639 letërporosi;
- Njohjet e vendimeve penale të huaja - 44 kërkesa;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit - 20 kërkesa;

- Transferimet e procedimeve nga jashtë- 27 raste;
- Transferimet e procedimeve për jashtë - 18 procedime penale;
- Transferimet e personave të dënuar nga jashtë - në 34 raste;
- Transferimet e personave të dënuar për jashtë - 8 kërkesa.

Gjatë vitit 2019 prokuroria ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 235 **shtetas** dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e **172 subjekteve** nga listat e kërkimit ndërkombëtar.

Vlerësojmë të theksojmë se, përveç volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme ka trajtuar në kohë reale gjatë vitit 2019 edhe 651 **kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja.

III.4 Përgjimet

Gjatë vitit 2019 janë ekzekutuar gjithsej 2714 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, aplikuar në lidhje me 717 procedime penale. Nga këto, procedime 141 penale kanë qenë në kuadër të hetimeve të prokurorisë për krime të rënda. Përsa më sipër është mundësuar interceptimi për 5062 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.


III.5 Dekriminalizimi

Spektori i Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushetrojnë Funksione Publike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2019, ka administruar 204 raste për verifikim të thelluar.

Gjatë kësaj periudhe, për 163 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 41 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

IV. Ngarkesa në pesë vitet e fundit

Volumi në hetim në shkallë vendi në pesë vitet e fundit, ku numri organik i prokurorëve ka qenë 336, paraqitet grafikisht në vijim:



Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2015	2016	2017	2018	2019
Berat	Volumi në hetim	1986	1962	2122	1898	2212
	Numri i prokurorëve	7	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	284	327	354	316	369
Dibër	Volumi në hetim	855	798	1228	987	943
	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	143	133	205	165	157
Durrës	Volumi në hetim	4750	4104	4678	5152	5812
	Numri i prokurorëve	26	26	26	26	26
	Mesatarja për prokuror	183	158	180	198	224
Elbasan	Volumi në hetim	4451	4023	3815	3788	4294
	Numri i prokurorëve	25	25	25	25	25
	Mesatarja për prokuror	178	161	153	152	172
Fier	Volumi në hetim	3141	2688	2621	2871	2864
	Numri i prokurorëve	16	14	14	14	14
	Mesatarja për prokuror	196	192	187	205	205
Gjirokastrë	Volumi në hetim	1245	1442	1577	1483	1786

	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	249	288	315	297	357
Kavajë	Volumi në hetim	1096	1203	1171	1047	1101
	Numri i prokurorëve	6	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	183	172	167	150	157
Korçë	Volumi në hetim	2485	2346	2465	2791	2864
	Numri i prokurorëve	15	13	13	13	13
	Mesatarja për prokuror	166	180	190	215	220
Krimet e Rënda	Volumi në hetim	769	671	722	667	795
	Numri i prokurorëve	16	20	22	22	22
	Mesatarja për prokuror	48	34	33	30	36
Krujë	Volumi në hetim	1196	1229	1051	1172	1335
	Numri i prokurorëve	7	7	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	171	176	175	195	223
Kukës	Volumi në hetim	1008	912	781	699	666
	Numri i prokurorëve	5	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	202	228	195	175	167
Kurbin	Volumi në hetim	1021	874	919	899	898
	Numri i prokurorëve	5	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	204	219	230	225	225
Lezhë	Volumi në hetim	2179	1894	1868	2127	1723
	Numri i prokurorëve	10	10	10	10	10
	Mesatarja për prokuror	218	189	187	213	172
Lushnje	Volumi në hetim	1730	1702	1791	1617	1791
	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	247	243	256	231	256
Mat	Volumi në hetim	477	522	445	360	340
	Numri i prokurorëve	5	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	95	174	148	120	113
Përmet	Volumi në hetim	217	279	240	214	224
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	109	140	120	107	112
Pogradec	Volumi në hetim	879	924	947	1034	1012
	Numri i prokurorëve	5	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	176	231	237	259	253
Pukë	Volumi në hetim	434	322	280	230	299
	Numri i prokurorëve	4	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	109	107	93	77	100
Sarandë	Volumi në hetim	1624	1605	1761	1849	2276
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	325	321	352	370	455
Shkodër	Volumi në hetim	4047	4526	3654	3357	3004

	Numri i prokurorëve	19	19	19	19	19
	Mesatarja për prokuror	213	238	192	177	158
Tiranë	Volumi në hetim	17868	18452	19541	18924	19168
	Numri i prokurorëve	73	78	77	77	77
	Mesatarja për prokuror	245	237	254	246	249
Tropojë	Volumi në hetim	622	415	431	447	390
	Numri i prokurorëve	4	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	156	138	144	149	130
Vlorë	Volumi në hetim	4449	4458	4183	4121	4091
	Numri i prokurorëve	20	20	20	20	20
	Mesatarja për prokuror	222	223	209	206	205

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezultojn si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2015	2016	2017	2018	2019
Durrës	Volumi	1205	1143	1182	761	761
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	4
	Mesatarja për prokuror	241	229	236	152	190
Gjirokastrë	Volumi	418	389	318	238	193
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	209	195	159	119	97
Korçë	Volumi	537	355	469	405	274
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	269	178	235	203	137
Shkodër	Volumi	949	1279	1110	1279	670
	Numri i prokurorëve	3	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	316	320	278	320	168

Tiranë	Volumi	4197	3919	3200	3113	2085
	Numri i prokurorëve	8	9	9	9	9
	Mesatarja për prokuror	525	435	356	346	232
Vlorë	Volumi	1524	1436	1261	1001	821
	Numri i prokurorëve	4	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	381	287	252	200	164

Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2015	2016	2017	2018	2019
Berat	Volumi në hetim	1986	1962	2122	1898	2212
	Numri i prokurorëve	7	6	6	6	5
	Mesatarja për prokuror	284	327	354	316	442
Dibër	Volumi në hetim	855	798	1228	987	943
	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	143	133	205	165	157
Durrës	Volumi në hetim	4750	4104	4678	5152	5812
	Numri i prokurorëve	26	25	25	25	26
	Mesatarja për prokuror	183	164	187	206	224
Elbasan	Volumi në hetim	4451	4023	3815	3788	4294
	Numri i prokurorëve	25	25	25	25	25
	Mesatarja për prokuror	178	161	153	152	172
Fier	Volumi në hetim	3141	2688	2621	2871	2864
	Numri i prokurorëve	16	14	14	14	14
	Mesatarja për prokuror	196	192	187	205	205
Gjirokastrë	Volumi në hetim	1245	1442	1577	1483	1786
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	249	288	315	297	357
Kavajë	Volumi në hetim	1096	1203	1171	1047	1101
	Numri i prokurorëve	6	7	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	183	172	195	175	184
Korçë	Volumi në hetim	2485	2346	2465	2791	2864

	Numri i prokurorëve	14	12	11	11	11
	Mesatarja për prokuror	178	196	224	254	260
Krimet e Rënda	Volumi në hetim	769	671	722	667	795
	Numri i prokurorëve	16	20	20	20	19
	Mesatarja për prokuror	48	34	36	33	42
Krujë	Volumi në hetim	1196	1229	1051	1172	1335
	Numri i prokurorëve	7	7	5	5	4
	Mesatarja për prokuror	171	176	210	234	334
Kukës	Volumi në hetim	1008	912	781	699	666
	Numri i prokurorëve	4	4	3	3	4
	Mesatarja për prokuror	252	228	260	233	167
Kurbin	Volumi në hetim	1021	874	919	899	898
	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	255	219	230	225	225
Lezhë	Volumi në hetim	2179	1894	1868	2127	1723
	Numri i prokurorëve	10	10	10	10	9
	Mesatarja për prokuror	218	189	187	213	191
Lushnje	Volumi në hetim	1730	1702	1791	1617	1791
	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	247	243	256	231	256
Mat	Volumi në hetim	477	522	445	360	340
	Numri i prokurorëve	5	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	95	174	148	120	113
Përmet	Volumi në hetim	217	279	240	214	224
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	109	140	120	107	112
Pogradeç	Volumi në hetim	879	924	947	1034	1012
	Numri i prokurorëve	5	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	176	231	237	259	253
Pukë	Volumi në hetim	434	322	280	230	299
	Numri i prokurorëve	4	2	2	2	3
	Mesatarja për prokuror	109	161	140	115	100
Sarandë	Volumi në hetim	1624	1605	1761	1849	2276
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	325	321	352	370	455
Shkodër	Volumi në hetim	4047	4526	3654	3357	3004
	Numri i prokurorëve	19	19	19	19	18
	Mesatarja për prokuror	213	238	192	177	167
Tiranë	Volumi në hetim	17868	18452	19541	18924	19168
	Numri i prokurorëve	73	77	76	76	77
	Mesatarja për prokuror	245	240	257	249	249
Tropojë	Volumi në hetim	622	415	431	447	390

	Numri i prokurorëve	4	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	156	138	144	149	130
Vlorë	Volumi në hetim	4449	4458	4183	4121	4091
	Numri i prokurorëve	20	20	18	18	18
	Mesatarja për prokuror	222	223	232	229	227

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2015	2016	2017	2018	2019
Durrës	Volumi	1205	1143	1182	761	761
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	3
	Mesatarja për prokuror	241	229	236	152	254
Gjirokastrë	Volumi	418	389	318	238	193
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	209	195	159	119	97
Korçë	Volumi	537	355	469	405	274
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	269	178	235	203	137
Shkodër	Volumi	949	1279	1110	1279	670
	Numri i prokurorëve	3	4	4	4	2
	Mesatarja për prokuror	316	320	278	320	335
Tiranë	Volumi	4197	3919	3200	3113	2085
	Numri i prokurorëve	8	8	9	9	7
	Mesatarja për prokuror	525	490	356	346	298

Vlorë	Volumi	1524	1436	1261	1001	281
	Numri i prokurorëve	4	5	5	5	4
	Mesatarja për prokuror	381	287	252	200	70

VI. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS FINANCIARE DHE

ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL PËR VITIN 2019

Raporti i monitorimit 2019

Dokumenti bazë mbi të cilin është mbështetur aktiviteti buxhetor i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2019, është Deklarata e Politikës së Programit Buxhetor Afatmesëm. Kjo deklaratë, është hartuar mbështetur në dokumenta si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, rekomandime të dhëna nga ekspertë të huaj si dhe nga prioritetet e vetë institucionit, të përcaktuara në analizat e punës vjetore.

Prioritetet e punës tone kanë konsistuar në :

- Krijimin e kushteve cilësore në kryerjen e detyrave funksionale të prokurorëve nëpërmjet mbështetjes financiare të aktivitetit të tyre;
- Përmirësimit të infrastrukturës ndërtimore, kushteve të punës, si dhe plotësimit me elemente të sigurisë;
- Mbështetjen në vazhdimësi me fonde buxhetore për rritjen profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të prokurorëve e oficerëve të policisë gjyqësore;
- Ndjekjen e politikave buxhetore fleksibël, gjatë zbatimit të buxhetit, në varësi të situatave konkrete të krijuara.

Disa nga mekanizmat e përdorur gjatë aktivitetit buxhetor të prokurorisë janë:

- Analiza e detajuar e projekt-buxhetit afatmesëm të çdo prokurorie në funksion të hartimit të Projekt- Buxhetit Përmbledhës për Prokurorinë e Përgjithshme;
- Ndjekja periodike e realizimit të shpenzimeve buxhetore nëpërmjet situacionit mujor të shpenzimeve;
- Analiza e detajuar e kërkesave për buxhet shtesë referuar situatave apo zhvillimeve të reja, në funksion të rialokimit të fondeve me qëllim realizimin e buxhetit dhe efektivitetin e buxhetit të miratuara me ligj;
- Monitorimi i zbatimit të buxhetit, nëpërmjet raporteve të monitorimit, të cilat janë katër mujore. Me anë të këtyre raporteve identifikohen arritjet në terma sasiore dhe vlerore të produkteve të ofruara dhe shkaqet e mosrealizimeve;
- Monitorimi dhe kontrolli i llogarive vjetore të prokurorive në funksion të hartimit të llogarisë vjetore përmbledhëse për Prokurorinë e Përgjithshme (Bilanci i konsoliduar).

Me ligjin nr.99/2018, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019”, u miratua buxheti për Prokurorinë e Përgjithshme, në vlerë 1.752.200 mijë lekë.

Realizimi i fondeve buxhetore për Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2019, sipas zërave (në 000/lekë), për vitin 2018 paraqiten si më poshtë (në buxhetin e rishikuar për vitin 2019, janë përfshirë të gjitha rialokimet e kryera gjatë vitit):

Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2019	Buxheti i Rishikuar për vitin 2019	Realizimi i buxhetit për vitin 2019	Raporti (në %) Realizim/ Buxhet për vitin 2019
Paga	1.062.000	1.685.000	1.649.629	97.9%
Sigurime Shoqërore	208.000	184.500	168.845	91.5%
Shpenzime operative	349.905	349.850	343.836	98.2%
Transferta korente të huaja	95	150	140	93.3%
Transferime tek individ	2.200	2.700	2.413	89.3%
Investime	130.000	130.000	6.895	5.3%
TOTALI	1.752.200	2.352.200	2.171.758	92.3%

Siç vërehet, buxheti i miratuar për **shpenzime personeli** (paga dhe sigurime shoqërore) në fillim të vitit 2019, ishte 1.270 milion lekë. Ky buxhet mbulonte nevojat për paga dhe sigurime shoqërore për numrin e punonjësve të miratuar me ligj prej (928 punonjës).

Por në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Per statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr.1, date 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019” pika 10, nuk ishte çelur fondi i pagave për efekt të rritjes së pagave të magjistratëve. Në kushtet kur edhe institucionet e reja ishin në krijim e sipër lindi nevoja për shtesë të fondit “Paga” në shumën 600.000 mijë lekë nga fondi rezervë i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Sistemin e Drejtësisë.

Gjatë vitit 2019 nuk janë plotësuar vendet vakante për punonjës nga të cilët 8 prokurorë, 3 oficerë të policisë gjyqësore dhe 1 kancelar.

Si rezultat i këtyre shtesave buxheti për shpenzime personeli për vitin 2019 u realizua në masën 1.649.629 mijë lekë ose 97,9 % e buxhetit të rishikuar.

Shpenzimet operative, përfshijnë shpenzime që kryhen nga prokuroritë në mbështetje të realizimit të detyrave të tyre funksionale si: shtypshkrime, kancelari, udhëtime e dieta, energji, shpenzime postare, telefon, shpenzime transporti, shpenzime për mirëmbajtje të ndryshme (sidomos sistemet e IT dhe paisjet e Interceptimit), shpenzime për ruajtjen e

godinave, avokatë, përkthyes, ekspertë të ndryshëm, shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, etj.

Edhe pse, ky zë i shpenzimeve, ka një peshë të ulët specifike, në buxhetin total të prokurorisë 14,8%, impakti i tij në aktivitetin e përditshëm është i drejtpërdrejtë dhe shumë i rëndësishëm.

Për vitin 2019, buxheti i miratuar me ligj për shpenzime operative prej 349.850 mijë lekë ishte i plotësonte të gjithë nevojat e parashikuara për këtë zë të shpenzimeve të kërkuara edhe në Projekt-Buxhetin 2019-2021. Përdorimi me efikasitet të lartë i këtyre fondeve bëri që gjatë vitit 2019 të likujdohen 124,9 milionë lekë fatura për grupin (avokate, ekspertë, MKZ dhe Mjeko Ligjore) të cilat pothuajse çdo vit rriten me 80 milione lekë.

Buxheti për shpenzime operative për vitin 2019 u realizua në masën 343.836 mijë lekë ose 98,2% e buxhetit ë rishikuar.

Përsa i përket **investimeve**, fondi i miratuar për investime për vitin 2019, ishte 130,000 mijë lekë.

Në detajimin e fondit të investimeve për vitin 2019 janë mbajtur në konsideratë, kërkesat buxhetore për vitin 2019, programi afatmesëm i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme për investimet në infrastrukturën ndërtimore të prokurorive, infrastrukturës elektronike etj.

Ky buxhet si dhe realizimi gjatë vitit i investimeve paraqitet në tabelën në vijim:

Emri Produktit	Njësia Matëse	Sasia e Planifikuar	Sasia e Realizuar
Rikonstruksion godine	000/leke	42.148	448
Paisje kompjuterike	000/leke	57.274	3.947
Sistemi me kamera	000/leke	16.483	0
Paisje e orendi zyre	000/leke	7.984	868
Blerje dhe instalim kondicioneri	000/leke	960	834
Blerje paisje teknike	000/leke	5.151	798

Fondi i investimeve është realizuar në masën 6.895 mijë lekë ose 5,3 % e buxhetit të miratuar për vitin 2019.

Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

Për vitin 2019, sipas kalendarit vjetor të auditimeve, janë miratuar nga ana e titullarit, 11 angazhime auditimi gjithsej, nga të cilat 10 të kombinuara dhe 1 auditim pjesor (pajtueshmërie e të tjera), ndërkohë që janë kryer gjithsej 9 misione auditimi nga të cilat 8 misione të kombinuara dhe një tematik.

Subjektet që u audituan janë prokuroritë e shkallës së parë Lushnje, Gjirokastër, Përmet, Berat, Krimet e Rënda, Korçë, prokuroritë e Apelit Korçë, Gjirokastër, Vlorë, Krime të Rënda.

Në fazën e planifikimit të angazhimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të mesëm, dhe aty është fokusuar auditimi.

Mbështetur në përvojën e audituesve, në analizat e detajuara të problematikave të hasura përgjatë angazhimeve si dhe specifikave të aktivitetit në njësitë vartëse, fokusi i fushave prioritare, mbi të cilat janë fokusuar e materializuar programet e auditimit, kanë qenë si më poshtë:

- Prokurimet e fondeve publike dhe zbatimi i kuadrit rregullator për investimet;
- Në fushën e investimeve publike me financim të brendshëm;
- Administrimi i vlerave materiale e monetare;
- Shkelje, shpërdorime dhe mungesë dokumentacioni justifikues për shpenzimet e kryera për udhëtime e dieta;
- Zbatimi i rregullave të kontabilitetit publik, ruajtja dhe administrimi i pronës;
- Përmirësimi i rregullave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimi i asetëve dhe burimeve nga subjektet e audituara etj.

Nga misionet e ushtruara në subjekte janë përcaktuar risqet kryesore të identifikuara dhe janë marrë masa për analizimin dhe trajtimin e këtyre risqeve, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e komponentëve të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar Publik.

Nga misionet e auditimit për vitin 2019 në subjektet e audituara, janë dhënë 52 rekomandime gjithsej, të strukturuar sipas kësaj tipologjie:

- a) 1 rekomandime për arkëtim të shumave që janë përfituar padrejtësisht;
- b) 51 rekomandime për masa të karakterit të ndryshëm.

Zbatimi i ligjit për shërbimin civil

Në zbatim të ligjit 152/2013 “për nëpunësin civil” i ndryshuar, gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 2 konkurse për praninë në shërbimin civil në pozicionet: specialist projektsh në Sektorin e studimeve dhe specialist IT.

Gjatë vitit 2019, 3 punonjës në periudhë prove ndoqën programin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA.

VII. OBJEKTIVA PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2020

Me synim përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor të prokurorisë, forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e mëtejshme të efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e çështjeve/akuzave në gjyq, për krime të rënda e sensitive, me shtrirje të gjerë dhe me tendenca në rritje dhe në marrjen e masave për vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe respektimin e të drejtave të ligjshme dhe lirive personale të individit në procesin penal, objektivat/prioritetet dhe masat e prokurorisë për vitin 2020, janë si më poshtë:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rritja e efikasitetit në ndjekjen penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, nëpërmjet masave:

i) Inicimi i ndryshimit të nenit 287 të K.Penal, për të parashikuar në mënyrë të qartë një nocion të dyshimit (*dyshonte se pasuria ishte e ardhur*) ose neglizhencës (*duhej të supozonte/mendonte se pasuria ishte e ardhur*) nga krimi në kontekstin e kësaj vepre penale, në përqasje me nenin 9 (3) të Konventës së KiE-së “*Për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimi i terrorizmit*” e ratifikuar me ligjin nr.9646/2006, sipas rekomandimit për Shqipërinë nga Konferenca e Palëve të kësaj Konvente të KiE-së në Tetor 2019, ashtu dhe në kuadrin e përafrimit të këtij neni të K.Penal me Direktivën (BE) 1673/201 të Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 Tetor 2018 “*Për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit*”;

ii) Krijimi i një task-force ndërinstitucionale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

iii) Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjensi ligjzbatuese të përfshira, mbi gjurmimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në bashkëpunim me Projektin Pameca V;

iv) Pasurimi/përditësimi i manualit të Projektit të Binjakëzimit të BE “*Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri*” me standartet dhe praktikën e mira europiane, praktikën shqiptare dhe ide novative mbi tipologjitë dhe metodikën e hetimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

v) Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit përmes ndërtimit të platformave apo skuadrave të përbashkëta, me qëllim përafrimin e qasjeve institucionale dhe rrëzimin e barrierave burokratike;

vi) Rritja e hetimeve paralele, krahas hetimeve për veprën penale kryesore që gjeneron të ardhura nga veprimtaria kriminale ose veprimtaria terroriste, sipas rastit edhe për veprat penale pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit;

vii) Rritja e fleksibilitetit në përgjigjen ndaj fenomenit, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat që lejon ligji, me qëllim goditjen e aseteve të pajustificuara dhe vënien para përgjegjësisë penale të të hetuarve për pastrim produktesh të veprave penale, edhe përmes rritjes së rasteve të ndjekjes penale për veprat penale në fushën ekonomike;

viii) Rritja e hetimeve pasurore, krahas hetimeve për veprën penale që gjeneron të ardhura nga veprimtaria kriminale, dhe rritja e kërkesave, sipas rastit, për sekuestrim preventiv të pasurive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale dhe/ose sekuestrim në zbatim të ligjit nr.10192/2009 “antimafia”, lidhur me pasuritë e ardhura nga veprimtaria kriminale, si dhe rritja e kërkesave për konfiskimin e tyre.

2. Standartizimi i procedurave të operimit në pikëpamje administrative dhe procedurale brenda zyrave të prokurorisë në funksion të organizimit të ri kushtetues dhe ligjor, me qëllim funksionimin normal të tyre, duke ruajtur pavarësinë dhe siguruar përgjegjshmërinë e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet masave:

i) Përcaktimi i ngarkesës për prokuror dhe rishikimi i strukturave, nëpërmjet aktiviteteve:

-Përcaktimi i ngarkesës mesatare për prokuror dhe numrin e prokurorëve sipas rretheve gjyqësore dhe niveleve të prokurorisë, bazuar në standardet dhe praktikat e mira europiane. *Kjo, referuar në analiza/studime të volumit të punës, gjendjes, përhapjes dhe tendencave të kriminalitetit, në prokuroritë e shkallës së parë, prokuroritë e apeleve dhe në prokurorinë e përgjithshme, sipas treguesve në 5 (pesë) vitet 2015-2019;*

-Rishikimi i strukturave organike dhe funksionale të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm në të gjitha nivelet;

-Rishikimi i rregullave standart të organizimit dhe funksionimit të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, për menyrën e organizimit në seksione, llojet dhe numrin e tyre në vartësi të tendencave dhe shtrirjes së grup veprave penale në prokuroritë e shkallës së parë, në bashkëpunim me Projektin Euralius V.

ii) Masat për të shmangur efektet e uljes së numrit të prokurorëve në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtar:

-Shtimi i numrit të oficerëve të policisë gjyqësore dhe në administratën ndihmëse/mbështetëse të prokurorëve në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm, për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur vepimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në sistemin e prokurorisë, bazuar në studimin e gjendjes dhe nevojave;

-Bashkëpunimi me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas ligjit, me synim për të shmangur rritjen progresive të numrit organik të prokurorëve që i

mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

iii) Inicimi i ndryshimeve ligjore, në përjasje me praktikat e mira dhe standartet e europiane, për të shmangur problemet e hasura në praktikë dhe të kuadrit ligjor **lidhur me ngritjen e grupeve hetimore për çështje të veçanta**, dhe për të parashikuar: -kritere të qarta për rastet e krijimit të grupeve hetimore; -përdorimin e shortit elektronik apo formave të tjera në caktimin e prokurorëve pjesëmarrës në grupin hetimorë; -rregullat për funksionimin e tyre si gjatë hetimit, në fazën e mbylljes së tij dhe deri në përfundimin e përfaqësimit të çështjes/akuzës në gjykim;

iv) Përmirësimi i procedurave të trajtimit të kallëzimeve penale apo materialeve referuese, nëpërmjet miratimit të një **memorandumi të përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për standartizimin e trajtimit të materialeve kallëzuese/referuese në prokurori** me qëllim uljen e ngarkesës së prokuroreve dhe shkurtimin e procedurave dhe kohës së zgjidhjes për ankesat apo kallëzimet e shtetasve dhe viktimave akuzuese.

3. Mirëfunksionimi i zyrave të prokurorisë, përmes monitorimit të punës në drejtim të zbatimit të ligjshmërisë, garantimit të respektimit të pavarësisë së prokurorëve dhe rritjes së përgjegjshmërisë, respektimit të drejtave të subjekteve të procedimit penal, nëpërmjet masave:

i) Sektori i monitorimit i krijuar rishtazi në Prokurorinë e Përgjithshme **do të formalizojë masat administrative dhe teknike për të krijuar mekanizma komunikimi**, me prokuroritë e shkallës së parë dhe apeleve, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Avokatin e Popullit, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe organizmat e shoqërisë civile, me qëllim shkëmbimin e të dhënave dhe identifikimin në kohë të rasteve objekt monitorimi;

ii) Përgatitja e projekt udhëzimit të përgjithshëm për funksionimin e sistemit të monitorimit;

iii) Përgatitja e projekt akteve të përbashkëta me institucionet e tjera për arritjen e marëveshjeve të bashkëpunimit dhe krijimin e mekanizmave komunikues të përhershëm;

iv) Konceptimi dhe përgatitja e projekt protokolleve standarde për trajtimin e të dhënave.

4. Mirëadministrimi i procesit, që nga faza e regjistrimit të veprës penale dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, me qëllim uljen e kohëzgjatjes së hetimeve dhe optimizimin e produktivitetit, nëpërmjet masave:

i) Evidentimi i problemeve të hasura në implementimin e “sistemit të menaxhimit të çështjeve” (CAMS), dhe propozimi i masave konkrete për përshtatjen e këtij sistemi sipas nevojave të organit të prokurorisë, për të mundësuar hedhjen e bazave për dixhitalizimin e plotë të dosjeve penale;

ii) **Ngritja e një grupi pune për vlerësimin e situatës ligjore dhe infrastrukturës dixhitale për ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave në institucione të ndryshme apo organizma private** duke përfshirë në proces përfaqësues nga ekzekutivi, institucionet e pavarura, subjektet private, ekspertë etj;

iii) **Vlerësimi i kapaciteteve humane dhe teknologjike, përllogaritja e kostove dhe gjetja e financimeve;**

iv) **Inicimi i ndryshimeve ligjore që do të mundësojnë aksesin dhe komunikimin e të dhënave në rrugë elektronike, si dhe që do të legjitimojnë përdorimin e tyre;**

5. Intensifikimi i bashkërendimit ndërinstitucional me të gjithë aktorët e përfshirë, për të rritur efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale, si kundër veprave penale me natyrë korruptive, trafikimet e paligjshme, vepra me qëllime terroriste apo krime të rënda të tjera, ashtu dhe kundër fenomeneve kriminale tradicionale, siç janë vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje, etj, apo krime që çënojnë rendin dhe sigurinë publike, duke bërë kujdes për të administruar çdo indicie dhe provë që evidentojnë elemente të formave të bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e veprimtarisë kriminale (organizate kriminale, organizate terroriste, grupi strukturuar, etj), në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme;

i) **Zgjerimi e thellimi i hetimeve dhe rritja e efikasitetit në ushtrimin e ndjekjes penale ndaj veprave penale në kompetencë të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm** do të ndihmojë koordinimin e veprimtarisë hetimore me Prokurorinë e Posaçme dhe do të jetë bazë e furnizimit e kësaj prokurorie me çështjet që lidhen me grupveprat penale të krimit të organizuar.

ii) **Rritja e mëtejshme e bashkëpunimit në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë me autoritetet gjyqësore të huaja,** si për të shkëmbyer informacion lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit, ashtu dhe rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit, **me mbështetjen e Prokurorit Ndërlidhës Shqiptar në selinë e Eurojust-it,** i cili së afërmi pritet të përzgjidhet e të komandohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

6. Vlerësim i thelluar mbi efikasitetin e politikave penale, përmes rikonceptimit të qasjeve institucionale dhe kuadrin ligjor, me qëllim uljen e nivelit të kriminalitetit, reduktimin e kostove të hetimit dhe minimizimin e efekteve sociale, nëpërmjet masave:

i) **Përgatitja e udhëzimit të përgjithshëm “Për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”,** në bashkëpunim me Projektin Euralius V, me synim llogaritjen e shpenzimeve procedurale penale të parapaguara nga shteti dhe marrjen e masave procedurale për kthimin e tyre shtetit;

ii) **Nëpërmjet bashkëpunimit me disa aktorë (Shkolla e Magjistraturës, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, INSTAT-in e institucione tjera të përfshira,) të ndërmerren hapat e nevojshëm për të mundësuar fillimin e përgatitjeve për një studim të përbashkët “Vlerësimi i thelluar mbi efikasitetin e politikave penale, përmes**

rikonceptimit të qasjeve institucionale dhe kuadrit ligjor, me qëllim uljen e nivelit të kriminalitetit”.

-Nisur nga fakti se, në zbatimin e disa masave prioritare mësipër për inicimin e ndryshimeve ligjore dhe në zbatimin e kësaj mase përfshihen edhe aktorë të tjerë të institucioneve të pavarura, ekzekutivit, arsimit të lartë dhe ato akademike kërkohet mbështetjen tuaj, me anë të mekanizmave kushtetues e ligjor që dispononi, për të mundësuar zbatimin e tyre.

7. Nxjerrja e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme me natyrë administrative dhe procedurale, në bashkëpunim me Projektin EURALIUS V, me synim qartësimin e kuptimit dhe zbatimit në praktikë të kuadrit ligjor përkatës dhe mbikëqyrja e zbatimit tyre, si më poshtë:

- i) Udhëzimi i përgjithshëm “Për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave”;
- ii) Udhëzimi i përgjithshëm “Për funksionimin e policisë gjyqësore të përfshirë në hetime dhe koordinimin e punës ndërmjet tyre dhe prokurorive në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- iii) Udhëzimi i përgjithshëm “Për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit dhe të oficerit të policisë gjyqësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- iv) Udhëzimi i përgjithshëm “Për ushtrimin e të drejtës së ankimit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- v) Udhëzimi i përgjithshëm “Për ekzekutimin e vendimeve penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- vi) Udhëzimi i përgjithshëm “Për marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe urdhërin penal”;
- vii) Udhëzimi i përgjithshëm “Për kërkesat e prokurorit për caktimin e masave të sigurimit”;
- viii) Udhëzimi i përgjithshëm “Për kryerjen e hetimeve proaktive”;

8. Garantimi i respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale, nëpërmjet mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të ligjshme dhe lirive personale të individit në procesin penal, me synim mbrojtjen e lirive dhe të drejtat, si të personave të arrestuar, ndaluar, paraburgosur apo dënuar, ashtu dhe të viktimës.

9. Përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori, forcimin e kapaciteteve institucionale e profesionale dhe për sigurimin e aksesit të shtetasve në shërbimin e prokurorisë.

Ju faleminderit!

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA

ANEKS I

TË DHËNA PËR PASURITË E SEKSUESTRUARA DHE TË KËRKUARA PËR KONFISKIM NË ZBATIM TË LIGJIT NR.10192/2009 DHE KODIT TË PROCEDURËS PENALE

I. Informacion i Prokurorisë për Krime të Rënda lidhur me sekuestrimet dhe kërkesat për konfiskim në zbatim të ligjit nr.10192/2009

Gjatë vitit 2019, në procedimet penale në fazën e hetimeve, është vendosur masa e sekuestrimit për pasuri të dyshuara si produkte të veprës penale në zbatim të ligjit nr.10192/2019 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, në kuadër të 13 procedimeve penale dhe është kërkuar në gjykatë konfiskimi mbi pasuritë e listuara më poshtë:

-Kërkesat për konfiskimin e pasurive si më poshtë janë:

- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.5, viti 2017 është paraqitur kërkesa për konfiskimin e 26 pasurive të paluajtshme dhe vlerës së investimit të kryer në këto pasuri, ku vlera e pasurive që kërkohet të konfiskohet është në shumën prej rreth 3.000.000 euro. Gjykimi i kërkesës nuk ka përfunduar.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.2, viti 2018 është paraqitur kërkesa për konfiskimin e shumave monetare prej 174.810 Euro, të shumës 1.000 USD, si dhe të shumës monetare 9.605.000 lekë. Gjykimi i kërkesës nuk ka përfunduar.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.9, viti 2018 është paraqitur kërkesa për konfiskimin e llogarive bankare në shumën 16.207.329 lekë, në shumën 1.026.879 lekë, në shumën 42.000.000 lekë dhe në shumën 51.444.350 lekë. Gjykimi i kërkesës nuk ka përfunduar.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.10, viti 2018 është paraqitur kërkesa për konfiskimin e 17 pasurive të paluajtshme dhe katër automjete. Gjykimi i kërkesës nuk ka përfunduar.

-Kërkesat në zbatim të ligjit nr.10192/2009 bazuar në të cilat është vendosur nga gjykata sekuestrimi i pasurive janë:

- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.1, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri: 3 (tre) llogari bankare në shumën 7.054.812 lekë; në shumën 6.200.000 lekë, dhe në shumën 5.555 lekë.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.2, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri: -tre apartamente dhe një garazh; -truall me sipërfaqe 473 m² dhe tokë me sipërfaqe 608 m²; dhe 8 (tetë) automjete.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.3, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri: -shuma monetare 3.360.130 euro, shuma monetare 80.000 franga zvicerane, shuma monetare 72.000 euro; -katër pasuri të paluajtshme.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.9, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri:- gjashtë pasuri të paluajtshme, -një shoqëri tregtare, -pesë automjete, -shumat monetare 173.500 euro, 8.629.000 lekë, 15.000 euro.

- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.4, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri: -13 pasuri të paluajtshme, -shumat monetare 21.501 euro, 16.479 euro, 5.000 euro, 2.919.000 lekë, 1.091.000 lekë, 1.827.000 lekë; -një automjet.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.5, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri: -Dy automjete, -dy aktivitete tregtare.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.6, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri: -Tre pasuri te paluajtshme, -dy automjete.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.8, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri: -Një pasuri te paluajtshme, -katër automjete.
- ✓ Në kuadër të procedimit pasuror nr.7, viti 2019 është vendosur masa e sekuestrimit për këto pasuri:- Nëntë pasuri te paluajtshme, -tre automjete.

II. Informacion nga prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm për sekuestro preventive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale

Vlera e pasurive të sekuestruara në proceset penale për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, për periudhën e vitit 2018 e në vijim, rezulton si më poshtë:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në kuadrin e 2 (dy) procedimeve penale ka kërkuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi pasuritë:- apartament me sipërfaqe 364,31 m²;

- tokë arë me sipërfaqe 5090 m²;
- depo plehu kimik me sipërfaqe 100 m² dhe pjesë funksionale e ambientit 100 m²;
- Automjet i markës “Audi Q7”
- apartament, me sipërfaqe 50 m²;
- tokë arë + truall me sipërfaqe 500 m², si dhe ndërtesë 1 kat e llojit njësi, me sipërfaqe 167,9 m²;
- tokë arë me sipërfaqe 809,5 m²;
- sekuestros preventive mbi 50% të kuotave të zotëruara në shoqërinë tregtare “..”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në kuadrin e 2 (dy) procedimeve ka kërkuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi pasuritë:

- “Njësi me sipërfaqe 197 m² me vlerë 18.261.900 Lekë;
- Apartament me sipërfaqe 104 m² me vlerë 6.427.200 Lekë;
- Apartament me sipërfaqe 75 m² me vlerë 4.635.000 Lekë,
- Njësi shërbimi me sipërfaqe 22 m² me vlerë 2.039.400 Lekë;
- Apartament me sipërfaqe 60 m² me vlerë 3.708.000 Lekë;
- Apartament me sipërfaqe 70 m² me vlerë 4.326.000 Lekë;
- Njësi me sipërfaqe 20 m² me vlerë 1.854.000 Lekë;
- Apartament me sipërfaqe 81 m² me vlerë 5.005.800 Lekë;
- Njësi shërbimi me sipërfaqe 25 m² me vlerë 2.317.500 Lekë;

- Objekt informal, ndërtesë tre katëshe, me sipërfaqe baze ndërtimore 150 m² dhe me sipërfaqe totale 450 m², me vlerë 18.076.500 Lekë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në kuadrin e 1 (një) procedimi penal ka kërkuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi pasuritë:

-Njese dyqane te sekuestruara në total sip.1709 m²= 158.424.300 (Nje qinde e pesedhjete e tete milion e katerqinde e njezete e kater mije e treqinde) lekë.

-Apartamente ne total sip.5822 m²= 359.799.600 (tre qinde e pesedhjete e nenete milion e shtate qinde e nentedhejte enente mije e gjashte qind) leke.

-Garazhe në total sip.1201 m²=51.955.260 leke afro (Pesdhjete e dy milion)

-Shoqeria “PERSONI JURIDIK 1” te sekuestruara ndertesa =99,309.623 leke dhe makineri pajisje ne vleren 29,355,165 leke.

-Shtetasit PERSONI V jane sekuestruar 50.000 euro dhe PERSONI 1 jane sekuestruar 1.000.000 leke Cash ne llogarite bankare.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në kuadrin e 4 (katër) procedimeve penal ka kërkuar dhe vendosur ng gjykata masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi pasuritë:

-Para kesh mbi 5.000.000 lekë;

-Pese apartamente me sip total sip.500 m².

-Tre siperfaqe toke, ne total sip 5500 m2

Në Prokurorinë e shkalles së parë Shkodër në kuadër të 5 procedimeve penale janë sekuestruar pasuritë si më poshtë:

- Pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, vlere e të cilave sipas aktit të eksperimentit është në shumën prej 2.112.091.215 (dy miliard e një qind e dymbëdhjete million e nëntë dhjetë e një mijë e dy qind e pesëmbëdhjetë) lekë.

- 3 automjete (të pavlerësuar).

- Pasurinë, truall+ndertese, me siperfaqe totale 600 m2, nga e cila ndertese 315,5 m2, dy katëshe, godinë e kombinuar banimi dhe social ekonomike, një kat banim me sip 188.6m2 dhe një kat për aktivitet ekonomik me sip 315.5 m2,

- Pasurinë pemtore me sipërfaqe 4707 m2, e ndodhur në Ivanaj, Malësi e Madhe,

- Pasurinë, truall+ndertese me siperfaqe 89.9 m2, godinë social-ekonomike një kat, e ndodhur në fshatin Ivanaj, Bashkia Malësi e Madhe,

- Pasurinë, truall+ndertese 1 kat me siperfaqe 37.8 m2, godinë një katëshe social-ekonomike, e ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi e Madhe,

- Pasurinë pemtore me sipërfaqe 4579.3 m2, e ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi i Madhe.

- Pasurinë, pemtore me sipërfaqe 1088 m2, e regjistruar e ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi i Madhe.

- Pasuria pemtore më sipërfaqe 4510 m2, e ndodhur në Hot, Malësi e Madhe.

- Sipërfaqe 262 ha ose 2 620 000 m².
- Pasuri me sipërfaqe 3.600.000 m², ose 360 ha.
- Pasuria me sipërfaqe 2.400.000 m², ose 240 ha.
- Pasuri e luajtshme;
- Shumat prej 145 620 euro; 272 400 \$; 510 Paund; 414 000 lekë.
- 20 automjete (të pavlerësuara)
- Shuma prej 100 350 (një qind mijë e tre qind e pesëdhjetë) euro.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në kuadrin e 2 (dy) procedimeve penal ka kërkuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur masën e sigurimit pasurorë të sekuestros preventive mbi pasuritë:

-Shuma 1,000,000 (njëmilion) Euro dhe shuma 500,000 (pesëqind mijë) Euro në ABI Bank në emër të subjektit.

-Shuma 239,835 (dyqind e tridhjet e nëntë mijë e tetëqind e tridhjet e pesë) euro në bankën BKT;

-Shuma 250,000 (dyqind e pesëdhjet mijë) euro në bankën Reiffaisen Bank;

-Shuma 1,920 (një mijë e nëntëqind e njëzet) euro në bankën Union.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, në kuadrin e 1 (një) procedimi per vepren penale te “Pastrimi i produkteve te vepres penale” te parashikuar nga neni 287 te K.Penal ka kërkuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur sekuestro preventive në shumën 5 269 551 Euro.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, në kuadrin e 1 (një) procedimi penale per vepren penale te “Pastrimi i produkteve te vepres penale” te parashikuar nga neni 287 te K.Penal ka kërkuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur masën e sigurimit pasurorë të sekuestros preventive: -Në dy pasuri të paluejtshme në një vlerë 61,400 (gjashtë e një mijë e katërqind).

Përve sa më sipër, **në prokuroritë e tjera të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm** janë sekuestruar në kuadër të procedimeve për pastrim të produkteve të veprës penale edhe:

Llogari bankare:	2 me vlerë deri 5.000.000 lek
	1 me vlerë mbi 5.000.000 lek.
Automjete	16
Apartamente:	13 deri 100 m ²
	4 apartamente mbi 10 m ²
	3 sipërfaqe toke deri 500 m ²
	2 sipërfaqe toke mbi 500 m ²
Aktivitete tregtare:	1 person fizik
	1 person juridik

